

UDHËZIME PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMEVE TË ZBULIMIT

Për komisionet parlamentare në
Kuvendin e Republikës së Maqedonisë



DCAF

a centre for security,
development and
the rule of law

Maj 2018



ASSEMBLY OF
THE REPUBLIC OF MACEDONIA

UDHËZIME PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMEVE TË ZBULIMIT

Për komisionet parlamentare në
Kuvendin e Republikës së Maqedonisë



DCAF

a centre for security,
development and
the rule of law



ASSEMBLY OF
THE REPUBLIC OF MACEDONIA

Maj 2018

Falënderim

Kompletimi i këtyre Udhëzimeve për mbikëqyrje të shërbimeve të zbulimit do të ishte i pamundur pa kontributet dhe mbështetjen e çmuar të një numri të madh të individëve.

Falënderojmë para së gjithash, deputetët e **Kuvendit të Republikës së Maqedonisë** të cilët kontribuuuan në dizajnimin dhe zhvillimin e këtyre Udhëzuesve që nga fillimi. Ata e kanë iniciuar këtë projekt dhe na i kanë shpjeguar sfidat praktike me të cilat ballafaqohen komisionet e tyre në mbikëqyrjen e shërbimeve të sigurisë dhe zbulimit. Ata kanë ndarë kohë nga orari i tyre i ngjeshur që të ndajnë me autorët perspektivat nga të cilat mësuam shumë. Shpresojmë që Udhëzuesi t'u përgjigjet pritjeve dhe nevojave të tyre, duke u bërë një mjet i dobishëm dhe informativ për punën e Kuvendit.

Parlamenti federal belg ka mbështetur projektin përmes përfshirjes aktive të Komisionit të përhershëm për revizion të agjencive të zbulimit (Komisioni I) në shkëmbimin e praktikave të mira dhe mësimëve të marra me kolegët nga Republika e Maqedonisë.

Si bashkautorë të këtij botimi, **Magdalena Lembovska, profesori Xhulian Riçards dhe Valter de Rider, të cilët** kanë dhënë përpjekje të jashtëzakonshme individuale edhe kolektive, të pasuruar me durim dhe profesionalizëm në një periudhë prej gjashtë muajve. Ata tekstit i sollën një perspektivë të vlefshme dhe larmishme të një hulumtuesi, një ish udhëheqësi të lartë të zbulimit dhe një praktikanti në fushën e mbikëqyrjes.

Piter Gille ka vënë tekstin nën një shqyrtim rigoroz, duke siguruar rishikimin e jashtëm të Udhëzuesve. Jam shumë mirënjohës për këshillat e tija me vend dhe vërejtje të arsyeshme.

Dëshiroj të falënderoj **Andrej Rupnikun, Mark Remillardin, Irena Xhajkovskën dhe Vlado Gjerdovskin**, kolegët e mi në DCAF, për komentet dhe informatat kthyesë të rëndësishme. Dhe përfundimisht, një falënderim të veçantë për **Josip Specin** për mbështetjen e tij të zellshme redaktuese dhe menaxhimin e mirëfilltë të aktiviteteve rreth përkthimit dhe botimit.

Dr. Teodora Fuior, autor kryesor

Gjenevë, Maj 2018

DCAF dhe Kuvendi i Republikës së Maqedonisë e falënderojnë Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe çështje të Komonuelthit si dhe Ministrinë e Punëve të Jashtme të Holandës për mbështetjen e tyre financiare të Programit për Reforma në Sektorin e Zbulimit duke përfshirë dhe përgatitjen e këtij botimi.

Përmbajtja e këtij botimi nuk pasqyron qëndrimin ose mendimet e Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar.



Kingdom of the Netherlands

Contents

1. Hyrje: Çfarë është mbikëqyrja e shërbimeve të zbulimit dhe pse është e rëndësishme?	4
2. Korniza strategjike dhe ligjvënese për mbikëqyrjen e zbulimit	6
2.1. Korniza strategjike për siguri kombëtare	7
2.2. Dispozitat ligjore mbi shërbimet e zbulimit	8
2.2.1. Agjencia e Zbulimit	9
2.2.2. Drejtoria e sigurisë dhe kundërzbulimit (DSK)	10
2.2.3. Shërbimi për siguri ushtarake dhe zbulim (SHSUZ)	11
2.2.4. Agjencia operative- teknike (AOT)	12
2.3. Sistemi maqedonas i mbikëqyrjes së shërbimeve të zbulimit	13
2.3.1. Dispozitat ligjore për kontrollin e brendshëm	13
2.3.2. Kontrolli nga pushteti ekzekutiv	14
2.3.3. Mbikëqyrja nga ana e Kuvendit	16
2.3.4. Organe të tjera të pavarura	20
2.3.5. Prokuroria publike/Gjyqësori	23
3. Aftësia e komisionit për kryerje të mbikëqyrjes: krijimi i kushteve për mbikëqyrje efektive	25
3.1. Qasja deri tek informatat	26
3.2. Ekspertiza e komisionit	30
3.3. Procedurat e komisioneve	32
3.4. Takimet e përbashkëta dhe aktivitetet e mbikëqyrjes	33
4. Komisioni në veprim: Mjetet e mbikëqyrjes	35
4.1. Raportet	36
4.2. Seancat e shqyrtimit	37
4.3. Vizitat në terren	39
4.3.1. Përgatitja	40
4.3.2. Zbatimi	41
4.3.3. Hapat e mëtejshme pas vizitës në terren	42
4.4. Hetimet	44
5. Jashtë rrethit të fshehtësisë: mbikëqyrja e shërbimeve të zbulimit dhe publiku	45
5.1. Raportimi publik	45
5.2. Vlerësimi i mbikëqyrjes	47
5.3. Roli i shoqërisë civile në mbështetjen e mbikëqyrjes demokratike të shërbimeve të zbulimit	48
Shtojcat	50
Shtojca A: Pasqyrë e legjislacionit të Maqedonisë për mbikëqyrje parlamentare	50
Shtojca B: A Plani vjetor i aktiviteteve të Komisionit	62
Shtojca C: Pasqyrë e çështjeve në Planet vjetore të aktiviteteve	64
Shtojca D: Pasqyrë e aktorëve dhe proceseve	68

1 HYRJE: ÇFARË ËSHTË MBIKËQYRJA E SHËRBIMEVE TË ZBULIMIT DHE PSE ËSHTË E RËNDËSISHME?

Mbikëqyrja parlamentare i referohet¹ monitorimit, rishikimit, vlerësimit dhe hetimit të vazhdueshëm të punës së agjencive qeveritare dhe agjencive publike, duke përfshirë zbatimin e politikës, legjislacionit dhe ekzekutimin e buxhetit të shtetit. Mbikëqyrja parlamentare është një nga manifestimet më të rëndësishme të ndarjes së pushteteve në një demokraci. Mbikëqyrja parlamentare duhet të shtrihet në të gjithë sektorët e qeverisë, duke përfshirë shërbimet e zbulimit dhe të sigurisë.

Shërbimet e zbulimit punojnë në fshehtësi dhe kanë autoritetin të përdorin kompetenca të veçanta që mund të ndërhyjnë dhe të cenojnë të drejtat e njeriut. Vëzhgimi i komunikimeve, vëzhgimi i fshehtë dhe pirateria informatike janë vetëm dy nga këto kompetenca. Për këto arsye, shërbimet e zbulimit opinjoni i sheh me dyshim dhe mungesë besimi. Prandaj, nevoja për ligjshmërinë, legjitimitetin dhe llogaridhënien është më e madhe për shërbimet e zbulimit sesa për agjencitë e tjera qeveritare.”

Cilat janë kompetencat e veçanta të shërbimeve të sigurisë dhe zbulimit?

- Përgjimi, kapja, regjistrimi dhe monitorimi i bisedave, telekomunikacionit, transferime ose lëvizje të tjera të të dhënave - brenda vendit ose nga jashtë.
- Mbikëqyrje, regjistrimi dhe gjurmimi i informacionit.
- Bastisja e hapësirave dhe ambienteve të mbyllura, ndërhyrja në pronë.
- Hapja e letrave ose dërgesave të tjera, pa pëlqimin e dërguesit ose pranuesit.
- Kërkimi nga ofruesit e rrjeteve publike të telekomunikacionit të sigurojnë informacion në lidhje me identitetin e përdoruesve dhe trafikun që zhvillohet.
- Përdorimi i identiteteve të vjedhura ose falso, çelësave, softuer për hyrje, kopjimi ose dëmtimi i fshehtë i bazave të të dhënave.
- Të pasurit qasje në të gjitha vendet për instalimin e pajisjeve të vëzhgimit.
- Mbledhja e informacioneve financiare për individët ose rrjetet.
- Regrutimi dhe udhëheqja me resurset e fshehta njerëzore.
- Krijimi dhe përdorimi i personave të rrejshëm juridik për përkrahje të aktiviteteve operative.

Si ligjvënës, Kuvendi është përgjegjës për zbatimin e legjislacionit të qartë, të kuptueshëm dhe gjithëpërfshirës me të cilin themelohen shërbimet e zbulimit dhe rregullohet organizimi i tyre, kompetencat dhe kufizimet e tyre të veçanta. Mbikëqyrja parlamentare shqyrton, vlerëson dhe heton zbatimin e ligjeve dhe nëse dhe si veprimet e zbulimit janë në përputhje me kushtetutën, politikën dhe legjislacionin e sigurisë kombëtare. Kuvendi gjithashtu sjell buxhetet e shërbimeve të zbulimit dhe mund të luajë një rol të rëndësishëm në shqyrtimin e ekzekutimit të buxhetit.

Mbikëqyrja efektive parlamentare siguron një urë midis shërbimeve të zbulimit dhe publikut dhe sjell përfitime për të gjithë: për shërbimet e zbulimit, për vetë parlamentin dhe më e rëndësishmja, për qytetarët.

- 1) Kur shërbimet e zbulimit janë të përgjegjshme dhe japin llogari në përmbushjen e mandatit të tyre ligjor, legjitimiteti dhe efektiviteti i tyre forcohet. Mbikëqyrja i mbron shërbimet e zbulimit nga keqpërdorimi politik dhe mund të ndihmojë në krijimin e vendeve të punës me burime të mjaftueshme, meritokratike dhe jo-diskriminuese për profesionistët e zbulimit. Llogaridhënia më e madhe e shërbimeve të zbulimit përmirëson besimin e publikut

¹ Në shumicën e vendeve mbikëqyrja parlamentare i shqyrton aktivitetet dhe programet që tashmë i zbatojnë shërbimet e zbulimit. I vetmi përjashtim është Kongresi i Shteteve të Bashkuara të Amerikës ku një numër i kufizuar i përfaqësuesve janë të informuar para se të fillojnë programet zbuluese të ndjeshme. Ex-ante përfshirja e kuvendit jo detyrimisht lejon pjesëmarrjen e tyre në sjelljen e vendimeve ose në ndërprerjen e operacioneve, por mund ta komprometoj aftësinë e tyre të kritikojnë më vonë nëse diçka shkon keq.

në qeverinë.

- 2) Një përfshirje efektive parlamentare në mbikëqyrjen e zbulimit, që lë anash dallimet politike dhe përqendrohet në interesat kombëtarë, ndihmon parlamentin të rrisë besueshmërinë e tij si institucion demokratik dhe rrit respektin dhe besimin që merr nga shërbimet e zbulimit dhe publikun.
- 3) Mbikëqyrja efektive mbron të drejtat dhe liritë e qytetarëve dhe siguron mbrojtje të duhur për të parandaluar abuzimin dhe keqpërdorimin e pushtetit. Mbikëqyrja është vendimtare për sundimin e ligjit, respektimin e të drejtave të njeriut, dhe gjithashtu për të siguruar që paratë e taksapaguesve të shpenzohen në mënyrë efikase dhe ekonomike.

Pse mbikëqyrja e shërbimeve të zbulimit është e rëndësishme?

Shërbimet e zbulimit dhe sigurisë luajnë një rol thelbësor në ruajtjen e sigurisë së shtetit. Debatet publike dhe të hapura për qëllimin dhe kompetencat e tyre paraqesin një presion për përmirësimin e profesionalizmit dhe efikasitetit. Pa kontroll dhe mbikëqyrje të cilat do të sigurojnë se shërbimet e zbulimit i shërbejnë interesave kombëtare dhe punojnë brenda kufijve të vendosur me Kushtetutë dhe ligj, shërbimet mund të shndërrohen në gjeneratorë të krizave në vend të ofruesve të sigurisë.

Natyra e punës së shërbimeve të zbulimit imponon shkelje të ligjeve dhe të të drejtave të njeriut; sa më tepër sy që ndjekin këto shkelje dhe sa më tepër zëra që kërkojnë që këto shkelje të mbahen në minimum, aq më mirë.

Siguria është një e mirë publike për të cilën qytetarët duhet të paguajnë. Agjencitë e zbulimit dhe të sigurisë harxhojnë paratë publike dhe duhet të japin llogari ndaj taksapaguesve.

Përmes mbikëqyrjes ekziston edhe një funksion i rëndësishëm i edukimit të publikut; me të në mënyrë indirekte mund të ndërtohet edhe mbështetja e komunitetit për punën e rëndësishme që kryejnë agjencitë e zbulimit dhe sigurisë.

Shërbimet e sigurisë së brendshme kanë nevojë për një pranim më të madh nga publiku në vendet ku kanë sunduar regjime autokratike në të kaluarën - që kanë përdorur shërbimet e sigurisë për qëllimet e tyre; shërbimet kanë tendencën të nxisin dyshime publike, mungesë besimi dhe sulme ndaj legjitimitetit të tyre. Mbikëqyrja ndihmon që shërbimet të rikthejnë besimin e popullit dhe të ripërcaktojnë vendin e tyre në një shoqëri demokratike.

2 KORNIZA STRATEGJIKE DHE LIGJVËNËSE PËR • MBIKËQYRJEN E ZBULIMIT

Qeveritë dhe kuvendet kanë nevojë për zbulim të cilësisë së lartë për të marrë vendime të përshtatshme për sigurinë kombëtare në disa fusha, duke përfshirë vendimin për shumën e buxhetit të forcave speciale të sigurisë deri tek autorizimi i përdorimit të forcës. Përveç që janë shfrytëzues të informatave të zbulimit, kuvendet debatojnë, negociojnë dhe miratojnë dokumentet strategjike dhe ligjore që krijojnë mjedisin në të cilin veprojnë shërbimet e zbulimit. Korniza ligjor gjithashtu përcakton kompetencat ligjore të kuvendit dhe të komisioneve të tij gjatë mbikëqyrjes.

Ky seksion do të shqyrtojë kornizën aktuale strategjike dhe ligjore në Republikën e Maqedonisë, duke ofruar një vlerësim të shpejtë të dispozitave kryesore ligjore që rregullojnë punën e shërbimeve të zbulimit, organizimin e shërbimeve të ndryshme dhe llojet e informacionit që janë në dispozicion të publikut për autorizimet e zbulimit, metodat dhe mjetet. Mbikëqyrja nuk është vetëm një e drejtë e kuvendit, sepse përfshin detyrën dhe përgjegjësinë për të siguruar qartësinë dhe gjithë përfshirjen e kornizave strategjike dhe ligjore. Mangësitë e mundshme në planifikimin strategjik dhe ligjvënës duhet të shqyrtohen me kujdes, në mënyrë që të përcaktohen zgjidhjet më të mira për përmirësimin e administrimit të informacionit dhe llogaridhënies.

Terminologjia

Shërbimi i zbulimit dhe sigurisë – një organizatë shtetërore e cila mbledh, përpunon, analizon dhe shpërndan informata që kanë të bëjnë me kërcënimet mbi sigurinë kombëtare. Ka një mandat ligjor për përdorim të metodave ndërhyrëse për mbledhjen e informatave. Shërbimi mund të jetë një agjenci/shërbim e/i pavarur ose një sektor i një ministrie (siç është ajo e mbrojtjes, e punëve të brendshme ose e drejtësisë). E quajtur ndryshe: shërbim sigurie, shërbim zbulimi, agjenci inteligjence.

Spektori i zbulimit – të gjitha shërbimet e zbulimit dhe sektorët në ministri që kanë aktivitet zbulimi në shtet.

Kompetenca të veçanta – fuqitë autoritare që shërbimet e zbulimit i kanë për të mbledhur informata - siç është kompetenca (fuqia) për të ndërhyrë në komunikimet, kompetenca për të bërë vëzhgim, kompetenca për të përdorur informatat e fshehta, kompetenca për të hyrë nëpër shtëpi në mënyrë klandestine, e të ngjashme.

Metoda ndërhyrëse për të mbledhur informata – masat për grumbullim të informatave të cilat ka shumë gjasa që i shkelin të drejtat e njeriut ose të drejtat e qytetarëve të siguruara me kushtetutë, sidomos e drejta për privatësi. Përdoret për mbledhjen e provave në hetimet penale nga policia dhe prokuroria, ose për mbrojtjen e sigurisë kombëtare nga ana e shërbimeve të zbulimit.

Masat/teknikat e veçanta hetimore - masat për mbledhjen e informatave që e shkelin të drejtën e privatësisë, të zbatuara nga policia për mbledhjen e provave gjatë hetimeve penale. Ndonjëherë në mënyrë sinonime përdoret me metodat ndërhyrëse për mbledhjen e informatave.

Vëzhgimi i fshehtë – Monitorimi dhe vëzhgimi/përgjimi i personave, lëvizjeve të tyre, komunikimeve (fizike apo elektronike) dhe aktivitete të tjera dhe regjistrimi i aktiviteteve të tilla pa njohurinë e tyre.

Kontrolli—fuqia për të menaxhuar dhe për të drejtuar një shërbim zbulimi, e kryer nga ana e shërbimit të zbulimit mbi veten e tyre (kontrolli i brendshëm) dhe/ose nga ana e ministrit përgjegjës dhe personelit të tij (kontrolli ekzekutiv). Ajo mund të përfshijë mbikëqyrjen e brendshme, por nuk mund të zëvendësojë mbikëqyrjen e jashtme.

Mbikëqyrja—një term gjithëpërfshirës i cili përfshin shqyrtimin ex ante (kontroll paraprak), mbikëqyrjen e vazhdueshme dhe rishqyrtimin para dhe pas si dhe vlerësimin dhe hetimin.

Llogaridhënia—koncept i raportit, ku njëri aktor ka të drejtë të mbajë aktorin tjetër për përmbushjen e një shume të standardeve, ta gjykojë për plotësimin e përgjegjësisë dhe ta ndëshkojë nëse këto përgjegjësi nuk janë plotësuar.

Qeverisje—Ushtrim i pushtetit dhe autoritetit që ndikon në sigurimin e të mirave publike, siç është shëndetësia, arsimi apo siguria. Kjo përfshin vendimet formale qeveritare por gjithashtu dhe proceset joformale, aktorë dhe vlera të cilat modelojnë vendimet dhe zbatimin e tyre. Qeverisja e sigurisë i referohet të gjitha institucioneve dhe aktorëve të përfshirë në dispozitat, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e sigurisë në nivel kombëtar dhe vendor.

2.1. Korniza strategjike për siguri kombëtare

Në një demokraci, është shoqëria, jo shërbimet e zbulimit, ajo që e përcakton interesin kombëtar dhe atë që përbën kërcënim për sigurinë kombëtare. Ky është zakonisht një proces i gjatë i cili rezulton në formulimin e politikës dhe legjislacionit të sigurisë kombëtare. Përfshirja e kuvendit në debatin dhe / ose miratimin e dokumenteve strategjike dhe të planifikimit strategjik është pika fillestare e mbikëqyrjes. Dy gjëra duhet të jenë në vëmendjen e kuvendit në lidhje me kornizën strategjike:

- Dokumentet e planifikimit strategjik duhet të përmbushin vlerat dhe parimet e përfshira në kushtetutë;
- Shërbimet e zbulimit duhet të ushtrojnë kompetencat e tyre brenda objektivave, mandateve, prioriteteve dhe kufizimeve të përcaktuara në kuadrin e sigurisë strategjike.

Dokumentet strategjike afatmesme dhe afatgjate siç janë *politika e sigurisë kombëtare* ofrojnë një kornizë të integruar për të përshkruar se si një vend ofron sigurinë për shtetin dhe qytetarët e tij. Këto dokumente mund të quhen edhe *plan, strategji, libër i bardhë, koncept apo doktrinë*. Ato përcaktojnë nevojat dhe prioritetet e sigurisë, identifikojnë institucionet përgjegjëse për aspekte të ndryshme të sigurisë dhe u japin atyre udhëzime për politikën, dhe tregues mbi burimet dhe mjetet që do të përdoren për të arritur objektivat e pritura të sigurisë. Ndonjëherë ka edhe versione publike dhe të klasifikuara të dokumenteve të tilla, për të balancuar nevojën për transparencë dhe fshehtësinë.

Cilat janë disa nga çështjet kyçe strategjike në mbikëqyrjen e zbulimit?

- A funksionojnë zyrtarët e zbulimit brenda kornizës strategjike të krijuar nga qeveria dhe të miratuar nga kuvendi?
- A posedojnë shërbimet e zbulimit kompetenca të mjaftueshme ligjore, buxhet dhe personel për të përmbushur mandatin e tyre?
- Cilat probleme sistematike kanë lindur brenda sektorit të sigurisë nga një veprim apo proces zbulimi?
- A i kanë keqpërdorur krerët politikë shërbimet e zbulimit? Nëse po, si mund të parandalohet kjo?
- A ofrojnë profesionistë të zbulimit analiza të paanshme dhe objektive apo analizat e tyre janë të politizuara?

Dokumenti më gjithëpërfshirës, pra i rëndësishëm, strategjik për sigurinë kombëtare në Republikën e Maqedonisë është Koncepti **Kombëtar për Sigurinë dhe Mbrojtjen**². Koncepti përcakton interesat kombëtare, ofron një analizë të mjedisit të përgjithshëm të sigurisë (duke përfshirë rreziqet, kërcënimet dhe mundësitë), dhe përcakton qëllimet dhe udhëzimet për politikën e sigurisë kombëtare dhe politikën e mbrojtjes. Koncepti nuk u përditësua kurrë pas miratimit të tij nga Parlamenti në vitin 2003.

Koncepti parashikon që Qeveria të hartojë dhe të miratojë një Strategji të Integruar të Sigurisë Kombëtare “sa më shpejt që të jetë e mundur”. Kjo ndodhi në vitin 2008, por dokumenti nuk u bë publik.

Presidenti miraton **Strategjinë Kombëtare të Mbrojtjes**, të hartuar nga Ministria e Mbrojtjes³. Strategjia e fundit e Mbrojtjes Kombëtare daton nga viti 2010.

Korniza strategjike për sigurinë kombëtare ndikon në jetën, vlerat dhe mirëqenien e njerëzve dhe nuk duhet t'i lihet vetëm gjykimin të pushtetit ekzekutiv. Një kornizë strategjike e cila nuk është gjithëpërfshirëse, e përditësuar dhe e arritshme për publikun mund të konsiderohet si një dobësi për qeverisjen demokratike, duke penguar qasjen koherente dhe strategjike në mbikëqyrjen e sektorit të sigurisë. Përgjegjësitë për hartimin, miratimin dhe përditësimin e këtyre dokumenteve duhet të qartësohen nga legjislacioni, ndërsa komisionet parlamentare duhet të bëjnë presion ndaj qeverisë për të mbështetur afatet kohore të këtij procesi.

Programi i Qeverisë përcakton kornizën afatmesme politike për reformat e ardhshme dhe bazën mbi të cilën legjislacioni, buxhetet vjetore dhe planet e veprimtarisë do të përpunohen nga ekzekutivi. Dokumenti i paraqitet kuvendit për debat dhe përkrahje. Sapo të miratohet, ai duhet të bëhet pika kryesore e referimit për vlerësimin e punës së qeverisë. Për

² Ligji për mbrojtje, neni 17

³ Strategjia e mbrojtjes së Republikës së Maqedonisë, neni 18

këtë arsye, aktivitetet e mbikëqyrjes parlamentare duhet të marrin si pikënisje masat konkrete, reformat, politikat dhe angazhimet e ndërmarra me Programin e Qeverisë. Programi i Qeverisë 2017-2020 definon reformën e Drejtorisë për siguri dhe kundërzbulim (DSK) si një prioritet kyç, implementimi i të cilit do të udhëhiqet nga rekomandimet e Pribe-së dhe praktikat më të mira evropiane. Për më tepër, Qeveria përkushtohet që të mbështesë plotësisht mbikëqyrjen parlamentare të këtij shërbimi⁴.

Bazuar në Programin e Qeverisë, secila ministri zhvillon një plan strategjik 3-vjeçar i cili përditësohet çdo vit. Këto dokumente shqyrtojnë rezultatet e arritura nga ministria në vitin e kaluar dhe formulojnë misionin, vizionin, parimet e punës dhe prioritetet për periudhën trevjeçare që vijon. Planet strategjike të Ministrisë së Brendshme dhe të Ministrisë së Mbrojtjes mund të informojnë deputetët për çështje të tilla si: programet e planifikuara të zhvillimit, projektet e ardhshme, strategjitë që duhet të miratohen, zhvillimi i burimeve njerëzore etj. Por planet strategjike të këtyre ministrive nuk përmbajnë informacione rreth punës së departamenteve përkatëse të zbulimit; madje as nuk shpjegojnë se si aktivitetet e zbulimit integrohen në strategjinë e përgjithshme të ministrisë. Megjithatë, ky informacion duhet t'u sigurohet komisioneve parlamentare me kërkesë të tyre. Ministrive mund t'u kërkohet të përgatisin një version publik të planit strategjik dhe një klasifikim (që mbulon departamentet e zbulimit), që mund të vihen në dispozicion të komisioneve përkatëse.

2.2. Dispozitat ligjore mbi shërbimet e zbulimit

Standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe sundimi i ligjit⁵ parashohin që mandati dhe kompetencat e shërbimeve të zbulimit të përcaktohen me ligj. Ligji duhet të jetë i qartë, i parashikueshëm dhe i arritshëm. Masat mbrojtëse kundër veprimeve arbitrare duhet të jenë mirë të rregulluara në legjislacion, për të balancuar fshehtësinë. Qeveria mund të hartojë akte nënligjore - siç janë dekretet, urdhri i ministrit ose udhëzimet ministrore - që nuk janë vënë në dispozicion të publikut. Megjithatë, këto duhet të mbulojnë vetëm informacione specifike që mund të rrezikojnë punën e shërbimeve të zbulimit dhe / ose sigurinë kombëtare nëse bëhen publike (siç janë metodat operative dhe përdorimi i pajisjeve ose teknologjive të veçanta. Rregulloret që nuk janë publike duhet megjithatë të jenë në përputhje me ligjet dhe kushtetutën.

⁴ Shih faqen 27 të dokumentit: Program i Qeverisë 2017-2020

⁵ Parimi ku të gjithë anëtarët e shoqërisë (duke përfshirë edhe ata në qeveri) konsiderohen të nënshtruar në mënyrë të barabartë ndaj kodeve dhe proceseve ligjore të zbuluara publikisht.

Cilat janë standardet e tanishme evropiane për cilësinë e ligjit që rregullon shërbimin e zbulimit?

Këshilli i OKB-së për të Drejtat e Njeriut rekomandon që të gjitha shërbimet e zbulimit të krijohen dhe të veprojnë sipas ligjeve në dispozicion të publikut që janë në pajtim me Kushtetutën dhe të drejtën ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Shërbimet e zbulimit mund të ndërmarrin ose të udhëzohen për të ndërmarrë aktivitete që janë përshkruar nga dhe në përputhje me ligjin kombëtar. Përdorimi i rregullave shtesë që nuk janë në dispozicion të opinjonit është rreptësisht i kufizuar dhe rregulloret e tilla janë të autorizuar nga dhe mbeten brenda parametrave të ligjeve në dispozicion për opinjonin. Rregulloret që nuk bëhen publike nuk shërbejnë si bazë për ndonjë aktivitet që kufizon të drejtat e njeriut. *(Raporti i UNHRC i Raportuesit Special Martin Shajnin, praktikat e mira të OKB-së mbi mandatin dhe bazën ligjore, Praktika4, 2010)*

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) ka konsideruar që kornizat ligjore kombëtare duhet të jenë të qarta, të arritshme dhe të parashikueshme. Ajo i detyron shtetet anëtare të përfshijnë masa mbrojtëse minimale në ligj, siç janë përcaktimi i natyrës së veprave penale që mund të çojnë në urdhra ndërhyrjeje dhe përcaktimin e kategorive të njerëzve që mund të vihen nën vëzhgim. *(Shih, për shembull, Roman Zakharov kundër Rusisë, nr. 47143/06, 4 dhjetor 2015, paragrafi 227-231)*

Agjencia e Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore (FRA) rekomandon që shtetet anëtare të BE-së të kenë ligje të qarta, specifike dhe gjithëpërfshirëse të zbulimit. Kornizat ligjore kombëtare duhet të jenë sa më të detajuara lidhur me mandatet dhe kompetencat e shërbimeve të zbulimit dhe me masat mbikëqyrëse që mund të përdorin. Masat mbrojtëse të të drejtave themelore duhet të jenë të dukshme në ligjet mbi zbulimin, privatësinë dhe mbrojtjen e të dhënave në lidhje me garancitë për mbledhjen, ruajtjen, shpërndarjen dhe qasjen ndaj të dhënave. *(FRA, Mbikëqyrja nga Shërbimet e Zbulimit, 2017)*

Gjykata e Drejtësisë së BE-së thekson se legjislacioni kombëtar duhet së pari të përcaktojë rregulla të qarta dhe të sakta që rregullojnë fushëveprimin dhe zbatimin e masës së mbajtjes së të dhënave dhe vendosjen e masave mbrojtëse minimale, në mënyrë që personat të cilëve u janë mbajtur të dhënat kanë garanci të mjaftueshme për mbrojtjen efektive të të dhënave personale të tyre kundër rrezikut të keqpërdorimit. Ky legjislacion duhet, në veçanti, të tregojë se në cilat rrethana dhe në cilat kushte mund të miratohet masa e ruajtjes së të dhënave, si masë parandaluese, duke siguruar kështu që masa e tillë të kufizohet në atë që është rreptësisht e nevojshme. *(GJEDNJ, Rastet e bashkuara C-203/15 dhe C-698/15, Tele2 Sverige dhe Watson kundër ministrit të Punëve të Brendshme, 21 dhjetor 2016, paragrafi 109)*

2.2.1. Agjencia e Zbulimit

Agjencia e Zbulimit u krijua me ligj⁶ në vitin 1995 si një institucion shtetëror i pavarur. Drejtori i Agjencisë emërohet dhe shkarkohet nga Kryetari, ndërsa Qeveria gjithashtu ka kompetenca të rëndësishme lidhur me punën e saj. Ligji përcakton që "Agjencia është përgjegjëse për mbledhjen e të dhënave dhe informatave me rëndësi për sigurinë dhe mbrojtjen e Republikës së Maqedonisë dhe interesat ekonomik, politik dhe të tjerë të shtetit. AZ zbaton analizë dhe hulumtim të informacionit të mbledhur dhe duhet të informojë Kryetarin, Qeverinë dhe institucionet e tjera shtetërore për çështjet brenda fushave të tyre të përgjegjësisë."⁷ Buxheti i përgjithshëm i AZ-së është në dispozicion publik si pjesë e buxhetit të shtetit, pa ndarje të mëtejshme midis linjave buxhetore. Në vitin 2018, buxheti i përgjithshëm i AZ-së për vitin 2018 është 222 300 000 denarë apo përafërsisht 3.4 milion euro. Agjencia ka 254 punonjës⁸ dhe është e organizuar në gjashtë drejtori:

- Zbulimi strategjik;
- Zbulimi në fushën e terrorizmit ndërkombëtar dhe krimit transnacional;
- Kërkimi dhe analiza;
- Zbulimi teknik dhe mbështetja TI;
- Siguria;
- Çështjet organizative.

⁶ Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 19/95

⁷ Ligji për AZ: Neni 2

⁸ Buxheti i Republikës së Maqedonisë për vitin 2018

Puna dhe organizimi i AZ-së rregullohet me legjislacionin përkatës, dhe informacione të rëndësishme për institucionin janë bërë publike. Sidoqoftë ka fusha ku ka mundësi për përmirësim që duhet të ndiqen nga komisionet e mbikëqyrjes, për të siguruar që llogaridhënia të bëhet nëpërmjet mekanizmave efektivë të kontrollit të brendshëm dhe legjislacionit dytësor mirë të hartuar.

- Ligji për AZ-në mund të jetë më specifik sa i përket mjeteve dhe metodave të përdorur të punës. Ato duhet të përcaktohen nga Qeveria, ndërsa për përdorimin e tyre duhet të vendosë drejtori.⁹
- Kuvendi nuk ka kompetenca lidhur me emërimin e drejtorit.
- Punonjësit e AZ-së që punojnë në vendet e posaçme të punës posedojnë dhe mbajnë armë, municion dhe pajisje të tjera të përcaktuara. Megjithatë, ata nuk kanë status ushtarak.
- Ligji i AZ-së nuk është ndryshuar që nga miratimi i tij në vitin 1995, duke i lënë Drejtorit kompetenca diskrecionale të rëndësishme, që me akte nënligjore, të rregullojë çështje të tjera. . Këto mund të përfshijnë role dhe përgjegjësi të punonjësve, proce

Çfarë duhet të përcaktohet me kornizën ligjore?

- Mandatet e shërbimeve të inteligjencës, duke përfshirë fushat e veçanta të përgjegjësisë dhe një listë gjithëpërfshirëse të detyrave të tyre; kufijtë e mandatit të tyre, siç janë ndalimi i promovimit ose mbrojtjes së interesave të veçantë të ndonjë grupi të caktuar politik, fetar, etnik ose tjetër;
- Metodatat dhe veprimet e lejueshme dhe të palejueshme dhe kufizimet e vendosura për përdorimin e tyre, veçanërisht çdo metodë dhe veprim që mund të ndërhyjë në të drejtat e njeriut;
- Strukturat organizative dhe përgjegjësitë e njësive;
- Modalitetet për bashkëpunim me organet e tjera qeveritare dhe joqeveritare, duke përfshirë shkëmbimin e informacioneve dhe operacione të përbashkëta;
- Mekanizmat e kontrollit dhe mbikëqyrjes me anë të të cilave kërkohet përgjegjësi nga shërbimet e zbulimit, përfshirë kontrollin e brendshëm, ekzekutiv, gjyqësor dhe legjislativ, si dhe organe të posaçme të pavarura;
- Mjetet për ndihmë ligjore në rastet e ankesës, abuzimit ose shkeljes së të drejtave.

2.2.2. Drejtoria e sigurisë dhe kundërzbulimit (DSK)

Drejtoria e siguri dhe Kundërzbulim (DSK) është pjesë përbërëse e Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB). Puna e DSK-së nuk është e rregulluar me ligj të posaçëm, por me Ligjin e Punëve të Brendshme¹⁰, gjë që cenon qartësinë e përcaktimit të mandatit, kompetencave dhe përgjegjësisë së saj. Drejtori i DSK-së emërohet dhe shkarkohet nga Qeveria, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme. Sipas nenit 23 të Ligjit, DSK-ja është përgjegjëse për:

- Veprimet e kundërzbulimit;
- Lufta kundër terrorizmit dhe mbrojtja nga terrorizmi;
- Mbrojtja nga veprime të tjera që kanë për qëllim rrezikimin ose shkatërrimin me forcë të institucioneve demokratike të përcaktuara me Kushtetutë;
- Forma serioze të krimit të organizuar që vijnë nga institucionet demokratike ose që i synojnë ato dhe mund të çojnë në rrezikimin ose ndikimin e tyre në sigurinë e shtetit.

DSK-ja mbledh informacione duke përdorur burime të hapura, bashkëpunëtorë të fshehtë¹¹, por gjithashtu masa dhe

⁹ Ligji i AZ-së nenet 2, 13 dhe 16 mund të interpretohen si carte blanche (duart e lira) nga aspekti i metodave; kjo mund të sjellë deri te shkelja para GJEDNJ-së dhe ta vështirësojë mbikëqyrjen. Gjithashtu TI nuk është në kuadër të strukturës mbikëqyrëse në Ligjin e ri për ndjekjen e komunikacioneve .

¹⁰ Ligji i Punëve të Brendshme, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 42/1, ndryshimet GZ 116/2014, 33/15, 33/15, 5/16, 120/16, 127/16 dhe 190/16, nenet nga 22 deri më 31

¹¹ Ligji i Punëve të Brendshme: neni 26

procedura ndërhyrëse për grumbullimin e të dhënave¹². Disa punonjës të DSK-së¹³ kanë kompetenca me autorizime policore duke përfshirë arrestimin dhe paraburgimin.¹⁴ Kjo nuk është një praktikë e zakonshme për shërbimet evropiane të zbulimit, pasi në shumicën e vendeve ato përbëhen vetëm nga mbledhja, analiza dhe interpretimi i informacionit, ndërsa arrestimi dhe paraburgimi mbeten kompetencë e policisë. Kombinimi i kompetencave të veçanta të policisë dhe shërbimeve të zbulimit e bën DSK-në një institucion të fuqishëm, pra mbikëqyrja dhe kontrolli i shëndoshë i punës së tyre është i një rëndësie të madhe.

Çfarë standardesh ndërkombëtare zbatohen gjatë arrestimit dhe ndalimit nga shërbimet e zbulimit?

Arsyetimi: Ligji duhet të ndalojë arrestimin dhe ndalimin e individëve për qëllimin e vetëm të mbledhjes së informacionit; në rrethana të veçanta, shërbimet e zbulimit mund të arrestojnë dhe ndalojnë individë që kanë kryer një krim kundër sigurisë kombëtare ose paraqesin një kërcënim të pashmangshëm ndaj sigurisë kombëtare.

Trajtimi i të paraburgosurve: Shërbimet e zbulimit duhet të respektojnë të drejtat e njeriut të individit të arrestuar dhe të ndaluar. Ata duhet të sigurojnë të drejtën e avokatit, kontaktit me familjen dhe kushteve adekuate të jetës gjatë kohës në paraburgim. Ata duhet të përmbahen nga çdo formë e keqtrajtimit të të paraburgosurve. Shërbimet e zbulimit nuk kanë qendrat e tyre të paraburgimit, por përdorin të njëjtat ambiente që i përdor policia.

Mbikëqyrja: Gjykata duhet të shqyrtojë ligjshmërinë e të gjitha paraburgimeve, duke parandaluar që individët të mbahen në mënyrë arbitrare. Përveç kësaj, organet parlamentare, institucionet e Avokatit të Popullit dhe organet e tjera të monitorimit të të drejtave të njeriut duhet të kryejnë inspektime të objekteve të paraburgimit (ndonjëherë pa paralajmërime).

Burimi: *Parimet e OKB-së mbi Paraburgimin, Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, Konventa kundër Torturës.*

Struktura e brendshme organizative e DSK-së bazohet në një parim linear dhe territorial.¹⁵ Megjithatë, ndryshe nga AZ-ja, struktura organizative e DSK-së nuk është publike. Sistematizimi zyrtar i Ministrisë së Brendshme¹⁶ nuk jep ndonjë indikacion se DSK-ja është pjesë përbërëse e saj. Për më tepër, as buxheti i kësaj agjencie nuk është publik, pasi ajo është pjesë e buxhetit të përgjithshëm të MPB-së. Gjithashtu, numri i të punësuarve brenda DSK-së nuk është publik. Paqartësia rreth DSK-së i nxjerrë në pah kufizimet që vijnë nga mungesa e një ligji për të përcaktuar rolin, organizimin dhe funksionimin e një shërbimi të zbulimit. Kërkimi i llogaridhënies nga një shërbim në këto rrethana është një detyrë e vështirë për mbikëqyrësit.

Ligji i vitit 2018 mbi përgjimin e komunikimeve bën dallimin e nevojshëm ndërmjet përgjimit të komunikimeve si një masë e veçantë hetimore (për qëllime të procedurave penale) dhe përgjimit të komunikimit për qëllime të sigurisë dhe mbrojtjes (kryesisht për parandalimin dhe identifikimin e kërcënimeve të mundshme). Kjo e fundit është veçanërisht e ndjeshme dhe më e fshehtë, sepse informacioni i mbledhur nuk përdoret si provë në një hetim penal, kështu që mbledhja e saj mund të sanksionohet nga gjykata.

¹² Ibid. neni 30

¹³ Në përputhje me Ligjin e Punëve të Brendshme, neni 37, ministri me akt të sistematizimit i përcakton vendet e punës në të cilat të punësuarit në DSK me status të personave të autorizuar për siguri dhe kundërzbulim kanë dhe mund t'i përdorin autorizimet policore me kushte të përcaktuara me Ligjin e policisë.

¹⁴ Ibid. neni 37. Autorizimet policore rregullohen e Ligjin e policisë.

¹⁵ Ibid. Neni 22, paragrafi 2

¹⁶ [http://www.mvr.gov.mk/Upload/Editor_Upload/publikacii%20pdf/Organogram%20na%20MVR%20\(Celosen\)%20-%2014_10_2015-1.pdf](http://www.mvr.gov.mk/Upload/Editor_Upload/publikacii%20pdf/Organogram%20na%20MVR%20(Celosen)%20-%2014_10_2015-1.pdf)

2.2.3. Shërbimi për siguri ushtarake dhe zbulim (SHSUZ)

Ky shërbim (SHSUZ – Shërbimi për siguri ushtarake dhe zbulim) është i vendosur në kuadër të Ministrisë së Mbrojtjes (MM) dhe Armatës së Republikës së Maqedonisë (ARM), por Ligji për Mbrojtje nuk i referohet këtij shërbimi si një njësie të veçantë organizative. Megjithatë, ligji definon aktivitetet e zbulimit dhe kundërzbulimit për qëllime të mbrojtjes¹⁷, duke përfshirë:

- zbulimin dhe parandalimin e veprimeve të zbulimit dhe veprimeve të tjera subversive të shërbimeve të zbulimit dhe kundërzbulimit ushtarak të huaj, të kryera në vend ose jashtë vendit, që kanë për qëllim mbrojtjen e Republikës;
- zbulimi dhe parandalimi i të gjitha formave të veprimtarisë terroriste që synojnë mbrojtjen e Republikës;
- kryerjen e mbrojtjes kundër-zbuluese i detyrave dhe planeve, dokumenteve, mjeteve materiale dhe teknike, zonave dhe objekteve nga interesi i mbrojtjes.

SHSUZ është i përbërë nga një njësi brenda MM, Shërbimi i sektorit për siguri ushtarake dhe zbulim dhe pjesa e dytë janë tre sektorë në kuadër të njësive të ARM-së: J-2, S-2, A-2. Rregullat se si SHSUZ -ja kryen punën e vet janë të rregulluara me akte nënligjore që dalin nga neni 136 i Ligjit për Mbrojtje. Sektorët në ARM janë dyfishtë të nënshtuara: nën funksionin e komandës nën Shtatmadhorinë e ARM; dhe nga funksionet profesionale nën udhëheqësin e Shërbimit sektorial për siguri ushtarake dhe zbulim (gjithashtu Shefi i SHSUZ -së në përgjithësi).

Gjithashtu Shërbimi sektorial për siguri ushtarake dhe zbulim ka nëntë njësi, duke përfshirë: Njësine për planifikim dhe çështje të përgjithshme, Njësia për mbështetje, Njësia për CCIRM¹⁸, Njësia për zbulim 1, Njësia për zbulim 2, Njësia për kundërzbulim, Njësia për siguri, Njësia për siguri fizike Njësia për analitikë¹⁹. Nuk ka informata publike për personelin ndërsa buxheti i tyre është i përfshirë në buxhetin e MM. SHSUZ -ja nuk ka buxhet të ndarë dhe për të gjitha qëllimet financiare trajtohet si pjesë e buxhetit të MM-së. Personat e autorizuar nga SHSUZ -ja kanë të drejtë të mbledhin të dhëna, informata dhe njoftime²⁰.

Qendra për mbikëqyrje elektronike (QME)²¹ e ARM-së gjithashtu ka kompetenca për ndjekje të komunikimeve²², SHSUZ gjithashtu ka kompetenca për ndjekjen e komunikimeve, por vetëm në frekuenca të caktuara të radio valëve (Frekuencë e lartë (High Frequency- HF), Frekuencë shumë e lartë (Very High Frequency-VHF) dhe Frekuencë ultra të lartë (Ultra High Frequency UHF)) që janë specifike për nevojat e mbrojtjes. Në mënyrë hierarkie QME -ja nuk është pjesë e strukturës së SHSUZ -së, por një njësi ushtarake e varur drejtpërdrejtë nga Shtatmadhuria. SHSUZ koordinohet me QME-në, për qëllime profesionale, përmes Seksionit J-2 në Shtatmadhori.

Cilat shërbime dhe funksione të zbulimit funksionojnë aty?

Zbulimi i jashtëm ose i huaj - mbledhja, analiza dhe prodhimi i të dhënave të zbulimit të rëndësishme për sigurinë e jashtme të shtetit dhe paralajmërimi për kërcënimet e jashtme që afrohen;

Zbulimi i brendshëm ose vendor (shpesh të quajtur shërbime të sigurisë) - grumbullojnë dhe analizojnë të dhënat që lidhen me sigurinë e brendshme të shtetit dhe ruajtjen e rendit dhe sigurisë publike.

Zbulimi penal - prodhon informata për krimin e organizuar, korrupsionin dhe aktivitetet kriminale për të ndihmuar në zbatimin e ligjit.

Kundër-zbulimi - zbulimi dhe prishja e spiunazhit të kryer nga shërbimet e huaja të zbulimit që drejtohen kundër interesave të shtetit dhe popullatës së tij.

Zbulimi ushtarak ose i mbrojtjes - gjenerojnë informata relevante për planifikimin e mbrojtjes, mbrojtjen e personelit dhe bazave të forcave të armatosura dhe mbështetjen e operacioneve ushtarake; ata janë pjesë e forcave të armatosura dhe mandatet e tyre janë më të kufizuara sesa ato të shërbimeve civile

Qendra kombëtare të specializuara - përqendrohen në çështje të veçanta, siç është Qendra Kombëtare kundër Terrorizmit (QKKT);

¹⁷ Ligji për mbrojtje, numri 42/01, ndryshimet GZ 5/03, 58/06, 110/08, 151/11, 2015/15, Vendimi i Gjykatës Kushtetuese numër 37/2002 (GZ nr. 73/202) dhe Vendimi i Gjykatës Kushtetuese numër 37/2002 dhe 155/2001 (GZ 78/2002)

¹⁸ Koordinim, mbledhje dhe menaxhim me kërkesat për informacione

¹⁹ <http://morm.gov.mk/wp-content/uploads/2017/06/Organogram-juni-2017.pdf>

²⁰ Të punësuarit në SHSUZ (edhe në MM edhe në ARM) janë persona zyrtar të autorizuar me autorizime të saktësuara në Ligjin për Mbrojtje, nenet 133, 134, 136

²¹ Qendra për vëzhgim elektronik (QVE)

²² Neni 4, pika 7 nga Ligji për ndjekjen e komunikimeve, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", numër 71/18

2.2.4. Agjencia operative- teknike (AOT)

Reforma legjislativ e sistemit të ndjekjes së komunikimeve të miratuara në prill 2018, krijoi një Agjenci Operative-Teknike (AOT) si një organ shtetëror i ndarë dhe i pavarur. AOT-i duhet të ketë rol teknik, duke lehtësuar lidhjen midis organeve të autorizuar dhe ofruesve²³ të shërbimeve, ekskluzivisht në bazë të një urdhri gjyqësor (neni 2 i ligjit mbi AOT-in). Kërkesat për një “urdhër” të përgjimit do të aprovohen radhazi nga prokurori publik, nga gjyqtari, dhe pastaj i kalojnë AOT-it i cila mbikëqyr operatorët dhe i bën informatat e përgjuara në dispozicion për agjencitë²⁴. AOT-i nuk ka mundësinë për t’iu qasur përmbajtjes së komunikimeve të përgjuara.

Hapi i madh përpara në krijimin e AOT-it është fakti se aftësia teknike për t’u angazhuar në mbikëqyrje largohet nga agjencia përgjegjëse për grumbullimin dhe analizimin e zbulimit. DSK-ja nuk duhet të ketë qasje të drejtpërdrejtë në telekomunikacionet në sistemin e ri. Ky rregullim institucional parandalon përqendrimin e fuqisë në një institucion, duke lehtësuar kështu llogaridhënien. AOT-i është e dizajnuar si “amortizator” midis organeve të autorizuar për të përdorur përgjimet dhe operatorët e shërbimeve dhe me këtë po kryen funksionin për mbikëqyrje eksperte brenda sistemit të përgjimit.

AOT-i gjithashtu i nënshtrohet mbikëqyrjes të kryer nga kuvendi dhe organet e tjera mbikëqyrëse. Mbikëqyrësit do të duhet të sigurohen që AOT-i të ngel vetëm agjenci teknike dhe e lirë nga ndikimet dhe presionet e jashtme. Rekrutimi, kontrolli dhe mbikëqyrja e zyrtarëve të AOT-it do të duhet të jenë të fuqishme me qëllim që të shmangin vazhdimësinë potenciale të praktikave dhe mentaliteteve të kaluara të keqpërdorimit. Duhet ti kushtohet kujdes zhvillimit të nën ligjeve, rregullave, standardeve profesionale, kodeve të sjelljes dhe trajnimit personal. Mbikëqyrja e ndërhyrjes në komunikime duhet t’i kushtojë vëmendje të veçantë një numri të dispozitave ligjore zbatimi i të cilave mund të rrisë sfidat për llogaridhënie:

- Mjetet dhe pajisjet speciale teknike që mundësojnë ndjekjen e komunikimeve (siç janë Kapësi IMSI, ndërhyrje në Wi-fi etj.) do të mbahen nga prokurori publik; përdorimi i këtyre pajisjeve duhet të monitorohet nga mbikëqyrës dhe eventualisht të rregullohet më shumë (LNK, neni 17)
- Ligji (LNK, neni 18) i referohet bashkërisht metodave të ndryshme për ndjekje të cilat duhet të rregullohen ndaras, pasi që niveli i ndërhyrjes është i ndryshëm, ndërsa disa kanë për funksion të mundësojnë funksionimin e të tjerave. (siç është hyrja në hapësirat private për të vendosur pajisje për audio dhe video regjistrime).
- Ekzistojnë dy përjashtime të rëndësishme për procesin e përgjithshëm të mbikëqyrjes: e para DSK-ja, SHSUZ (MM) dhe QZE (Armatë) mund të kërkojnë nga operatorët drejtpërsëdrejti mega të dhënat (LNK, neni 33) dhe gjithashtu mund të kryejnë ndjekjen e tyre pa referim të gjyqit ose AOT-it (neni 34). Kjo nuk përputhet me standardet aktuale evropiane të vendosura nga jurisprudenca e GJEDNJ-së dhe GJED-it.

2.3. Sistemi maqedonas i mbikëqyrjes së shërbimeve të zbulimit

Ekzistojnë nivele të ndryshme të kontrollit dhe mbikëqyrjes që kontribuojnë në sigurimin e llogaridhënies së shërbimeve të zbulimit. Ato janë komplementare dhe përforcojnë njëra tjetrën, dhe defektet në një nivel kanë potencialin të ndikojnë në të gjithë sistemin. Ky kapitull do të prezantojë shkurtimisht parimet kryesore që shpjegojnë një shtresë të veçantë të kontrollit dhe mbikëqyrjes dhe pastaj do të shqyrtojë dispozitat ligjore më relevante që përcaktojnë atë shtresë në Republikën e Maqedonisë.

²³ Në Maqedoni për momentin ka tetë trupa të cilat janë të autorizuar të përdorin metoda ndërhyrëse për mbledhjen e informative, që i nënshtrohen mbikëqyrjes së parlamentit: AZ, DSK, njësitë hetimore penale të policisë, policia financiare, Dogana, SHSUZ (Mbrojtje, ARM/QZE (Armata), AOT

²⁴ Ka dy përjashtime të rëndësishme nga ky proces i përgjithshëm i mbikëqyrjes: së pari DSK-ja, SHSUZ (Mbrojtje) dhe QZE (Armatë) mund të pyes operatorët drejtpërsëdrejti për meta të dhëna (neni 33 i Ligjit për ndjekje të komunikimeve) dhe mund të kryejnë gjithashtu përgjim pa u thirrur te gjyqi apo AOT-i (neni 34).

Kush është përgjegjës për kërkimin e llogaridhënies në sektorin e zbulimit?

1. **Kontrolli i brendshëm** - duke drejtuar zyrtarët dhe mekanizmat e kontrollit të brendshëm dhe të revizionit. Mbështetet në urdhrat e përhershëm, rekrutimin, trajnimin, koordinimin e stafit (duke përfshirë mekanizmat për mbrojtjen e të drejtave të oficerëve dhe disiplinimin e individëve).
2. **Kontrolli ekzekutiv** - nga ministrat përkatës dhe zyrtarët ekzekutivë. Bazuar në politikat, direktivat, prioritetet, përgjegjësinë ndaj kuvendit.
3. **Mbikëqyrja parlamentare** - nga komisionet përkatëse të mbikëqyrjes. Në bazë të ligjeve, procedurave parlamentare, aktiviteteve të mbikëqyrjes, miratimit dhe rishikimit të buxhetit të shtetit.
4. **Shqyrtimi gjyqësor** - nga një gjyqësor i pavarur. Përfshin autorizimin e kompetencave të posaçme ndërhyrëse dhe gjykimin e shkeljeve të pretenduara të ligjit.
5. **Mbikëqyrja e jashtme** - nga mediet dhe shoqëria civile. Bazuar në hetime, kërkime të pavarura, debate publike të alternativave të politikave dhe prioritetëve.

2.3.1. Dispozitat ligjore për kontrollin e brendshëm

Drejtorja e brendshme kontrollon aktivitetet e përditshme të shërbimeve të zbulimit dhe siguron që zyrtarët e zbulimit të kryejnë punën e tyre në mënyrë efektive në përputhje me ligjin përkatës kombëtar dhe ndërkombëtar. Vlerat, etika dhe njohuritë ligjore të personelit të zbulimit janë me rëndësi të madhe.

- Drejtorja e brendshme duhet të promovojë një kulturë të llogaridhënies dhe profesionalizmit, duke filluar me proceset efektive të rekrutimit dhe trajnimit; ata gjithashtu koordinojnë proceset për vlerësimin e punës së stafit. Drejtuesit duhet të zbatojnë kriteret e fuqishme të përzgjedhjes për të siguruar punësimin e personave me vlera të përshtatshme; gjithashtu duhet të sigurojnë trajnim të vazhdueshëm, ku do përfshihen edhe çështjet nga fusha e të drejtave të njeriut dhe rolin e mbikëqyrjes - për të ngritur vetëdijen dhe gatishmërinë për të bashkëpunuar me organet e jashtme të mbikëqyrjes.
- Drejtuesit emërohen për një mandat të caktuar për t'i mbrojtur ata nga presioni politik ose ndryshimet në qeveri; mund të shkarkohen nga detyra vetëm nëse shkelin rregullat të veçanta.
- Inspektorët e brendshëm vlerësojnë ligjshmërinë e aktivitetit të shërbimit dhe alarmojnë ekzekutivin për çdo problem individual ose sistemor.

Kontrolli i brendshëm zakonisht përkufizuar shkurtimisht nga ligjet, duke u zhvilluar më tej me aktet nënligjore dhe rregulloret e brendshme siç janë procedurat e caktimit të detyrave, raportimit dhe vlerësimit të veprimeve të zbulimit, ose kodet e sjelljes dhe standardet profesionale. Informacionet publike në dispozicion për mekanizmat dhe procedurat e kontrollit të brendshëm në shërbimet maqedonase të zbulimit janë të pakta.

- **Ligji për Punë të Brendshme** parasheh një njësi të veçantë organizative përgjegjëse për vlerësimin e ligjshmërisë në punën e punonjësve të Ministrisë së Punëve të Brendshme. Sektorin për Kontroll të Brendshëm, Hetime Penale dhe Standardet Profesionale vepron ex-officio në lidhje me informacionin e mbledhur nga ankesat e qytetarëve, dokumentacionin e brendshëm dhe informatat nga punonjësit e MPB-së; mund të veprojë edhe në bazë të një urdhri nga ministri i Punëve të Brendshme. Sektori kryesisht ka të bëjë me sjelljen e keqe të policisë; nuk ka të dhëna publike për përfshirjen e tyre në DSK. Për fat të keq, asnjë nga aktet nënligjore që konkretisht ka të bëjë me DSK-në nuk janë në dispozicion të publikut.
- **Ministria e Mbrojtjes** kryen kontrollin e brendshëm përmes inspektorëve të përgjithshëm që kontrollojnë përputhshmërinë e punës së të punësuarve me ligjet përkatëse.
- **Ligji për Agjencinë e Zbulimit** nuk ka dispozita që rregullojnë kontrollin e brendshëm.

Komisionet parlamentare kanë përgjegjësinë të shqyrtojnë këto politika, mekanizma dhe praktika të brendshme. Edhe sikur këto të bazohen në urdhrat e pushtetit ekzekutiv të klasifikuara dhe procedurat e brendshme, komisioneve të

mbikëqyrjes duhet doemos t'u lejohet qasja në këto dokumente.

Një mënyrë e rëndësishme që kuvendi të ndikojë në kontrollin e brendshëm është të mund të jap mendimin e tij për emërimin e drejtorëve të shërbimit. Në disa vende pushteti ekzekutiv konsultohet me partitë e opozitës dhe / ose me komisionet parlamentare përpara emërimit të drejtorëve. Kuvendi mund të bëjë pyetje rreth kandidatit ose t'i ftojë ata për një seancë dëgjimore. Kjo ndihmon në parandalimin që pushteti ekzekutiv të emërojë persona që mbrojnë ose promovojnë interesat e tyre politike.

Cili është dallimi midis kontrollit dhe mbikëqyrjes?

Kontrolli i referohet kompetencës për të drejtuar politikën dhe aktivitetet e një organizate, për shembull duke i vendosur rregullat, kodet ose politikën që përcaktojnë se si funksionon një organizatë.

Mbikëqyrja nënkupton verifikimin nëse respektohen rregullat dhe ligjet dhe zbatohen kodet dhe politikën.

Mbikëqyrja mund të ndërmerret nga shumë aktorë dhe institucione të ndryshme, ndërkohë që kontrolli është kryesisht përgjegjësi e udhëheqjes dhe pushtetit ekzekutiv.

2.3.2. Kontrolli nga pushteti ekzekutiv

Autoriteti i fundit dhe legjitimiteti i veprimtarisë së shërbimeve të zbulimit mbështetet në miratimin parlamentar të kompetencave, mandatit dhe shpenzimeve të tyre. Por për arsye praktike dhe për shkak të natyrës së ndjeshme dhe urgjencës së punës së zbulimit, kontrolli efektiv dhe ditor qëndron brenda qeverisë. Pushteti ekzekutiv politik është klienti, drejtuesi i detyrës, kontrolluesi dhe mbikëqyrësi kryesor i shërbimeve të zbulimit. Ata vendosin politikën dhe prioritetet kryesore për shërbimet e zbulimit, shpërndajnë burimet, formulojnë direktivat, rregulloret dhe udhëzimet për aspekte të ndryshme të punës së zbulimit, duke filluar nga shkëmbimi i informacionit me partnerët e huaj deri te përdorimi i masave ndërhyrëse për mbledhjen e informacionit. Si konsumatorë kryesorë të shërbimeve të zbulimit, pushteti ekzekutiv duhet të ofrojë udhëzime rreth asaj se cilat produkte të zbulimit iu nevojiten dhe duhet të japin qëndrimin e tyre ndaj raporteve të dorëzuara nga shërbimet e zbulimit. Mungesa e reagimit nga ta, mund të rezultojë me produkte joadekuate të zbulimit.

Strukturat qeveritare janë të pajisura për të drejtuar dhe koordinuar shërbimet e zbulimit në kohë reale. Ministrat përgjegjës kanë nevojë për një shkallë të mjaftueshme kontrolli mbi shërbimet e zbulimit dhe të drejtën për të kërkuar informacion prej tyre. Megjithatë, kontrolli efektiv i pushtetit ekzekutiv nuk nënkupton përgjegjësi të drejtpërdrejtë udhëheqëse për operacionet e zbulimit. Ekziston nevoja për të vendosur balancën e duhur në marrëdhëniet ndërmjet pushtetit ekzekutiv dhe shërbimeve të zbulimit:

- Kontrolli dhe ndikimi i tepërt i pushtetit ekzekutiv në punën e shërbimeve të zbulimit mund të çojë në keqpërdorimin e shërbimeve për interesa politike.
- Kontrolli i pamjaftueshëm i pushtetit ekzekutiv krijon rrezikun e keqpërdorimit të kompetencave dhe burimeve të zbulimit nga individët brenda shërbimeve, për interesat e tyre personale.

Cilat organe janë përgjegjëse për kontrollin ekzekutiv të inteligjencës?

- Ministrinë me portofol më të gjerë, siç janë mbrojtja, çështjet e brendshme, gjyqësori, për shërbimet e zbulimit të organizuara si departamente në një ministri
- Kryeministri (p.sh. në Turqi)
- Kryetari (p.sh. në Rumani)
- Organ i përbashkët nga kryetari dhe kryeministri (p.sh. në Kroaci, Sllovenia).
- Një trup kolektiv siç është Këshilli i Sigurisë Kombëtare (p.sh. Kroacia, Rumania, Serbia).

Në Republikën e Maqedonisë, si në të gjitha vendet e tjera, pushteti ekzekutiv (duke përfshirë Kryetarin e Republikës dhe Qeverinë) janë përfituesit kryesorë të punës së shërbimeve të zbulimit. Shërbimet mbledhin dhe analizojnë informacionin rreth kërcënimeve të zbuluara kundër shtetit dhe popullatës së tij. Ata këtë informacion ia japin qeverisë, duke i mundësuar asaj që të zhvillojë dhe zbatojë politikën e sigurisë. Llogaridhënia kërkohet nëpërmjet akteve nënligjore dhe rregulloreve të brendshme; megjithatë, ka pak informacion publik që lejon një vlerësim përkatës se si zbatohet në realitet kontrolli ekzekutiv.

- Shërbimi i kundërzbulimit (DSK) dhe zbulimi ushtarak janë vendosur brenda ministrive përkatëse dhe i përgjigjen përkatësisht Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Ministrisë së Mbrojtjes.
- Qeveria cakton dhe shkarkon Drejtorin e DSK-së, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme.
- AZ-ja i raporton drejtpërdrejt Kryetarit të Republikës së Maqedonisë, i cili ka të drejtë të emërojë dhe shkarkojë drejtorin e saj. Qeveria ka kompetenca të forta në lidhje me AZ-në pasi që përcakton metodat dhe mjetet e operimit të AZ-së dhe mban gjithashtu drejtorin e AZ-së përgjegjës, por ligji nuk specifikon se si²⁵. Nga ana tjetër, Drejtori ka autonomi të plotë mbi masat që duhen përdorur - nuk ka dispozitë ligjore për kontroll paraprak nga ministri. Metodot specifike të përdorura në një operacion duhet të jenë të klasifikuara, por nuk ka asnjë arsye pse ligji nuk duhet të specifikojë në terma të përgjithshëm cilat janë metodat që janë "të parapara".

Sfida specifike për mbikëqyrjen dhe kontrollin e shërbimeve të zbulimit në kontekst të vendeve në tranzicion:

Shërbimet e zbulimit janë një element thelbësor në ruajtjen e regjimeve autoritare ose totalitare, që do të thotë se mund të paraqesin sfidë të veçantë kur ato transferohen në demokraci të reja:

- Informacioni i mbledhur nën regjimin e mëparshëm mund të përdoret për shantazh, zhvatje ose manipulim politik.
- Kërkimi i drejtësisë për abuzimet në të kaluarën mund të nxisë interesat e fuqishëm për të penguar tranzicionin politik.
- Mosndëshkimi për abuzimet e mëparshme mund të cenojnë institucionet e reja politike veçanërisht nëse personeli i regjimit të mëparshëm mbetet në detyrë.
- Zyrtarët qeveritarë, përfaqësuesit e zgjedhur, shoqëria civile dhe mediet në shtetet në tranzicion mund të jenë të paaftë ose të gatshëm për të kontrolluar shërbimet e zbulimit.
- Mungesa e një kuadri ligjor për mbikëqyrjen dhe kontrollin demokratik, fragmentimi i shërbimeve dhe mandatet e gjera të shërbimeve të inteligjencës vështirësojnë mbikëqyrjen.

Mbikëqyrja parlamentare varet nga kontrolli ekzekutiv. Mbikëqyrësit duhet të parandalojnë ndikimin e tepërt ekzekutiv që çon në politizim jo të duhur të shërbimeve, por në anën tjetër ata duhet të sigurojnë që ekzekutivi të ketë kompetenca dhe mjete të qarta ligjore për të ushtruar kontroll efektiv mbi punën e inteligjencës. Ministrat mund të thirren që të japin llogari për veprimet e shërbimeve të sigurisë vetëm nëse ata kanë fuqi reale të kontrollit dhe informata adekuate për veprimet e ndërmarra nga shërbimet.

²⁵ Ligji për AZ, neni 4

Cilat janë sfidat tipike për mbikëqyrjen demokratike të shërbimeve të zbulimit?

Fshehtësia: menaxhimi, kontrolli dhe mbikëqyrja e një burokracie të madhe qeveritare është më e ndërlikuar kur ka nevojë për fshehtësi. Institucionet e pavarura, por të ndërlidhura me mbikëqyrje me mandate të qarta për qasje në informata mund të ndihmojnë në kapërcimin e këtij problemi.

Liria e veprimit (Diskrecioni): profesionistët e inteligjencës zakonisht kanë liri veprimi (të drejtë diskrecionale) për të marrë vendime të pavarura gjatë punës së tyre. Mbikëqyrja efektive e tyre është e gjatë dhe e vështirë.

Vullneti politik: për shkak të nivelit të fshehtësisë në shërbimet e zbulimit, llogaridhënia e tyre nuk është domosdoshmërisht e dobishme për të fituar e vota. Prandaj, përfaqësuesit e zgjedhur mund të mos jenë të motivuar për të investuar kohën e tyre në mbikëqyrjen e shërbimeve të zbulimit. Sado elegante të jetë struktura e mbikëqyrjes, ajo do të jetë e efektshme vetëm nëse mbikëqyrësit punojnë shumë.

Perceptimet e ekzagjeruar të kërcënimeve: kërcënimet e perceptuara ndaj sigurisë kombëtare mund të përdoren për të justifikuar veprimet që mund të jenë jo-proporcionale me kërcënimin dhe dëmtimin e parimeve të qeverisjes demokratike, të të drejtave të njeriut dhe sundimit të ligjit. Profesionalizmi i lartë, pavarësia politike dhe mbikëqyrja efektive janë të nevojshme për të siguruar që analiza e shërbimeve të zbulimit mos e tejkalon ose nënvlerëson rrezikun e një kërcënimi për sigurinë kombëtare.

Shtrirja ndërkombëtare: bashkëpunimi ndërkombëtar i shërbimeve të zbulimit shtrin kompetencat dhe aktivitetet e shërbimeve kombëtare të zbulimit përtej fushëveprimit të sistemeve kombëtare të kontrollit dhe mbikëqyrjes. Fuqitë mbikëqyrëse nuk arrijnë përtej juridiksionit kombëtar, por përcaktimi i fushës dhe natyrës së bashkëpunimit ndërkombëtar mund të parandalojë abuzimet dhe të rrisë besueshmërinë e shërbimeve kombëtare të zbulimit.]

Teknologjia: teknologjitë e përdorura në punën e shërbimeve të zbulimit përparojnë më shpejt se mandatet dhe kompetencat për mbikëqyrjen dhe kontrollin e tyre, që rezultojnë me mangësi në llogaridhënie. Ekspertët teknikë mund t'u sigurojnë organeve të mbikëqyrjes informacione vendimtare, ndërsa ligjvënësit duhet të sigurojnë që kornizat ligjore t'i ndjekin hap pas hapi këto ndryshime.

2.3.3. Mbikëqyrja nga ana e Kuvendit

Mbikëqyrja e shërbimeve të zbulimit është njëra nga fushat më të reja²⁶ dhe më sfiduese të punës parlamentare. Në shumë vende demokratike sot, është e pranueshme që të gjitha aktivitetet shtetërore të jenë të hapura për shqyrtim dhe hetim nga ana e kuvendit. Shërbimet e zbulimit nuk janë përjashtim nga ky rregull edhe pse shpesh zbatohen restriksione dhe kufizime në informatat që jepen për mbikëqyrësit.

Cila është shtrirja e mbikëqyrjes së agjencive të zbulimit?

- **Ligjshmëria** – I referohet harmonizimit me të gjitha dispozitat e zbatueshme ligjore nga ligjet primare dhe sekondare të shtetit dhe në kuadër të standardeve që dalin nga konventat ndërkombëtare dhe i ashtuquajturit *soft law* (ligji i butë)- (siç janë vendimet nga gjykatat ndërkombëtare, kodi i sjelljes, rezolutat, rekomandimet etj.).
- **Efektiviteti**– I referohet shkallës deri tek e cila shërbimi arrin synimet e përkufizuara nga politika qeveritare (siç është të mbahen kërcënimet nën një nivel të caktuar).
- **Efikasiteti** – I referohet asaj se si po përdoren kapacitetet financiare dhe njerëzore në një mënyrë ekonomike optimale, në kryerjen e mandatit të një shërbimi.

Komisionet e përhershme të specializuara për mbikëqyrje të agjencive të zbulimit janë krijuar në shumicën e vendeve evropiane. Në një analizë krahasuese të kuvendeve në tërë Evropën, asnjë fushë tjetër e mbikëqyrjes parlamentare nuk është emëruar, organizuar dhe ka mandat në mënyrë kaq të ndryshme me një detyrë. Në thelb, ekzistojnë tre qasje në

²⁶ Siguria kombëtare në përgjithësi dhe zbulimi në veçanti, janë perceptuar si fushë ekskluzive e kompetencës për pushtetin ekzekutiv, ndërsa organet legjislative dhe gjyqësore kanë shtyrë ndërhyrjen. Vetëm në vitet '90, pas përfundimit të luftës së ftohtë, mbikëqyrja parlamentare e zbulimit është bërë normë dhe parakusht i demokracisë.

ngritjen e mbikëqyrjes së agjencive të zbulimit, duke u zhvilluar në drejtim të rritjes së specializimit dhe ndërlikimit në aspekti organizativ.

- 1) **Komisionet për mbrojtje dhe siguri.** Në disa shtete, një komision me një mandat të gjerë merret me legjislacionin dhe mbikëqyrjen për tërë sektorin e sigurisë, duke përfshirë këtu edhe shërbimet dhe sektorët e zbulimit; kjo qasje mundëson që anëtarët të zhvillojnë një kuptim më gjithëpërfshirës të sektorit të sigurisë dhe të integrojnë mirë proceset legjislative dhe mbikëqyrëse. Ky është rasti sot në shtetet siç janë Shqipëria, Mali i Zi, Moldavia të cilat kanë një sektor sigurie relativisht të vogël, por para një apo dy dekadash, kjo ishte qasja e shumicës së shteteve demokratike dhe atyre në tranzicion.
- 2) **Komisionet për mbikëqyrje të agjencive të zbulimit.** Një shumicë e madhe e kuvendeve evropiane kanë krijuar (krahas komisioneve të mbrojtjes dhe sigurisë) organe të specializuara punuese që merren ekskluzivisht me mbikëqyrjen e agjencive të zbulimit. Ata kanë një mandat të ngushtë, të fokusuar mbikëqyrës, kështu që anëtarët dhe personeli i zgjedhur të mund të shfrytëzojnë më së miri kohën dhe resurset që të zhvillojnë ekspertizë më shpejtë dhe më mirë. Ndonjëherë mandati i këtyre komisioneve është vetëm mbikëqyrës, duke i kufizuar kështu përgjegjësitë e tyre në procesin legjislativ.
- 3) **Organet eksperte jashtë kuvendit.** Një numër në rritje i shteteve po krijojnë organe eksperte për mbikëqyrje të agjencive të zbulimit, krahas komisioneve parlamentare. Anëtarët janë figura publike më në moshë, pjesëtarë të shquar të shoqërisë civile, anëtarë të tanishëm dhe të mëparshëm të gjyqësorit apo politikan të mëparshëm. Ata më së shpeshti kanë mandat për të mbikëqyrur punën e shërbimeve të zbulimit dhe respektimin e të drejtave të njeriut, por mandati i tyre mundet gjithashtu të përfshijë monitorimin e efikasitetit të operacioneve, praktikave administrative apo përdorimin e metodave ndërhyrëse për mbledhjen e informatave. Këto organe zakonisht janë të emëruara nga kuvendi dhe i raportojnë kuvendit dhe/apo pushtetit ekzekutiv. Belgjika, Kroacia, Gjermania, Greqia, Norvegjia dhe Suedia janë shembuj të tillë.

Strukturat e krijuara brenda Kuvendit të Maqedonisë dhe me mandat për të siguruar llogaridhënien e shërbimeve të zbulimit ilustrojnë evolucionin e njëjtë drejtë specializimit dhe ndërlikimit institucional në mbikëqyrjen e këtyre shërbimeve.

- 1) Një komision i mbrojtjes dhe sigurisë me kompetenca të përgjithshme legjislative dhe mbikëqyrëse mbi sektorin e sigurisë është përgjegjës për mbikëqyrjen e zbulimit ushtarak në kuadër të Ministrisë së Mbrojtjes.
- 2) Një komision i specializuar për mbikëqyrjen e shërbimeve të zbulimit mbikëqyr dy shërbimet kryesore - Drejtorinë e Sigurisë dhe Kundërzbulimit nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe Agjencinë e pavarur të zbulimit. Një komision i tretë parlamentar ka një mandat mbikëqyrës shumë preciz dhe të specializuar, që monitoron zbatimin e metodave ndërhyrëse për qëllim të mbledhjes së informatave.
- 3) Ligji i ri për përgjimin e komunikimeve i miratuar në prill 2018 sjell një institucion të ri në sistemin e mbikëqyrjes: një organ civil jashtë kuvendit (Këshilli qytetar për mbikëqyrje), i cili pranon ankesat dhe mbikëqyr ligjshmërinë e përgjimeve.

Autoriteti ligjor²⁷ i organeve mbikëqyrëse është parakushti i parë për mbikëqyrje efektive të shërbimeve të zbulimit. Autoriteti ligjor i tre komisioneve parlamentare të Maqedonisë mbështetet në (1) dispozitat e përgjithshme ligjore që rregullojnë mbikëqyrjen parlamentare dhe (2) dispozitat specifike që rregullojnë mbikëqyrjen e shërbimeve të zbulimit.

(1) Baza juridike e mbikëqyrjes parlamentare përcaktohet në **Kushtetutën** e Republikës së Maqedonisë, e cila shkruan: "Kuvendi kryen monitorim politik dhe mbikëqyrje të Qeverisë dhe bartësve të tjerë të funksioneve publike që i përgjigjen Kuvendit".²⁸ **Ligji mbi Kuvendin** ka një kapitull të veçantë për "Mbikëqyrje parlamentare", që rregullon seancat e shqyrtimit si mjetin kryesor për mbikëqyrje.

Rregullorja e punës së Kuvendit është dokumenti më i hollësishëm ligjor që rregullon të drejtat dhe obligimet e deputetëve, duke përfshirë të drejtën për informim, përdorimin e pyetjeve të deputetëve dhe interpelancën si mjete për mbikëqyrje, punën me informata të besueshme dhe procedura për përzgjedhje të organeve punuese. Sidoqoftë,

²⁷ Shtojca 1 rishikon fragmentet përkatëse të ligjeve që u japin komisioneve parlamentare autoritetin ligjor për mbikëqyrje të shërbimeve të zbulimit.

²⁸ Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, neni 68

këto dispozita të përgjithshme nuk i referohen drejtpërsëdrejti komisioneve për mbikëqyrje të shërbimeve të zbulimit. Megjithatë, disa nga to janë mjete të rëndësishme të cilat mund të përdoren në mënyrë pro-aktive nga ana e deputetëve. Për shembull, në rastet kur zyrtarët publik nuk paraqiten pasi që janë ftuar për të marrë pjesë në seancat e komisioneve, apo kur komisionet nuk mbahen për çfarëdolloj arsyeje, deputetët mund të kryejnë mbikëqyrjen me anë të parashtrimit të pyetjeve të deputetëve në seancat plenare. Pasi që deputetët nga komisionet mbikëqyrëse kanë certifikatë sigurie, ata mund të kërkojnë një përgjigje me shkrim në rast se përgjigja përmban informata të klasifikuara.

(2) krahas këtyre dispozitave të përgjithshme të cilat kanë të bëjnë me kuvendin në tërësi, mbikëqyrja e aktiviteteve të shërbimeve të zbulimit, nga ana e komisioneve parlamentare përkatëse, është e përshkruar shkurtimisht në disa ligje.

- Neni 11 i Ligjit për Agjencinë e Zbulimit përcakton që “drejtori është përgjegjës për të mundësuar njohuri dhe për të ofruar të gjitha informatat dhe të dhënat që janë në kuadër të fushëveprimit të komisionit”.
- Neni 42 paragrafi 1 i Ligjit për Punë të Brendshme parasheh që “Me kërkesë të komisionit parlamentar, Drejtoria do të mundësojë njohuri dhe do t'i sigurojë komisionit raportet, informatat dhe të dhënat e nevojshme që kanë të bëjnë me punën e tij”.
- Të dyja shërbimet janë të obliguara të dorëzojnë raport vjetor mbi punën e tyre deri te komisioni. DSK-ja gjithashtu dorëzon programin vjetor të punës²⁹.

Mandati i komisioneve parlamentare d.m.th. “fushëveprimi i punës së tyre” definohet me vendim të Kuvendit në fillim të çdo legjislature të re. Sipas këtij burimi të autoritetit ligjor³⁰, **komisioni për mbikëqyrje të shërbimeve të zbulimit** (për DSK-në dhe AZ-në) ka një mandat të fuqishëm mbikëqyrës, duke përfshirë respektimin e ligjit në ushtrimin e autoritetit të shërbimeve, respektimin e të drejtave të njeriut si dhe metodat dhe mënyrat e përdorura nga ana e shërbimeve dhe mjetet financiare, personelin dhe AOT teknike. Shërbimet kanë obligimin për të siguruar informatat e nevojshme për realizimin e mandatit mbikëqyrës të komisionit.

Ligji për ndjekjen e komunikimeve i miratuar në prill të vitit 2018, sqaron dhe përforcon autoritetin ligjor të kuvendit në **mbikëqyrjen e ndjekjes së komunikimeve**. Komisioni parlamentar i cili ka mandat me këtë detyrë është i definuar me këto karakteristika:

Përbërja. Komisioni kryesohet nga deputet i opozitës (neni 38); dhënia e rolit udhëheqës opozitës, në mbikëqyrje, konsiderohet si praktikë e mirë për të krijuar llogaridhënien e aktiviteteve qeveritare të cilat kryhen në fshehtësi, ku keqpërdorimi dhe përdorimi arbitrar i pushtetit është i lehtë.

Mandati. Komisioni është i autorizuar që të mbikëqyr ligjshmërinë dhe efikasitetin (neni 40) në përdorimin e përgjimeve. *Ligjshmëria* duhet të vlerësohet me anë të krahasimit të të dhënave statistikore nga ana e operatorëve të shërbimeve, AOT-i dhe organet e tjera të autorizuara në zbatimin e përgjimeve (neni 41-3). Komisioni mund të kryejë mbikëqyrjen pa paralajmërim paraprak, kur është e nevojshme dhe së paku njëherë në tre muaj edhe në mungesë të shumicës së votave (neni 44). Këto dispozita do të duhej të ndihmojnë në krijimin e një klime të llogaridhënies dhe praktikës së rregullt për mbikëqyrje. Duhet t'u kushtohet vëmendje disa dispozitave ligjore, interpretimi dhe zbatimi i mëtejshëm i të cilave janë të rëndësishme për përcaktimin e fushëveprimit të ardhshëm të mbikëqyrjes:

- Derisa ligjshmëria i referohet përgjimeve të zbatuara për hetimet penale (policia gjyqësore, neni 7) dhe gjithashtu për arsye të sigurisë dhe mbrojtjes (nga ana e DSK-së dhe MM-së, neni 18), efikasiteti duket se i referohet vetëm përgjimeve në raste të hetimeve penale, pasi që ky synim i mbikëqyrjes duhet të arrihet përmes analizës së raportit të Prokurorit publik (neni 40 (3)).
- Për të rishikuar efikasitetin e përgjimeve të zbatuara për qëllime të sigurisë dhe mbrojtjes kombëtare, komisionit do t'i duheshin burime më të ndryshme dhe komplekse të informimit. Në kuptimin e fjalëpërfjalshëm të ligjit, mbikëqyrja duket se ka të bëjë kryesisht me sigurimin se masat dhe proceset hetimore janë zbatuar siç duhet; mbikëqyrja për këtë arsye synon kryesisht sferën funksionale të zbulimit, por kjo nuk përjashton mundësinë e përfshirjes në mbikëqyrjen e aktiviteteve operative dhe efikasitetin e tyre.

Qasja deri tek ekspertiza. Ligji përcakton (neni 39) që jo më vonë se 50 ditë pasi që të jetë krijuar, komisioni do të angazhojë dy ekspertë për mbështetje të përhershme teknike; brenda 6 muajsh, komisioni duhet të krijojë regjistër të

²⁹ Ligji për Agjencinë e zbulimit, neni 10; Ligji i punëve të brendshme, neni 61

³⁰ Vendimi i Kuvendit nr. 08-1396/1 nga 31 maj 2017

ekspertëve vendor dhe të jashtëm për të siguruar mbështetje nga rasti në rast. Ligji përcakton detyrimin e agjencive të tjera shtetërore për të ofruar mbështetje profesionale me kërkesë të komisionit. Këto janë masa të veçanta që kanë për qëllim që të rrisin ekspertizën e komisionit dhe të zgjerojnë aftësinë e tij për t'u angazhuar në mbikëqyrje efektive. Ekspertiza e pamjaftueshme në çështjet e zbulimit është njëri nga problemet më të mëdha në mbikëqyrje, në çdo shtet. Ligji i siguron komisionit disa mënyra të ndryshme për zgjidhjen e këtij problemi dhe duke përcaktuar afate të ngushta për përdorimin e ekspertizës, ajo detyron komisionin që të ndërmarrë veprime dhe të trajtojë këtë çështje.

Qasja deri tek informatat. Të dhënat mbi të cilat ka qasje komisioni me qëllim të përmbushjes së mandatit të tij mbikëqyrës e që janë lidhur me *ligjshmërinë* janë të cekura në nenin 41-3. Komisioni do të mund të kontrollojë numrin e autorizimeve të dhëna dhe llojin e vëzhgimit që është përdorur. Duke supozuar se dokumentacioni në të cilin ka qasje komisioni përmban indikacione të tilla specifike, mund të jetë gjithashtu në gjendje të kontrollojë se për çfarë shkeljesh janë përdorur lloje të ndryshme të vëzhgimit. Ky lloj i mbikëqyrjes është i rëndësishëm pasi që mund të shërbejë për të ri-siguruar politikanët në Kuvend se mbikëqyrja nuk po del jashtë kontrollit.

- Megjithatë, komisioni duhet të përpiket që të merr informata të cilat përkojnë me përgjegjësitë e mbikëqyrjes lidhur me efikasitetin e përgjimeve. Kjo do të thotë se duhet të shkojë më tej pas "gjurmës së letrës" dhe krahasimit të të dhënave statistikore dhe të zhvillojë aftësi të mjaftueshme për gjetjen e fakteve për të hetuar sjelljen dhe regjistrimet e agjencive përkatëse.
- Qasja deri tek informatat e klasifikuara (neni 37) parasheh që anëtarët e organit mbikëqyrës "do të jenë në posedim të një certifikate sigurie me shkallë të përshtatshme për qasje në informacione të klasifikuara" dhe një certifikatë e tillë do të lëshohet brenda 30 ditëve. Në varësi të asaj se saktësisht cili nivel informacioni duhet të shqyrtohet dhe veçanërisht nëse kjo përfshin informata operative, këto duket të jenë jashtëzakonisht të shkurtra dhe ndoshta me afate kohore tejet ambicioze për të siguruar verifikimin dhe miratimin e certifikatave të sigurisë.

Raportimi. Aty ku zbulohen parregullsitë, komisioni duhet të informojë prokurorin, autoritetet kompetente (për mbrojtjen e të dhënave) dhe kur është e përshtatshme, Kuvendin dhe popullin. Mund të prodhojë raporte të veçanta nëse kjo kërkohet nga Kuvendi. Raportet vjetore të komisionit duhet të bëhen publike (neni 45). Ligji përfshin praktikën e mirë të përcaktimit të afateve të qarta kohore për publikimin e raporteve: Komisioni do ta paraqesë raportin vjetor para Kuvendit më së voni deri në fund të shkurtit (neni 45(1)), që është një qëllim mjaft ambicioz.

- Ligji është paksa i paqartë mbi atë se kur dhe si do të bëhen publike rezultatet nga hetimet dhe mbikëqyrja. Komisioni do të informojë publikun atëherë kur kjo do të jetë e nevojshme dhe pa dhënë të dhëna specifike (neni 44). Pyetja se çfarë do të thotë fjala "e përshtatshme" këtu dhe kush vendos për këtë duhet të sqarohet në Rregulloren e punës së komisionit.
- Një tjetër synim shumë ambicioz për raportim është vënë në nenin 51: Komisioni do të informojë Këshillin qytetar për mbikëqyrje për rezultatet e secilës kërkesë brenda 15 ditëve. Nuk ka gjasa që ky afat të arrihet në mënyrë rutine edhe pse kjo do të varet qartë nga burimet e personelit që komisioni ka në dispozicion.

Ligji për ndjekjen e komunikimeve i referohet vetëm njërit nga tre komisionet parlamentare, mandatet e të cilave mbulojnë aspekte dhe institucione të ndryshme brenda sektorit të zbulimit të Maqedonisë. Sidoqoftë, dispozitat e saja ambicioze sugjerojnë një ndryshim drejt një mbikëqyrjeje të zgjeruar dhe kanë potencialin për të inspiruar komisionet tjera të ndjekin ndryshimet në ligjet, rregullat dhe praktikën, në mënyrë që të arrihet një përmirësim i efektit parlamentar në mbikëqyrjen e shërbimeve të zbulimit. Disa hapa të mundshëm mund të parashihen me qëllim që të zhvillojnë më tej autoritetin ligjor të komisioneve:

- **Të miratohet/ndryshohet rregullorja.** Autoriteti i zmadhuar ligjor i siguruar me Ligjin për ndjekjen e komunikimeve për komisionin përkatës, duhet të shfrytëzohet për zhvillimin e praktikave efektive mbikëqyrëse, që do të përdoren nga ana e komisionit në mënyrë rutine. Miratimi i Rregullores së Komisionit (kërkuar me nenin 46 të ligjit) është hapi i radhës i nevojshëm për zhvillimin e dispozitave ligjore në udhëzues praktik dhe të hollësishëm mbi punën e komisionit. Dy komisionet tjera duhet të ndjekin këtë shembull; pasi që anëtarët janë të vetëdijshëm se mbikëqyrja e shërbimeve të zbulimit është përgjegjësia e të gjitha komisioneve.
- **Të miratohen ligjet të shkruara për të gjitha shërbimet/sektorët e zbulimit.** Pakoja legjislative për ndjekjen e komunikimeve e miratuar në prill të vitit 2018 duhet të jetë vetëm fillimi i një reforme gjithëpërfshirëse

legjislative të sektorit të zbulimit dhe mbikëqyrjes së tij; përpjekje të ngjashme janë duke u zhvilluar në shumë shtete evropiane. Mandati ligjor i të gjitha agjencive dhe departamenteve që mund të përdorin metoda ndërhyrëse për grumbullimin e informacionit duhet të definohet më qartë, në legjislacion (vetëm Agjencia e Zbulimit funksionon në bazë të një ligji, por jo zbulimi ushtarak dhe DSK-ja). Paqartësitë dhe mbivendosja duhet të shmangen, me qëllim që të krijohet një themel i qartë për llogaridhënien.

- **Të konsiderohet miratimi i legjislacionit të posaçëm për mbikëqyrjen e shërbimeve të zbulimit** Sfidat e natyrshme të procesit të mbikëqyrjes së shërbimeve të zbulimit kërkojnë një bazë të fortë ligjore dhe procedura të qarta për punën e organeve mbikëqyrëse. Në vend që autoriteti ligjor për mbikëqyrje të jetë i shpërndarë në disa ligje dhe rregullore, disa shtete kanë vendosur të miratojnë një ligj të veçantë për të përcaktuar qartë mandatin dhe kompetencat e organeve mbikëqyrëse (Gjermania, Sllovenia, Mali i Zi, Mbretëria e Bashkuar dhe Rumania janë vetëm disa shembuj). Kjo sjell disa përparësi: sqaron rregullat e lojës në mbikëqyrje dhe e bën autoritetin ligjor për mbikëqyrje të pakontestueshëm; kjo mund të sjellë dukshmëri më të madhe, prestigj dhe besueshmëri në organet përgjegjëse të mbikëqyrjes; ai siguron vazhdimësi strukturore dhe procedurale në mbikëqyrjen parlamentare, nga njëri mandat në tjetrin, duke kontribuar kështu në përmirësimin e kujtesës institucionale.

Mbikëqyrja e shërbimeve të zbulimit është një përpjekje ambicioze, gjithnjë e ndryshueshme dhe sfiduese. Duhet të konsiderohet si punë e vazhdueshme dhe krahas të gjitha sfidave, mund të bëhet shumë punë në përmirësimin e efikasitetit të saj. Problemi kryesor në mbikëqyrje qëndron kryesisht në kulturën institucionale të institucioneve të zbulimit që kanë të drejtën ligjore, të dhënë nga shteti, të përdorin metoda ndërhyrëse për grumbullimin e informacionit dhe kompetenca të tjera të veçanta. Miratimi i legjislacionit është përgjegjësi e kuvendit. Por ligjet asnjëherë nuk mund të formulohen aq qartë sa të mund të përjashtohet i gjithë potenciali për keqpërdorim të pushtetit. Gjithnjë do të ekzistojnë mënyra që të shfrytëzohen mungesat, në rast se institucionet me mandat për të siguruar sundimin e së drejtës, siç janë kuvendi dhe gjyqësori, janë të paaftë apo pa vullnet për të parandaluar këtë.

Çfarë lloji të fuqive ligjore kanë komisionet parlamentare për mbikëqyrje të shërbimeve për zbulim në BE?

Kompetencat themelore (20 nga 24 parlamente të anketuara)

- të mbikëqyr politikën e administratës dhe shërbimeve, buxhetin dhe harxhimet
- të merr raporte nga shërbimet e zbulimit dhe/apo nga pushteti ekzekutiv;
- mund të kërkojë nga shërbimet e zbulimit dhe/apo nga pushteti ekzekutiv që t'i sigurojë informacione komisionit.

Kompetenca të zgjeruara (4 nga 24) – kompetencat themelore janë të zgjeruara nga:

- kompetencën për të pranuar ankesa
- të nisë hetime me vetë iniciativë dhe të inspektojë hapësirat,
- të jep rekomandime apo vendime detyruese;
- mund të jetë i përfshirë në procesin e autorizimit apo masave për vëzhgim

Agjencia e BE-së për të Drejtat Themelore (FRA), Mbikëqyrja nga shërbimet e zbulimit, masat mbrojtëse themelore dhe mjetet juridike në Evropë. Hartimi i kornizës ligjore të vendeve anëtare, 2015

2.3.4. Organe të tjera të pavarura

Këshilli qytetar për mbikëqyrje

Ligji për ndjekjen e komunikimeve i vitit 2018 krijon edhe një shtresë tjetër të mbikëqyrjes së shërbimeve të zbulimit, përmes një organi civil i cili ka mandatin për të mbikëqyrur ligjshmërinë e përgjimit të komunikimeve. Kjo është një hap i rëndësishëm para për të ndërtuar besimin publik në sektorin e zbulimit, në veçanti për shkak se anëtarët e shoqërisë civile ishin lëndë e përgjimeve të paligjshme në të kaluarën.

Puna e Këshillit qytetar për mbikëqyrje është e lidhur nga afër me kuvendin dhe në veçanti me Komisionin parlamentar për mbikëqyrje të komunikimeve të përgjuara. Këshilli përbëhet nga kryetari dhe gjashtë anëtarë (tre ekspertë dhe tre përfaqësues të OJQ-ve) që do të jetë i emëruar nga Kuvendi pasi që të ketë shpallje publike për vendet e lira. Këshilli gjithashtu i raporton kuvendit. Për më tepër, hapësirat e punës së Këshillit do të sigurohen nga ana e kuvendit, i cili do të mundësojë bashkëpunim dhe komunikim më të afërt midis komisioneve të kuvendit dhe Këshillit.

Një tjetër risi është mundësia për qytetarët për të dorëzuar ankesa në raste të dyshimit për përgjime të paligjshme. Këshilli dhe Kuvendi kanë përgjegjësi të përbashkët në trajtimin e këtyre ankesave. Gjegjësisht, Këshilli pranon ankesat dhe mirëmban komunikimet me qytetarët e prekur, por komisioni parlamentar është përgjegjës për të bërë kontrollin dhe për të vërtetuar nëse është bërë një shkelje apo jo. Andaj, është e rëndësishme që kuvendi të zhvillojë rregulla dhe procedura të qarta të cilat do të rregullojnë bashkëpunimin dhe komunikimin midis këtyre dy organeve.

Këshilli gjithashtu ka autorizim që të kryejë mbikëqyrjen e AOT-it dhe organeve të autorizuara në bazë të një ankese nga ndonjë qytetar apo me vetë iniciativë. Ligji megjithatë nuk është shumë i qartë për atë se si Këshilli do të kryejë "kompetencën mbikëqyrëse", apo te cilat informata do të ketë qasje. Kjo është veçanërisht e rëndësishme meqë anëtarët e Këshillit sipas të gjitha gjasave nuk do jenë me përvojë në aktivitetet e zbulimit apo në shërbimin qeveritar. Pavarësisht nëse ai vepron *proprio motu* ose në bazë të një ankese, duket sikur sipas nenit 51(5) është i kufizuar në shikimin e të dhënave anonime në posedim të AOT-it ose organeve të autorizuara (mbikëqyrëse), dhe më pas vetëm "pas shpalljes". Roli hetues i Këshillit duket se mbështetet në kompetencat hetimore të komisionit parlamentar përkatës (shih nenin 51/2). Këshilli duhet vetëm të përcaktojë nëse ka ndodhur ndonjë shkelje apo jo (neni 51/4). Nëse gjen keqpërdorim e njofton prokurorin (neni 51/6) dhe publikun (neni 51/7).

Ekziston rreziku i dyfishimit të punës së Këshillit dhe komisionit, por gjithashtu edhe i pasjes së qëndrimeve dhe gjetjeve të ndryshme mbi punën e shërbimeve. Efikasiteti i mbikëqyrjes i ndërmarrë nga këto organe do të varet shumë nga zhvillimi pasues i procedurës, praktikave dhe ekspertizës edhe brenda komision-it (-eve) të Kuvendit dhe të Këshillit qytetar për mbikëqyrje. Rregullat e qarta të procedurës duhet gjithashtu të minimizojnë rrezikun e politizimit në mbikëqyrje.

Drejtoria për mbrojtjen e të dhënave personale

Agjencitë për mbrojtjen e të dhënave luajnë një rol fundamental në ruajtjen e të drejtës për mbrojtjen e të dhënave personale. Drejtoria për mbrojtjen e të dhënave personale e Maqedonisë është njëri nga organet më të rëndësishme të pavarura mbikëqyrëse kur bëhet fjalë për mbikëqyrje të shërbimeve të zbulimit, duke marrë parasysh që shërbimet e zbulimit grumbullojnë dhe procedojnë sasi të mëdha të të dhënave private të ndjeshme.

Drejtoria është një institucion i pavarur i menaxhuar nga Drejtori, që emërohet dhe shkarkohet nga Kuvendi pas një shpallje që paraprakisht është shpallur publikisht, për një periudhë 5 vjeçare me të drejtë për rizgjidhje³¹. Drejtori ia dorëzon Raportin vjetor Kuvendit, por gjithashtu dhe një raport shtesë në rast se një kërkesë e tillë vjen nga Kuvendi. Njëri nga instrumentet më të rëndësishme për të siguruar mbrojtjen e të drejtave personale janë inspektimet. Inspektimet e rregullta kryhen sipas një programi vjetor; megjithatë, një inspektim urgjent mund të kryhet edhe pas një propozimi / nisme nga një autoritet qeveritar, person juridik dhe fizik, ose në rast se inspektori supozon se ka pasur shkelje të Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale³².

Ligji për përgjimin e komunikimeve të vitit 2018 (Neni 54) përmend Drejtorinë për mbrojtjen e të dhënave personale si organ kompetent për mbikëqyrjen e ligjshmërisë së veprimeve të ndërmarra gjatë përpunimit të të dhënave personale

³¹ Ligji për mbrojtjen e të dhënave personale, Version i konsoliduar (G. Z. 7/2005, e ndryshuar G. Z. 103/2008, 124/2008, 124/2010, 135/2011, 43/2014, 153/2015 dhe 99/2016). Neni 37

³² Ibid. Neni 44-b

dhe masat e marra për mbrojtjen e tyre. Drejtoria morri veprime konkrete publike, për të përmirësuar keqpërdorimin e përgjimeve, duke realizuar disa inspektime gjatë 2016/2017.

Cilat janë praktikat më të mira ndërkombëtare mbi grumbullimin dhe menaxhimin e informatave si dhe përdorimin e të dhënave personale?

Praktika 21. Legjislacioni kombëtar përcakton llojet e masave për mbledhjen e të dhënave që janë në dispozicion të shërbimeve të zbulimit; objektivat e lejueshme të mbledhjes së informatave; kategoritë e personave dhe aktivitetëve që mund të jenë lëndë e mbledhjes së informatave për zbulim; pragu i dyshimit që kërkohet për të justifikuar përdorimin e masave për mbledhjen e informatave; kufizimet në kohëzgjatjen për të cilën mund të përdoren masat e mbledhjes së informatave; si dhe procedurat për autorizimin, mbikëqyrjen dhe shqyrtimin e përdorimit të masave të grumbullimit të informatave.

Praktika 23. Ligji që është në dispozicion publik nënvizon llojet e të dhënave personale që mund të mbajnë shërbimet e zbulimit dhe cilat kritere zbatohen për përdorimin, mbajtjen, fshirjen dhe zbulimin e këtyre të dhënave. Shërbimet e zbulimit lejohen të mbajnë të dhëna personale që janë të nevojshme vetëm për qëllimet e realizimit të mandatit të tyre.

Praktika 24. Shërbimet e zbulimit kryejnë vlerësime të rregullta për rëndësinë dhe saktësinë e të dhënave personale që i mbajnë. Prej tyre është ligjërish të kërkuar që të fshijnë ose përditësojnë çdo informacion që vlerësohet të jetë i pasaktë ose nuk ka më lidhje me mandatin e tyre, punën e institucioneve mbikëqyrëse ose procedurat e mundshme ligjore.

Praktika 25. Një institucion i pavarur ekziston për të mbikëqyrë përdorimin e të dhënave personale nga shërbimet e zbulimit. Ky institucion ka qasje në të gjitha dosjet që mbahen nga shërbimet e zbulimit dhe ka autoritetin për të urdhëruar zbulimin e informacionit për individët në fjalë, si dhe shkatërrimin e dosjeve ose të informacionit personal që përmban.

KB, Këshilli i të drejtave të njeriut, M. Shajnin (2010)

Avokati i popullit-Ombudsmeni

Mandatet e institucioneve të Avokatit të Popullit ndryshojnë shumë në Evropë dhe shumica nuk luajnë një rol të rëndësishëm në mbikëqyrjen e zbulimit. Edhe kur ligjet lejojnë që ata të hetojnë ankesat e qytetarëve për shërbimet e sigurisë dhe të zbulimit, ata rrallë e bëjnë këtë në praktikë. Ndikimi i tyre mbi sjelljen e shërbimeve ose në situata kur të drejtat e njeriut janë shkelur në ndonjë rast të caktuar, është i kufizuar për shkak se ata mund të japin vetëm rekomandime.

Roli që luan Avokati i Popullit në Maqedoni në mbikëqyrjen e shërbimeve të zbulimit mund të jetë i rëndësishëm, duke marrë parasysh mandatin që i është dhënë nga legjislacioni kombëtar. Baza ligjore për punën e institucionit të ombudsmanit rrjedh nga neni 77 i Kushtetutës së Maqedonisë, i cili fuqizon atë të "mbrojtë të drejtat kushtetuese dhe ligjore të qytetarëve kur shkelen nga organe të administratës shtetërore dhe nga organe dhe organizata të tjera që kanë mandate publike." Çdo qytetar ka të drejtën të dorëzojë një ankesë deri tek Avokati i Popullit – i cili është i zgjedhur nga ana e kuvendit për një mandat tetëvjeçar, i cili mund të ripërtërihet njëherë. Ligji për Avokatin e Popullit i miratuar në 2003 i jep një mandat të qartë dhe kompetenca të forta hetimore. Avokati i Popullit mund të iniciojë hetime në autoritetin e tij / saj (neni 13) duke pasur parasysh shkakun e mundshëm, ose mundësinë se mund të ndodhin keqpërdorime. Ai ka autoritetin të detyrojë institucionet publike që të sigurojnë informacion dhe shpjegime të detajuara në lidhje me çdo ankesë në kohën e duhur; gjithashtu ka të drejtë të hyjë në mjediset e institucioneve dhe të shikojë dokumentacionin e tyre (neni 24). Të gjithë zyrtarët shtetërorë (duke përfshirë krerët e shërbimeve të zbulimit) duhet të binden, pavarësisht nëse informacioni i kërkuar është i klasifikuar apo jo (neni 27). Pasi që Avokati i Popullit të konstatojë se ka pasur shkelje, ai / ajo ka të drejtë: të sugjerojë mënyrat për të hequr pengesën(-at) e gjetura, të iniciojë procedura disiplinore ose të kërkojë që Prokurori publik të iniciojë një hetim penal (neni 32).

Ligji i ri për ndjekjen e komunikimeve (neni 56) i cakton Avokatit të Popullit rol në mbikëqyrjen e ligjshmërisë së përgjimeve, nga aspekti i mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të njeriut.

Enti Shtetëror për Revizion

Institucioni më i rëndësishëm kur është fjala për sigurimin e llogaridhënies financiare të shërbimeve të zbulimit është Enti Shtetëror për Revizion (ESHR). Ky institucion i pavarur shtetëror përbëhet nga profesionistë të specializuar në zbulimin e parregullsive financiare.

Marrëdhëniet ndërmjet Kuvendit dhe ESHR-së rregullohen me Ligjin për revizion shtetëror. Drejtori dhe zëvendës drejtori i ESHR-së zgjidhen nga kuvendi për një periudhë prej 9 vjetësh. Programi vjetor i ESHR-së-së i dorëzohet kuvendit vetëm për informim.³³ Gjithashtu, ESHR-ja paraqet raporte individuale mbi revizionet e kryera dhe raportin vjetor për punën e tij, por vetëm raporti vjetor është lëndë e debatit në kuvend. Raportet individuale për revizionin e kryer mbi shërbimet e zbulimit nuk janë diskutuar ende me komisionet përkatëse³⁴.

Në përmbushjen e mandatit të saj, ESHR-ja ka qasje në informatat e klasifikuara. Meqenëse qasja në dokumentacionin e shërbimeve të zbulimit është e kufizuar për institucionet e tjera të mbikëqyrjes, ESHR-ja mund të luajë një rol kyç në llogaridhënien e shërbimeve të zbulimit. Prandaj, është me rëndësi që ESHR-ja t'i kushtojë vëmendje raporteve financiare të shërbimeve të zbulimit dhe të kryejë revizione të rregullta për shpenzimet e tyre. Forcimi i komunikimit në mes të Kuvendit dhe ESHR-së gjithashtu do të kontribuonte në rritjen e llogaridhënies financiare përmes një shkëmbim më të mirë të informatave midis ESHR-së dhe komisioneve mbikëqyrëse dhe madje edhe planifikimin e veprimeve të përbashkëta.

2.3.5. Prokuroria publike/Gjyqësori

Kontrolli gjyqësor është një nga garancitë më të fuqishme në përdorimin e metodave ndërhyrëse; prandaj legjislacioni duhet të përcaktojë qartë parimet e zbatueshme për autorizimin gjyqësor *ex-ante* të një mase dhe për shqyrtimin gjyqësor *ex-post*, gjatë zbatimit dhe pas ndërprerjes së masës. Këto parime (të tilla si legjitimiteti, proporcionalja, ligjshmëria, domosdoshmëria, subsidiariteti ose *ultima ratio*) duhet të jenë të natyrës detyruese për të gjitha autoritetet shtetërore të përfshira në iniciimin, autorizimin dhe zbatimin e metodave ndërhyrëse për grumbullimin e informacionit. Krahas autorizimit të këtyre masave, gjyqësori ndërmerr edhe disa veprime të rëndësishme për mbikëqyrjen e shërbimeve të zbulimit:

- *Vendos për akuzat për abuzim*, veprimtari kriminale ose qasje në informata në çështjet e lidhura me zbulimin. Në mënyrë që fshehtësia mos të çojë në mosndëshkim, dispozita të veçanta gjyqësore mund të sigurojnë që ligji zbatohet edhe duke mbrojtur informatat e klasifikuara;
- *Sigurimi i qasjes në mjete juridike*, në rastet kur individët ankohen për shkeljet e të drejtave të tyre nga shërbimet e sigurisë dhe të shërbimit të fshehtë, dhe kundërshtojnë arrestimin, marrjen në pyetje, ndalimin ose ndërhyrjen në privatësinë e tyre;
- *Kryen shqyrtimin gjyqësor*, i cili siguron që të gjitha ligjet dhe politikat e lidhura me zbulimin të krijuara nga legjislativi ose ekzekutivi të janë në përputhje me kushtetutën;
- *Në shumë vende ndihmojnë* në mbikëqyrjen parlamentare ose të pavarur, zyrtarët gjyqësor (ose anëtarët e pensionuar të gjyqësorit) duke kontribuar me ekspertizën e tyre në hetimet parlamentare ose komisionet e mbikëqyrjes ose në kryerjen e hetimeve të veçanta.

Mbrojtja juridike, si një parim i përgjithshëm në zbatimin e masave ndërhyrëse, ka qenë disi e anashkaluar në të kaluarën (jo vetëm Në Maqedoni por në shumicën e vendeve) për edhe atëherë kur është siguruar autorizimi gjyqësor për vëzhgim, kjo në praktikë ka qenë një formalitet. Gjyqtari nuk ka pasur ose nuk ka konsideruar se ka përgjegjësi për të kontrolluar nëse mbikëqyrja është e justifikuar për arsye materiale. Në vend të kësaj, gjyqtari ka kontrolluar vetëm formalitetet (p.sh. nëse shkelja për të cilën është kërkuar një vëzhgim është vepër penale për të cilën lejohet vëzhgimi). Sot, një qasje e tillë e limituar për një autorizim gjyqësor është i kundërt me standardet Evropiane dhe situata po ndryshon dukshëm edhe në Republikën e Maqedonisë.

³³ Ligji për revizion shtetëror, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, neni 23

³⁴ ESHR-ja bëri revizion Agjencisë së Zbulimit në vitin 2007

Gjyqësori luan një rol të rëndësishëm në propozimin, miratimin dhe zbatimin e masave të veçanta të hetimit në Republikën e Maqedonisë. Roli i tyre është evident në drejtim të ndjekjes së komunikimeve, siç është e përshkruar me Ligjin e ri mbi ndjekjen e komunikimeve.

Ligji parashikon dy shtresa kontrolli në zbatimin e përgjimeve, për qëllime të hetimeve penale si dhe për sigurinë dhe mbrojtjen kombëtare³⁵: Prokurorin publik dhe gjyqtarin që lëshon urdhrin për përgjimin e komunikimeve³⁶ si organe kontrolli për zbatimin e masave për përgjimin e komunikimeve. Kontrolli i tyre i referohet ligjshmërisë së zbatimit të masave ndërsa lëndë e kontrollit janë organet e autorizuar, operatorët dhe AOT-i. Përveç miratimit të masave, ligjvënësit i dhanë kompetenca të fuqishme gjyqësorit: inspektimin e vendeve, pajisjeve dhe dokumentacionit pa paralajmërim, qasjen e drejtpërdrejtë në sistemin e regjistrimit elektronik, kontrollin mbi përdorimin e mjeteve dhe pajisjeve të veçanta teknike etj.³⁷

Prokurori publik i Republikës së Maqedonisë paraqet raport vjetor në kuvend, i cili duhet të përmbajë informata për zbatimin e masave të posaçme hetimore. Komisioni që mbikëqyr ndjekjen e komunikimeve do ta konsiderojë këtë raport si pjesë të detyrës për të kryer mbikëqyrjen mbi efikasitetin e ndjekjes së komunikimeve.

Ashtu si me shumicën e shteteve evropiane, sistemi kryesor i kontrollit mbi mbikëqyrjen në Republikën e Maqedonisë është gjyqësia, duke u mbështetur në prokurorët dhe gjykatat. Mbikëqyrja parlamentare dhe qytetare shihet të jetë si një "rezervë" ("back-up"). Nëse prokurorët nuk veprojnë si një filtër për aplikimet e mbikëqyrjes dhe gjykatat nuk marrin seriozisht autorizimin dhe mbikëqyrjen e mandateve, atëherë sistemet rezervë ("back-up") nuk do të jenë në gjendje të kompensojnë këtë dështim kontrolli. Në rastin më të mirë, atë që mund ta bëjnë është ta zbulojnë dështimin në kontrollin gjyqësor.

Cilat janë dallimet midis mbikëqyrjes parlamentare dhe mbikëqyrjes gjyqësore?

- Mbikëqyrja parlamentare është më e lidhur me politikën, ndërsa shqyrtimi gjyqësor merret ekskluzivisht me çështje të ngushta ligjore; gjyqësori reagon vetëm ndaj çështjeve ligjore që sillen para gjyqësorit për vendim dhe nuk mund të marrë iniciativa më vete;
- Mbikëqyrja parlamentare, në teori është e pakufizuar. Deputetët kanë legjitimitetin demokratik të kërkojnë informacione dhe shpjegime për çdo aspekt të punës së një agjencie qeveritare dhe kanë të drejtë të inspektojnë hapësirat dhe të kontrollojnë vetë kapacitetet ndërhyrëse;
- Gjykatësit kanë tendencë të tregojnë më shumë respekt ndaj pushtetit ekzekutiv në çështjet e sigurisë kombëtare dhe të zbulimit sesa deputetët;
- Megjithatë parlamentet zakonisht kanë pak autoritet kur bëhet fjalë për çështje operative, ata kanë kompetencë më të gjerë për të përcaktuar mandatin dhe buxhetin e shërbimeve të sigurisë, që ju jep atyre ndikim të rëndësishëm në ndikimin mbi sjelljen e tyre.

³⁵ Në shumë shtete të Evropës kërkesa për përdorim të metodave ndërhyrëse për grumbullim të informatave për qëllim të sigurisë kombëtare nga ana e shërbimeve të zbulimit dorëzohet drejtpërsëdrejti te gjykatësi përgjegjës, pa filtrin e prokurorit.

³⁶ Gjyqtari i procedurës paraprake me të cilin urdhërohet masa e posaçme hetimore në pajtim me ligjin për ligjshmërinë dhe gjyqtari i Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë, me të cilin është lëshuar urdhri për përgjimin e komunikimeve. Ligji për përgjimin e komunikimeve, neni 57-61

³⁷ Ibid. neni 59-60

3. AFTËSIA E KOMISIONIT PËR KRYERJE TË MBIKËQYRJES: KRIJIMI I KUSHTEVE PËR MBIKËQYRJE EFEKTIVE

Që mbikëqyrja të jetë e besueshme, duhet të mbështetet në një autoritet ligjor të përcaktuar qartë, të përfshirë në Kushtetutë dhe në ligje, dhe të përmbush standardet demokratike që i bëjnë kontrollet dhe balancat funksionale dhe llogaridhënien një parim themelor të qeverisjes. Kapitulli i parë i këtij Udhëzuesi ka shqyrtuar kornizën legjislative që i jep kuvendit autoritetin ligjor për t'u angazhuar në mbikëqyrjen e shërbimeve të zbulimit. Institucionet dhe dispozitat ligjore që bëjnë të mundur mbikëqyrjen e shërbimeve të zbulimit janë vendosur. Megjithatë, kompetencat ligjore nuk janë të mjaftueshme për mbikëqyrje efektive. Kuvendi duhet të ketë aftësinë për të shfrytëzuar kompetencat ligjore që i ka dhe t'i transformojë ato në veprim mbikëqyrës, dhe këtë duhet ta bëjë në mënyrë të zakonshme. Që kjo të ndodhë, komisionet e mbikëqyrjes kanë nevojë për personel, informacion, ekspertizë dhe rregulla të përcaktuara mirë për zhvillimin e mbikëqyrjes. Ky kapitull do të shqyrtojë kushtet që u japin mundësi komisioneve të shfrytëzojnë plotësisht autoritetin e tyre ligjor dhe të angazhohen në mbikëqyrjen efektive të -shërbimeve të zbulimit.

Mbikëqyrja parlamentare është një funksion i kuvendit si tërësi, por është më efikas dhe dukshëm i zhvilluar në nivel komisioni. Një strukturë e mirë e institucionalizuar e komisioneve të përhershme³⁸, e cila është paralele me strukturën e qeverisë, është thelbësore për efektivitetin e kuvendit. Komisionet e forta zhvillojnë një etikë të pavarur, një kapacitet për mendim dhe veprim të pavarur, të paanshëm. Ato janë mjeti kryesor për ndikimin e kuvendit në procesin e politik-bërjes dhe për mbikëqyrjen e pushtetit ekzekutiv.

Komisionet këshillojnë përbërjen e plotë të kuvendit për të gjithë legjislacionin dhe vendimet kuvendare që duhet të merren në fushën e tyre të veprimtarisë. Raportet e tyre ofrojnë pikënisje për të gjitha debatet mbi legjislacionin në seancat plenare dhe janë mjeti kryesor për formulimin e rekomandimeve për qeverinë. Ata ndjekin llogaridhënien e agjencive ekzekutive (duke përfshirë shërbimet e zbulimit), kryesisht nga dy këndvështrime:

1. administrativ - duke hetuar politikat dhe veprimet e tyre për të siguruar respektimin e sundimit të ligjit dhe të të drejtave të popullatës dhe për të shmangur administrimin e keq, shpenzimin e burimeve publike pa kontroll dhe pa korrupsionin në veprimin e qeverisjes;
2. politik - duke u përpjekur të vlerësojnë zgjedhjet politike të ekzekutivit, konsistencën e tyre me interesat kombëtare dhe programin e qeverisë, zbatimin e tyre dhe pasojat.

Cilat janë nivelet e veprimit të mbikëqyrjes parlamentare?

Seanca plenare

Mbështetja e politikës / strategjisë së sigurimit dhe e politikës së qeverisë
Zbatimi i ligjeve
Miratimi i përdorimit të fondeve publike (Ligji i Buxhetit të Shtetit)
Mocionet dhe votat e besimit
Pëlqim për emërimet e funksionarëve të lartë (ministrat, drejtorët e shërbimeve të zbulimit)

Komisionet

Raportet legjislative, raportet e mbikëqyrjes
Rekomandimet
Dëgjimet dhe hetimet
Vizitat dhe inspektimet në terren
Hetimi i ankesave të qytetarëve

³⁸ Ekzistojnë Ad-hoc komisione të emëruara me mandate të veçantë dhe të vogël, si për shembull për propozim-ligj të caktuar ose për çështje nën hetim, këto komisione pushojnë së punuari pas mbarimit të mandatit të tyre..

3.1. Qasja deri tek informatat

Shumica e kuvendeve evropiane kanë qasje të privilegjuar në informacionin e klasifikuar për t'u mundësuar atyre mbikëqyrjen mbi agjencitë e zbulimit. E drejta e kuvendit për t'u informuar nga pushteti ekzekutiv paraqet kushtin e parë për ligjshmërinë dhe mbikëqyrjen efektive.

Në çështjet e sigurisë dhe të zbulimit, qasja në informata nxit sfida lidhur me nevojën për të balancuar kërkesat e llogaridhënies demokratike dhe transparencës me kërkesat e sigurisë dhe fshehtësisë shtetërore. Fshtësia (konfidencialiteti) kufizon rrjedhën e informatave drejt parlamentit dhe publikut. Megjithatë, duhet të bëhet dallimi ndërmjet “nevojës për fshtësi (konfidencialitet)”, e cila është e kuptueshme dhe e arsyeshme dhe interpretimi i saj ekstrem - “mungesa e shqyrtimit publik”, i cili është i papranueshëm në demokraci.

Komisioni për mbikëqyrjen e zbulimit dhe sigurisë ka qasje në informata të klasifikuara. Rrethanat dhe kushtet e kësaj qasjeje duhet të përcaktohen qartë me ligj dhe me Rregulloren e punës. Ekzistojnë dy mënyra kryesore për t'u dhënë deputetëve këtë qasje: (1) pa një leje sigurie (si përjashtim nga rregullat e statutit për qasjen në informatat sekrete shtetërore), ose (2) pas marrjes së një certifikate sigurie.

- (1) Në shumicën e shteteve evropiane supozohet se natyra e zgjedhur e mandatit parlamentar u jep të drejtën deputetëve të kenë qasje në informacione të klasifikuara, pa ndonjë verifikim paraprak.³⁹ Konsiderohet se procesi i kontrollimit të deputetëve do të ishte shkelje e ndarjes së pushteteve; do të kufizonte anëtarësimin në komisionet e mbikëqyrjes dhe potencialisht do të çonte në dëgjueshmëri ndaj pushtetit ekzekutiv. Një betim fshtësie është i nevojshëm dhe i mjaftueshëm, në fillim të mandatit legjislativ, pasi të jetë zgjedhur në një komision që merret me mbrojtjen, sigurinë ose zbulimin. Kjo qasje relative automatike tek informatat e klasifikuara nuk do të thotë që deputetët janë të çliruar nga sanksionet ligjore për zbulim të paautorizuar të informacionit sekret.
- (2) Në kuvendet tjera, anëtarët e komisionit fitojnë të drejtën në qasje tek informatat e klasifikuara vetëm pas marrjes së një certifikate sigurie (disa nga shembujt janë Estonia, Hungaria, Latvia, Lituania, Polonia, Serbia dhe Maqedonia). Certifikata e sigurisë u jepet deputetëve pasi të kenë kaluar kontrollin paraprak të kryer nga një agjenci qeveritare (zakonisht shërbimi vendor i zbulimit apo policia). Kontrollat sigurojnë vlerësim të rrezikut dhe ato u referohen lidhjeve, interesave apo dobësive ekzistuese që mund të çojnë individët në zbulimin e informacionit të klasifikuar për para, interesa politike ose të biznesit, ose përmes shantazhit. Një proces formal i suksesshëm verifikimi është mekanizëm i ndërtimit të besimit. Ndërtimi i besimit në marrëdhëniet midis organeve mbikëqyrëse dhe agjencive të zbulimit është veçanërisht i nevojshëm në demokracitë e reja, ku agjencitë e sigurisë ngurrojnë shumë për të ndarë informatat. Kjo qartëson rregullat e lojës dhe i fuqizon deputetët në dialogun e tyre me zyrtarët ekzekutivë.

Megjithatë, ka disa rreze që duhet të zbuten kur bëhet verifikimi i deputetëve:

- T'i jepet fuqia shërbimeve të zbulimit për të vendosur dhe miratuar se kush do jenë kontrolluesit. Ekziston një konflikt interesi potencial nëse “i mbikëqyruri” është gjithashtu edhe “ruajtësi i portës” për qasje deri tek informatat nga mbikëqyrësit. Për të larguar këtë rrezik, agjencia e cila bën kontrollat paraprake duhet të jep vetëm mendim, por ata nuk duhet të jenë ata që do të vendosin për dhënien e certifikatës së sigurisë. Vendimi final duhet të merret nga Kuvendi ndërsa ligji duhet të sigurojë mekanizma të kontestimit dhe ankimimit për rastet ku nevojitet certifikata e sigurisë.
- Krijimi i dy klasave të deputetëve në komisionet për mbikëqyrje: ata me dhe ata pa certifikatë sigurie (për shkak se nuk kanë kaluar procesin e verifikimit, apo për shkak se kanë refuzuar të aplikojnë). Kjo mund të rrezikojë funksionimin e komisionit dhe besueshmërinë e kuvendit si mbikëqyrës. Për të parandaluar këtë rrezik, verifikimi mund të bëhet para se të themelohet komisioni në mënyrë formale, për të verifikuar të gjithë

³⁹ Shih për shembull rastin e Holandës: <http://www.ennir.be/netherlands/intelligence-review-netherlands>

anëtarët e mundshëm; ndërsa vetëm deputetët që do të marrin certifikatë sigurie do të duhet të emërohen në komision.

- Dhënia e certifikatës së sigurisë një personi nuk do të thotë që ai/ajo nuk do të bëjë një zbulim të paautorizuar të informatave të klasifikuara. Politikanët nuk kanë domosdo një kulturë të mbajtjes së sekretit apo një kuptim të qartë për pasojat ligjore dhe implikimet operative të zbulimit të paautorizuar. Megjithatë, dialogu i vazhdueshëm midis parlamentit dhe shërbimeve ndërton vetëdijen dhe përgjegjësinë e nevojshme. Në shumicën e shteteve, deputetët zakonisht nuk gëzojnë imunitet nga ndjekja penale në rast të zbulimit të paautorizuar të informatave.

Me apo pa certifikatë sigurie, deputetët duhet të dinë se një qasje absolute deri tek informatat e klasifikuara është e paarrtshme. Ka dy kufizime të ndërlidhura për këtë qasje: mandati i komisionit dhe parimi *duhet ta di*.

Qasja deri tek informatat e komisionit duhet të definohet nga **mandati i tij për mbikëqyrje**. Nevojat për informacion të një komisioni që merret me çështjet e politikës dhe ligjshmërisë janë të ndryshme nga ato të një komisioni me mandat për të mbikëqyrur efikasitetin e operacioneve të zbulimit - të cilat kërkojnë informata më të thella. Ky udhëzim i qartë është i rëndësishëm jo vetëm për sigurimin e informatave të nevojshme për komisionet që ato të përmbushin mandatin e tyre, por edhe për parandalimin e përpjekjeve të deputetëve për të pasur qasje në informata që mund të mos kenë lidhje me punën e tyre.

Parimi duhet të di trajton çështjen e njëjtë: edhe nëse dikush ka të gjitha miratimet e nevojshme zyrtare ata nuk duhet të kenë qasje në informatat specifike përveç nëse ata kanë *nevojë të dinë* atë informatë, nevojë që arsyetohet me sjelljen e detyrave zyrtare të personit. Ky parim ka për qëllim që të dekurajojë "shfletimin" e lirshëm të materialeve të ndjeshme apo shpërdorimin e informatave të klasifikuara për interesa personale.

Këto kufizime për qasjen në informata dëshmojnë edhe një herë se mandati i komisionit duhet të jetë i definuar mirë me ligj dhe me rregulloren e punës. Nëse kuvendi nuk e bën këtë, përgjegjësia (apo diskrecioni) për të definuar "*duhet të di*" të një komisioni parlamentar i takon plotësisht pushtetit ekzekutiv. Më pas, qasja e kuvendit deri tek informatat varet nga mënyra se si një ministër e interpreton ligjin ndërsa kuvendi mbetet i kufizuar ose pa mbështetje për të sfiduar këto vendime.

Si është e rregulluar qasja e komisionit deri tek informatat në disa shtete?

- **Gjermani** – Paneli parlamentar për kontroll ka të drejtën të kërkojë informata, dokumente apo dosje të tjera me të dhëna nga qeveria federale dhe tre shërbimet e zbulimit. Kërkesat duhet të ndiqen menjëherë. Personeli i agjencive të zbulimit gjithashtu mund të merret në pyetje. Anëtarët e Panelit të Kontrollit betohen për fshehtësi, ata mund të komentojnë publikisht për çështje të caktuara, përderisa vendimi për ta bërë këtë arrihet nga dy të tretat e anëtarëve të tij. Paneli për kontroll mund të kërkojë dëshmitarët ekspertë të dorëzojnë vlerësime. (Akti i Panelit të kontrollit parlamentar)
- **Rumuni** - Komisioni për mbikëqyrjen e shërbimeve të zbulimit (për shërbimin e brendshëm SRI) mund të kërkojë raporte, përmbledhje të shkurtra, shpjegime, dokumente, të dhëna dhe informacione; ata mund të thërrasin për seanca dëgjimore personelin ushtarak dhe civil të shërbimit. SRI është e obliguar që të dorëzojë informatat e kërkuara nga komisioni brenda 7 ditëve të punës; nëse tejkalohet afati kohor, SRI është e obliguar që të sqarojë arsyet dhe të informojë për kohën e nevojshme për përgatitje të informatave të kërkuara. Vendimi i kuvendit nr. 85/2017)
- **Hungari** – dy të tretat e Komisionit kombëtar për siguri mund të votojnë për të kërkuar zbulimin e informatave specifike nga ana e pushtetit ekzekutiv/një agjencie në lidhje me metodat e zbulimit të agjencisë. (Akt CXXV/1995)

Më shpesh, ligjet po përcaktojnë **përrjashtimet** nga qasja dhe jo kategoritë e informacionit që mund të ndahen nga shërbimi me komisionin për mbikëqyrje. Kjo i siguron kuvendit një qasje më të gjerë deri tek informatat, pasi që të gjitha informatat që nuk janë përrjashtim duhet ti vihen në dispozicion komisionit. Përrjashtimet më të shpeshta nga qasja janë si vijojnë:

1. Informatat që kanë të bëjnë me **operacionet që janë në vijim e sipër**. Çdo zbulim i informacionit operativ të ndjeshëm mund të komprometojë operacionin dhe të rrezikojë zyrtarët që e zbatojnë atë. Megjithatë, deputetët duhet të jenë të vetëdijshëm se disa operacione mund të zgjasin me vite, duke mbetur të padepërtueshëm për mbikëqyrje; ose mund të jetë e vështirë të përcaktohet se kur ka mbaruar një operacion. Ky vlerësim i ngel agjencisë për ta bërë dhe kjo e drejtë e diskrecionit mund të manipulohet për të fshehur ndonjë çështje të caktuar nga vështrimi i komisionit. Krahas kësaj, ndonjëherë ekziston një hapësirë e hirtë midis politikës dhe operacioneve (për shembull, modelet e synimit (targetimit) dhe prioritetet e synimit).
2. Informata në lidhje me **burimet dhe metodat** e përdorura. Identitetet dhe rolet e burimeve njerëzore janë disa nga aspektet më të ndjeshme të punës së zbulimit. Rrjedhjet e identitetit të burimeve mund të rrezikojnë sigurinë e tyre personale ndërsa shpërndarja e informatave mbi metodat mund t'i bëjë metodat joefikase, t'i japë përparësi kundërshtarëve dhe të rrezikojë burimet njerëzore. Ndonjëherë sidoqoftë, kur komisioni ka mandat për të hetuar një krim serioz të dyshuar (siç është korrupsioni apo shkeljet e të drejtave njerëzore) mund të jetë e nevojshme qasja deri te ky lloj i informatave.
3. Informata nga **subjektet e huaja**. Kjo është rezultat nga bashkëpunimi ndërkombëtar në fushën e zbulimit (ndarja e informatave dhe operacione të përbashkëta). Kufizimet janë të bazuara në "rregullën e palës së tretë"⁴⁰: para se të përcillet informata te pala e tretë agjencia duhet të merr leje nga subjekti i parë (i origjinës). Ka shumë pak të dhëna në dispozicion për atë se sa shpesh bëhen kërkesa të tilla dhe nëse janë të suksesshme. Ndarja e informatave midis agjencive të zbulimit është rritur në mënyrë eksponenciale gjatë dekadës së fundit, duke e bërë bashkëpunimin ndërkombëtar njërin nga burimet kryesore të informatave të zbulimit. Pa informata mbi bashkëpunimin ndërkombëtar të agjencive të zbulimit, komisionet kanë një vështrim të pjesshëm mbi aktivitetet që përfshijnë agjencinë e tyre shtetërore. Marrja e më tepër informatave rreth bashkëpunimit ndërkombëtar (apo edhe nëse janë të përjashtuar nga rregulli i palës së tretë) është një përpjekje e shumë organeve mbikëqyrëse në Evropë.
4. Informata mbi procedurat gjyqësore apo hetimet e krimit - kufizimet zbatohen me qëllim të ruajtjes së të drejtës për një gjykim të drejtë dhe aftësinë e shtetit për të hetuar dhe ndjekur penalisht krimin.

Çfarë lloj informatash janë të përjashtuara nga qasja në ligjet e ndryshme kombëtare?

- Operacionet aktuale apo të ardhme të zbulimit, informata të cilat mund të zbulojnë identitetin e nëpunësve sekret, burimet, metodat apo mjetet.
- Përjashtimi nga qasja nuk aplikohet në situata ku një gjykatë ka vërejtur shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut (Rumuni). Dokumente të shërbimeve të huaja apo dokumente të cilat do të ndikojnë mbi të drejtat personale të palëve të treta (Gjermani).
- Procese të vazhdueshme gjyqësore apo hetime penale
- Informata të cilat mund të rrezikojnë interesat kombëtare apo sigurinë e njerëzve (Austri)
- Informata të cilat mund të rrezikojnë sigurinë e Republikës (Itali)
- Informata të ndjeshme (Mbretëria e Bashkuar)
- Informata të ndjeshme mbi operacionet (Francë)
- Informata të cilat mund të zbulojnë identitetin e burimit apo që do të dëmtonin të drejtat e palëve të treta (Luksemburg)

Qasja deri tek informatat ka rreziqet e veta. Informatat e klasifikuara mund të përdoren nga ana e shërbimeve në përpjekje që t'i çojnë në drejtim tjetër apo të ndikojnë mbi politikanët duke ju treguar informata të përzgjedhura. Informatat e klasifikuara mund gjithashtu të përdoren si një instrument efikas për të heshtur kuvendin, pasi, sapo të kenë pranuar informata të klasifikuara mbi një temë ata nuk mund ta diskutojnë atë çështje publikisht.

Komisionet parlamentare duhet të përpiqen të marrin informata të cilat përputhen me përgjegjësitë e tyre të mbikëqyrjes. Kjo do të thotë se duhet të shkojnë më tej pas "gjurmës së letrës" dhe krahasimit të të dhënave statistikore që janë vënë në dispozicion nga agjenci të ndryshme dhe të zhvillojnë aftësi të mjaftueshme për gjetjen e fakteve për të hetuar sjelljen dhe xhirimet që janë pronë e agjencive përkatëse.

⁴⁰ Ndonjëherë e quajtur edhe si "kontroll e origjinalit" (ORKON)

Si mund të përmirësohet qasja deri tek informatat?

- Të miratohen rregulla dhe procedura të qarta për qasje, debat, ruajtje dhe shpërndarje të informatave të klasifikuara duke përfshirë dhe rregullat e brendshme të komisionit për atë se çfarë mund të komunikohet (1) brenda kuvendit; (2) në publik.
- Të miratohen procedura të qarta për marrjen dhe ruajtjen e certifikatës së sigurisë, si për deputetët dhe për personelin e komisionit.
- Të përkushtohen hapësira dhe objekte të veçanta për menaxhimin/leximin/diskutimin e informatave të ndjeshme (siç është një dhomë e mbrojtur për mbledhje private të komisionit)
- Të punësohet personel i kualifikuar për menaxhimin e dokumenteve të klasifikuara (dhe të sigurohet trajnimi i tyre i shpeshtë)
- Të organizohen takime të mbyllura mbi tema të ndjeshme; këto nuk janë në dispozicion publik, as për deputetët të cilët nuk janë anëtarë të komisionit për mbikëqyrje.
- Të lidhet çdo kërkesë për informatë me mandatin për mbikëqyrje të komisionit (të bëhet referim preciz me nenet në kushtetutë, ligjet, Rregulloren e punës)
- Të parandalojnë klasifikimin tej mase, përmes ligjeve të cilat definojnë qartë dhe në mënyrë restriktive llojet e informatave të cilat mund të jenë të klasifikuara dhe përmes një agjencie të pavarur për mbikëqyrje të sistemit të klasifikimit
- Të vihet një kërkesë që agjencitë e zbulimit dhe qeveritë në mënyrë pro-aktive të zbulojnë lloje të caktuara të informatave në komision, pa e pritur kërkesën që ta bëjnë këtë.

3.2. Ekspertiza e komisionit

Problemi më i madh në mbikëqyrje është asimetria e informacionit dhe ekspertizës që ekziston midis kuvendit dhe shërbimeve të zbulimit. Në pothuajse çdo rrethanë shërbimet e zbulimit kanë përparësi në aspektin e ekspertizës, në qasjen në informata dhe lirinë në vendimmarrje mbi procesin, detyrat dhe burimet e tyre. Mbikëqyrja është shumë e varur nga gatishmëria e ekzekutivit dhe e shërbimeve për të shkëmbyer informacion rreth veprimeve të shërbimeve të zbulimit.

Ekspertiza e duhur dhe njohuria rreth asaj se çfarë pyetjesh duhet parashtruar është parakusht për mbikëqyrje efektive. Anëtarët e komisionit dhe këshilltarët e personelit duhet të njohin mirë ligjin, politikën dhe funksionin e shërbimeve të zbulimit të Maqedonisë dhe të jenë në gjendje të zbatojnë këtë njohuri kur zhvillojnë shqyrtimin e tyre për të konstatuar nëse shërbimet përmbushin kërkesat e demokracisë, të drejtave të njeriut dhe procesit të duhur ligjor. Mund të dallohen disa lloje të ekspertizës që nevojiten në fushën e mbikëqyrjes së shërbimeve të zbulimit.

1. **Ekspertiza e mbikëqyrjes demokratike** – të kuptohet mirë rëndësia e mbikëqyrjes dhe funksionimit të kuvendit në një demokraci; të njihen mjetet e mbikëqyrjes; të njihen procedurat e kuvendit dhe të komisioneve. Puna e kuvendit, procedurat legjislative, funksioni i komisioneve, ose roli i tyre brenda sistemit të kontroleve dhe balancave që e bëjnë llogaridhënien demokratike të mundshme është unike dhe e vështirë për t'u kuptuar për të jashtmit. Para se të mësojnë për veçoritë e botës së shërbimeve të zbulimit, anëtarët e komisionit (sidomos deputetët e rinj) duhet të kuptojnë dhe të përvetësojnë parimet dhe modalitetet e mbikëqyrjes, të zhvillojnë qëndrimin, vullnetin politik dhe guximin e nevojshëm për t'u angazhuar në mbikëqyrje kuptimplote.
2. **Ekspertiza ligjore** - të kuptohet qartë korniza strategjike dhe të gjitha ligjet dhe rregulloret përkatëse që mbështesin veprimtarinë e shërbimeve të zbulimit në Maqedoni. Kjo duhet të përfshijë ligjet dhe procedurat që rregullojnë
 - detyrat dhe mandatin e të gjitha shërbimeve të zbulimit;
 - të drejtat e njeriut, privatësinë dhe liritë qytetare, dhe kur mund të anashkalohen ato për arsye të sigurisë kombëtare;
 - përdorimi i kompetencave të veçanta siç janë rekrutimi i agjentëve ose ekzekutimi i përgjimeve;
 - mbrojtja e të dhënave, duke përfshirë ligjet dhe direktivat përkatëse të BE-së.

- ankesat e qytetarëve dhe ankesat e punonjësve të shërbimit, duke përfshirë masat mbrojtëse që ekzistojnë për personelin e shërbimeve të zbulimit, siç janë mbrojtja nga një urdhër i paligjshëm ose mbrojtje për treguesit.
3. **Ekspertiza operative** - të kuptohet si funksionojnë vërtet shërbimet. Pavarësisht nëse anëtarët e komisionit kanë përvojë paraprake me çështjet e zbulimit apo jo, ata duhet të përpiqen të kuptojnë funksionin e shërbimeve të zbulimit në një shtet modern. Kjo duhet të përfshijë:
- sferat e ndryshme të shërbimeve shtetërore të zbulimit, duke marrë parasysh dimensionin civil, ushtarak dhe shërbimet policore; dhe çështjet e grumbullimit të informacioneve të zbulimit në vend dhe jashtë vendit;
 - format kryesore me të cilat mbledhen dhe pastaj analizohen informatat, siç janë: zbulimi njerëzor (Humint); përgjimi dhe zbulimi i komunikimit (Sigint); zbulimi i burimit të hapur (Osint); zbulimi i imazhit (Imint); operacionet e fshehta të mbikëqyrjes; dhe operacionet kibernetike, mbrojtëse dhe sulmuese.
 - pranimi i parimeve dhe mekanizmave për bashkëpunim me partnerët jashtë shtetit;
 - cilat agjenci dhe organe janë përgjegjëse për këto aktivitete të ndryshme; cila është marrëdhënia mes tyre;
 - si janë përcaktuar përgjegjësitë dhe prioritetet për mbledhjen e informacioneve brenda sektorit të zbulimit.
4. **Ekspertiza teknologjike** - të kuptohen çështjet teknologjike dhe evoluimi i tyre i shpejtë dhe më konkretisht, teknologjitë e informacionit dhe komunikimit (TIK) dhe menaxhimit të të dhënave. Deputetët nuk mund të bëjnë vlerësime të sakta ligjore nëse ato bazohen në supozime të gabuara për funksionimin e teknologjisë.

Ekspertizë në dispozicion të organeve të mbikëqyrjes në Mbretërinë e Bashkuar

Komisioni parlamentar për Zbulim dhe Siguri (KZS) - i përbërë nga 9 deputetë, të zgjedhur nga një listë e miratuar nga Kryeministri, me emërimet të harmonizuara me liderin e opozitës, duke përfshirë kandidatët nga të dy dhomat e Parlamentit. Anëtarët e komisionit në mënyrë ideale do të duhej të kenë përvojë paraprake në fushën e zbulimit, por nuk mund të shërbejnë si ministër qeveritarë, siç është rasti në shumë sisteme parlamentare. Për mbështetje administrative në drejtimin e hetimeve dhe hartimit të raporteve, anëtarët e KZS-së së Mbretërisë së Bashkuar përdorin personelin ekzistues të përhershëm në kuadër të Sekretariatit të Sigurisë Kombëtare në Zyrën e Qeverisë.

Zyra e Komisionarit me Kompetenca Hetuese (KKH) përbën një përzierje të zyrave të veçanta të komisionarëve me miratimin e Ligjit për Kompetencat Hetuese (LKH) në vitin 2016. KKH është më shumë i përfshirë në pjesën mbikëqyrëse të sistemit sesa në atë të shqyrtimit, me përgjegjësi për mbikëqyrjen e aktiviteteve të përditshme të inteligjencës të të gjitha organeve dhe agjencive që ushtrojnë kompetenca hetuese (dmth. mbledhjen e informacionit). Kjo përfshin një sërë gjyqtarësh (të ashtuquajtur Komisionarë Gjyqësorë) të cilët japin pëlqimin përfundimtar për urdhrat e përgjimit, siç është ai i fundit i IPA-së i vitit 2016. Në tërësi, KKH përfshin:

- **15 Komisionarë gjyqësorë;**
- Përafërsisht **50 punonjës administrativë dhe teknikë** që paraqesin një gamë të gjerë të ekspertizës përfshirë ato ligjore dhe teknologjike;
- Një **Bord Këshillëdhënës Teknologjik (TAB)** nga i cili mund të kërkohej të komentojë mbi fusha të veçanta teknike. Ky organ përfshin anëtarë të stafit qeveritar, akademikë dhe ekspertë teknikë nga fusha, persona që punojnë në teknologjinë e informacionit dhe komunikimit (TIK). Grupi nuk mbledhet rregullisht, por mund të thirret të paktën një herë në vit dhe më shpesh sipas nevojave specifike.

Në këtë mënyrë, IKKH siguron mbikëqyrjen e përditshme të aktiviteteve të shërbimeve të zbulimit dhe një fushë më të thellë të ekspertizës për të plotësuar punën e parlamentarëve në KZS.

Arritja e ekspertizës në këtë fushë është një proces i ngadalshëm, i cili kërkon përkushtim dhe këmbëngulësi. Deputetët duhet të kenë pritje dhe ambicie reale gjatë procesit. Është e pranuar që përgjithësisht duhen vite (18-24 muaj sipas vlerësimeve më optimiste) që të kuptohen funksionet dhe hollësitë teknike të zbulimit dhe kjo varet nga gatishmëria e shërbimeve për bashkëpunim dhe për shkëmbim të informatave. Duke marrë parasysh qarkullimin e anëtarëve të komisionit pas zgjedhjeve, zhvillimi i një kapaciteti të fortë të stafit të ekspertëve brenda kuvendit është thelbësor.

Në mungesë të personelit, mundësitë për hulumtim të komisionit janë të kufizuara, duke i detyruar anëtarët të mbështeten kryesisht në informata të siguruar nga qeveria dhe agjencitë e sigurisë, ato institucione që komisioni duhet t'i mbikëqyrë.

Personeli i komisionit përgatit dhe organizon mbledhjet e komisionit, mban kontaktet me agjencitë qeveritare, mbledh informata dhe ndihmon në interpretimin e informatave qeveritare. Ata duhet të mbulojnë një gamë të gjerë aktiviteteve, nga puna e sekretarisë e deri te këshillimi juridik, hartimi i legjislacionit, planifikimi dhe organizimi i aktiviteteve mbikëqyrëse, shkrimi i punimeve shkencore ose fjalimeve. Një personel i qëndrueshëm dhe profesionist është qenësor për t'i mundësuar komisionit që të arrijë dhe të realizojë përgjegjësitë e veta; ata sigurojnë vazhdimësinë e ekspertizës dhe kujtesën institucionale të një komisioni.

Dispozitat e Ligjit të ri për ndjekjen e komunikimeve (neni 39) tregojnë një njohje të fuqishme të nevojës për të rritur ekspertizën në mbikëqyrjen e çështjeve komplekse teknike siç janë përgjimet.⁴¹ Zbatimi i këtyre dispozitave ligjore do të pajisë më mirë komisionin përgjegjës për t'u angazhuar në një dialog të informuar me institucionet e mbikëqyrura dhe për të ndërmarrë ekzaminime dhe hetime më efikase ndaj tyre. Dy çështje praktike duhet të zgjidhen me zbatimin e ligjit:

- Si do të trajtohen implikimet buxhetore të ligjit? Si do të financojë kuvendi punësimin e ekspertizës plotësuese (dy punonjës të përhershëm për mbështetje të personelit, regjistër i ekspertëve të punësuar rast pas rasti, personel i dërguar nga institucionet e tjera shtetërore) të parashikuar me ligj?
- Si do të zhvillojnë dy komisionet e tjera (mbrojtja dhe siguria, mbikëqyrja e shërbimeve të zbulimit) dhe Këshilli qytetar për mbikëqyrje mbështetjen e ekspertëve të cilët mund të mbështeten? Ligji nuk bën asnjë referim për mbështetjen administrative dhe asaj të ekspertëve të nevojshme për funksionimin e Këshillit. A do të jenë në gjendje të nxjerrin ekspertizë teknike specifike që do të përdoret nga komisioni i mbikëqyrjes së përgjimit kur të jetë e nevojshme?

Burimet e aftësisë së zgjeruar për mbikëqyrje të komisionit

- Qasja deri tek informatat.
- Procedura të qarta dhe të hollësishme të komisionit
- Personeli i parlamentit: përdorimi i 4 rretheve të ekspertizës së brendshme
 1. Këshilltarë personal
 2. Personeli i grupit parlamentar
 3. Personeli i komisionit
 4. Sektorët e specializuar (si Qendra parlamentare, departamenti legjislativ)
- Përdorimi i ekspertizës nga jashtë: akademia, OJQ-të,
- Bashkëpunimi me organet e tjera të mbikëqyrjes: Enti Shtetëror për Revizion, Avokati i Popullit, Këshilli qytetar për mbikëqyrje, Agjencia për mbrojtjen e të dhënave

3.3. Procedurat e komisioneve

Procedurat parlamentare (të quajtura "Rregullore të Punës") janë një grup rregullash, sjelljesh dhe zakonesh që rregullojnë takimet dhe aktivitetet e tjera të kuvendit. Rregullorja e punës (RRP) miratohet nga kuvendi në seancën e tij plenare, në fillim të çdo mandati të kuvendit. Qëllimi i tyre është të lehtësojë funksionimin e papenguar dhe efikas të parlamentit dhe të sigurojë një bazë për zgjidhjen e çdo çështjeje që mund të lindë, duke marrë parasysh të drejtat e anëtarëve të saj. Parimet e përgjithshme të procedurës parlamentare përfshijnë sundimin e shumicës me respekt për

⁴¹ Neni 58 i Ligjit gjithashtu i referohet angazhimit të ekspertëve - për të mbështetur organet përkatëse gjyqësore të cilat kontrollojnë zbatimin e përgjimeve.

të drejtat e pakicës.

Mandati dhe modalitetet e punës së shumicës së komisioneve parlamentare janë përkufizuar shkurtimisht në ligje dhe në Rregulloret e përgjithshme të punës të Kuvendit. Kjo u jep atyre autoritet të mjaftueshëm ligjor për të kryer mandatin e tyre. Sidoqoftë, komisionet me mandat posaçërisht të ndjeshëm dhe të vështirë, siç janë komisionet e mbikëqyrjes së shërbimeve të zbulimit, mund të kenë mandatin dhe kompetencat e tyre të mbikëqyrjes të përcaktuara në detaje me një vendim të posaçëm të kuvendit - i cili u jep atyre më shumë legjitimitet dhe besim ndërsa merren me mbikëqyrje, pasi që dëshmon mbështetjen e gjithë kuvendit për mandatin e tyre.

Rregullorja e Punës së Komisioneve miratohet nga anëtarët e komisionit në fillim të mandatit të komisionit, për të përcaktuar më mirë mandatin e tyre dhe për të mundësuar funksionimin e lehtë të procesit të vendimmarrjes brenda komisionit. Ajo zakonisht i referohet:

- Mandatit të komisionit - duhet të përshkruajë çështjet dhe / ose institucionet në fushën e kompetencës së komisionit. RRP-ja duhet të përditësohet (dhe votohet) shpesh, për çdo ndryshim të dizajnit institucional ose emërimit në fushën e kompetencës së komisionit. Ndërsa komisioni zhvillon ekspertizën dhe njohuritë e rrjeteve dhe aktiviteteve të shërbimeve të zbulimit, ata mund të duan të zgjerojnë ose ri-definojnë mandatin e tyre dhe modalitetet e angazhimit me institucionet e mbikëqyrura.
- Të drejtat dhe përgjegjësitë e kryetarit, deputetëve dhe stafit.
- Procedura e thirrjes dhe drejtimit të një takimi të komisionit (i rëndësishëm për të shmangur bllokimet nga kryesuesi nëse ai është i vetmi që mbetet përgjegjës)
- Rregullat e debatit dhe të votimit - duhet të sigurojnë që grupet minoritare të mund të shprehin pikëpamjet e tyre dhe të marrin pjesë në proceset e vendimmarrjes
- Mundësia e një anëtari të përfaqësuar nga kolegë të tjerë në rast mungese të pashmangshme.

Si e organizojnë komisionet parlamentare të mbikëqyrjes punën e tyre?

- Sjellin Rregulloren e Punës të komisionit.
- Qartësojnë mandatin dhe prioritetet e tyre: legjislacionin ose mbikëqyrjen; politikat, buxhetet apo operacionet.
- Vendosin në lidhje me profilin e personelit administrativ dhe të ekspertëve për të cilët kanë nevojë; përpiqen të bindin kuvendin (Këshilli i Buxhetit, neni 27 i Ligjit për Kuvendin) që të ndajë fonde të mjaftueshme për komisionin për të mundësuar punësimin e ekspertëve të nevojshëm (si për të përhershëm ashtu edhe të përkohshëm/ ose mbështetje për ndonjë çështje)
- Krijojnë nën komisione dhe / ose emërojnë raportues për mbikëqyrjen e një institucioni apo çështjeje të veçantë (siç është zbatimi i rekomandimeve të komisionit, një ligj apo reformë specifike). Ata kanë përgjegjësinë të monitorojnë çështjet përkatëse dhe të informojnë rregullisht komisionin për evolucionin e tyre, për të planifikuar dhe organizuar aktivitete konkrete mbikëqyrëse në atë fushë, për të siguruar komunikim të rregullt me shërbimin e mbikëqyrur për ato çështje, për të identifikuar nevojat e komisionit për ekspertizë të jashtme në këto çështje.
- Identifikojnë burimet e pavarura të informacionit dhe ekspertizës, jashtë shërbimeve të zbulimit dhe ekzekutivit: mjediset akademike, institutet kombëtare dhe ndërkombëtare, organizatat e shoqërisë civile etj.
- Shqyrtojnë se cilat mjete të mbikëqyrjes duhet t'i përdorin për të kuptuar mirë strukturat dhe proceset e shërbimeve të zbulimit - kërkojnë informim të rregullt, organizojnë vizita dhe inspektime në terren, ftojnë personelin e shërbimeve të zbulimit në seanca dëgjimore, parashtrojnë pyetje dhe ngrenë interpelanca në seancë plenare etj. Planifikojnë shfrytëzimin e mjeteve specifike të mbikëqyrjes sipas objektivave dhe prioriteteve specifike të mbikëqyrjes.
- Vendosin planin vjetor të aktiviteteve, për të lehtësuar planifikimin, angazhimin e ekspertëve dhe komunikimin me shërbimet e zbulimit (shih Shtojcën 3)
- Vendosin lidhje të mira me mediet - identifikojnë gazetarët që kanë interes dhe njohuri për çështjet e sigurisë të cilët janë të gatshëm të raportojnë për aktivitetet e komisioneve me profesionalizëm dhe objektivitet.

3.4. Takimet e përbashkëta dhe aktivitetet e mbikëqyrjes

Kuvendi maqedonas ka vendosur një mekanizëm kompleks dhe të specializuar institucional për mbikëqyrjen e shërbimeve të zbulimit, i përbërë nga tre komisione parlamentare dhe një organ mbikëqyrës i qytetarëve (shih seksionin 2.3.3). Përbërja, detyrat, ngarkesa e punës, transparenca dhe objektivat e këtyre organeve ndryshojnë. Ka përkim të pjesshëm të mandateve të tyre, por mund të ketë edhe aspekte të punës së zbulimit që futen në mes, duke u mundësuar shërbimeve të shmangin mbikëqyrjen kuptimplote nëse ky është qëllimi i tyre. Komunikimi, bashkëpunimi i ekspertëve dhe veprimi i përbashkët ndërmjet komisioneve janë të domosdoshme për disa arsye.

1. **Të kuptohen më mirë shërbimet e zbulimit.** Sektori i zbulimit është i madh dhe i ndërlikuar, ndërsa shërbimet e zbulimit nuk veprojnë në izolim. Komisionet përgjegjëse duhet të bëjnë një vlerësim real të gjendjes së sektorit të zbulimit dhe se si ai reagon ndaj mjedisit të sigurisë, në tërësinë e tij. Ndarja tradicionale e punës midis shërbimeve të zbulimit sfidohet nga kërcënimet ndërkufitare të sigurisë sot. Ka një integrim më të madh të përgjigjeve ekzekutive ndaj kërcënimeve, ndër-qeverisjes intensive dhe bashkëpunimit ndërkombëtar të shërbimeve të zbulimit, vijave të paqarta midis funksioneve të shërbimeve të zbulimit, ose ndërmjet përdorimit publik dhe privat të informacionit si pasojë e përdorimit të kontraktorëve. Mbikëqyrja është zhvilluar në mënyrë institucionale, me komisione parlamentare të fokusuara në departamente të veçanta qeveritare, por ajo që kërkohet sot është mbikëqyrja funksionale; me fjalë të tjera, kuvendi duhet të zhvillojë një kuptim gjithëpërfshirës të proceseve dhe rrjeteve që përfshijnë të gjithë ata që zhvillojnë veprime zbulimi lidhur me sigurinë.

2. **Bashkimi i burimeve dhe ekspertiza.** Burimet (stafi, koha, buxhetet) për mbikëqyrje janë gjithmonë shumë të vogla krahasuar me burimet e atyre që mbikëqyren; prandaj është jetësore që ato të shfrytëzohen maksimalisht për të pasur më shumë ndikim. Ekspertiza e zhvilluar nga secili komision në fushën e tyre të ekspertizës dhe përvoja e tyre në mbikëqyrje efektive duhet të ndahet me të tjerët. Ky është një hap i vogël drejt ndreqjes së asimetrisë së informacionit ndërmjet shërbimeve të zbulimit dhe kuvendit.
3. **Arritja e përfitimit sa më të madh politik.** Komisionet e përbashkëta mund të ndikojnë më mirë në pushtetin ekzekutiv dhe në sektorin e zbulimit. Komisionet nuk kanë fuqi të zbatimit; rekomandimet e tyre nuk janë ligjërish të detyrueshme për pushtetin ekzekutiv. Ata duhet të mbështeten në forcën e argumentit, në publicitetin dhe në mbështetjen shumëpalëshe për të bindur kuvendin që të ndjekë këshillat e tyre dhe pushtetin ekzekutiv për t'u pajtuar me rekomandimet e tyre. Kur veprojnë së bashku, komisionet kanë legjitimitet më të madh dhe zëri i tyre i përbashkët ka rëndësi të konsiderueshme politike.

Për këto arsye, zhvillimi i bashkëpunimit dhe plotësimit të veprimeve ndërmjet komisioneve të sigurisë dhe të zbulimit është thelbësor për mbikëqyrjen efektive. Është e drejta dhe përgjegjësia e komisioneve të përcaktojnë kur (situata) dhe si (procedurat) duhet të punojnë së bashku dhe të bashkojnë forcat në mbikëqyrje. Kjo mund të vendoset:

- Jo formalisht dhe ad-hoc, pas diskutimeve në mes të kryesuesve të komisionit dhe anëtarëve, për të debatuar dhe analizuar së bashku një politikë gjithëpërfshirëse, strategji të legjislacionit (si strategjia e sigurisë kombëtare, ligji për përgjimin e komunikimeve, statusi i personelit ushtarak, statusi i zyrtarëve të zbulimit etj) ose të hetojë një çështje me interes të përbashkët dhe të organizojë dëgjime të përbashkëta të zyrtarëve publikë, ose vizita të përbashkëta studimore dhe inspektive në terren.
- Formalisht, mund të parashikohet në Rregulloren e punës së secilit komision. RRP e secilit komision duhet të përshkruajë situatat dhe procedurat për takimet e përbashkëta, prandaj RRP aktuale duhet të ndryshohet në përputhje me rrethanat, pas konsultimeve midis komisioneve me qëllim të krijimit të dispozitave të ngjashme dhe konvergjente. Me kalimin e kohës, pasi që mbledhjet e komisioneve të përbashkëta të bëhen një praktikë e rregullt, mund të hartohet edhe Rregullorja e punës për mbledhjet e përbashkëta të komisioneve.
- Të tre komisionet që merren me mbikëqyrjen e sigurisë dhe të zbulimit duhet të zhvillojnë gjithashtu praktikën e mbledhjeve të përbashkëta me komisionet e tjera, në varësi të rastit, për të diskutuar politikën, legjislacionin apo veprimin e përbashkët të mbikëqyrjes.
- Bashkëpunimi dhe shkëmbimi i informacionit dhe ekspertiza me Këshillin qytetar për mbikëqyrje (shih pjesën 2.3.4) do të duhet të shqyrtohet me kujdes, veçanërisht nga Komisioni për mbikëqyrjen e përgjimeve.

Parimi kyç në organizimin e aktiviteteve të mbikëqyrjes duhet të jetë **realizimi i një qasje holistike të bazuar në rezultate** (Komisioni i Venedikut, 2015). Ajo që ka rëndësi nuk është se çfarë lloji, apo sa organe të mbikëqyrjes janë themeluar, por nëse rezultati përfundimtar i arritur është mbikëqyrja efektive.


4. KOMISIONI NË VEPRIM: MJETET E MBIKËQYRJES

Mjetet për mbikëqyrje të cilat janë në dispozicion të komisioneve parlamentare janë të ndryshme, por baza e tyre është **fuqia ligjore e kuvendit për të marrë informacion nga pushteti ekzekutiv** dhe rrjedhimisht të kërkojnë dokumente dhe raporte ose të thërrasin zyrtarët pushtetit ekzekutiv në mbledhjet e komisioneve dhe të kërkojnë që ata të shpjegojnë dhe justifikojnë veprimet e tyre.

Aktivitetet mbikëqyrëse të komisionit janë të pavarura nga aktivitetet plenare apo nga orari legjislativ. Komisionet vendosin programin e tyre dhe agjendën për mbikëqyrje, vendosin se kë të ftojnë në seanca ose mbledhje të komisionit - të cilat mund të jenë të hapura ose të mbyllura për publikun, në varësi nga vendimi i anëtarëve.

Ekzistojnë dy **strategji** të ndryshme, por megjithatë plotësuese, të mbikëqyrjes::

- **Proaktive:** Komisionet realizojnë aktivitete të quajtura **“patrulla policore”**, të cilat janë të rregullta dhe të planifikuara (që kërkojnë diskutime me agjencinë e mbikëqyrur) dhe përfshijnë takime të rregullta për të diskutuar legjislacionin apo zhvillimet e fundit të politikave, raporte të rregullta mbi aktivitetet të dorëzuara te komisioni, vizita në terren te zyrat qendrore apo hapësirat dhe zyrat rajonale, etj. Plani vjetor i komisionit – i shpërndarë tek institucionet e sigurisë dhe partnerët e interesuar – ndërton besim dhe ofron transparencë në raport me degën ekzekutive dhe publikun; ai gjithashtu siguron stabilitet dhe ju jep anëtarëve të komisionit mundësinë për të planifikuar aktivitetet e tyre për vitin që vjen.
- **Reaktive:** Kur komisionet të veprojnë vetëm pasi që është dëgjuar **“alarmi për zjarr”** dhe të organizojnë seanca dëgjimore ose hetime për të hetuar një problem të theksuar në debatet parlamentare, mediet ose ankesat e pranuar. Komisionet kanë autoritetin të thërrasin ministra, nëpunës civil apo ushtarak, drejtorë të agjencive ose ekspertë të pavarur, me qëllim që t'i përgjigjen pyetjeve të komisionit ose edhe të dëshmojnë nën betim.



Për të arritur rezultate të mira, është e rëndësishme që komisioni të kuptojë dhe të planifikojë mbikëqyrjen si një proces dhe jo si aktivitete të pavarura dhe të izoluar. Mjetet e ndryshme të mbikëqyrjes janë më të përshtatshme për fazat e ndryshme të procesit të mbikëqyrjes.

1. Marrja e informacionit dhe të kuptuarit e mirë të sektorit të zbulimit arrihet përmes raporteve, seancave konsultative dhe vizitave në terren.
2. Seancat dëgjimore, vizitat në terren, hetimet i mundësojnë anëtarëve të komisionit që të zhvillojnë ekspertizën e tyre në çështjet e sigurisë dhe të angazhohen në dialog të informuar me zyrtarët ekzekutiv, të pyesin për sqarime dhe hollësi specifike dhe të zhvillojnë kapacitetin e tyre për analiza të pavarura.
3. Pasi që të ketë fituar ekspertizën, komisioni është më mirë i pajisur për të vlerësuar punën e sektorit të sigurisë, të

identifikojë dobësitë dhe të formulojë zgjidhjet në formën e ligjeve, amendamenteve ligjore ose rekomandimeve për institucionet e sektorit të sigurisë.

4.1. Raportet

Raportet janë njëri nga mjetet më të fuqishme dhe më shpesh të përdorura të mbikëqyrjes.

Sipas parimeve të sundimit të së drejtës dhe ndarjes së pushtetit, në një shtet demokratik të gjithë sektorët e qeverisë janë të obliguar që t'i raportojnë kuvendit dhe opinjonit në masë të madhe. Ky është një parakusht për llogaridhënie demokratike. Raportet i mundësojnë kuvendit dhe organeve tjera mbikëqyrëse për të analizuar nëse ka respektim të politikës qeveritare dhe kornizës ligjore dhe a vlerësohen mjetet e dhëna të taksapaguesve. Shërbimet e zbulimit nuk përjashtohen nga kjo praktikë.⁴²

Në thelb, ekzistojnë dy kategori të raporteve: raportet për aktivitetet e rregullta të dorëzuara nga ana e shërbimeve të komisioni/kuvendi dhe raportet speciale mbi tema të caktuara, të hartuara me kërkesë të kuvendit.

Raportet e rregullta mbi aktivitetet⁴³ e shërbimeve të zbulimit janë lloji më i zakonshëm i raportimit. Ekzistojnë shumë shembuj të shërbimeve të zbulimit të cilat në mënyrë të rregullt, zakonisht njëherë në vit, nxjerrin raporte mbi aktivitetet që sigurojnë informata gjithëpërfshirëse dhe të dobishme për mbikëqyrje, pa komprometuar sigurinë kombëtare (Australia⁴⁴, Kanadaja⁴⁵, Kroacia⁴⁶, Republika Çeke⁴⁷, Holanda⁴⁸, Rumania⁴⁹). Ndonjëherë, teksti i cili është bërë publik nuk përmban domosdo të gjitha informatat të cilat fillimisht i janë dhënë parlamentit, pasi që disa informata janë larguar nga versioni publik⁵⁰.

Raportet e rregullta për aktivitetet mund të ndryshojnë për sa i përket gjatësisë dhe përmbajtjes varësisht nga zakoni lokal dhe përkufizimi ligjor i kompetencave të organit mbikëqyrës të cilit i adresohen. Krahas të gjitha dallimeve, raportet në përgjithësi përcjellin një logjikë të ngjashme dhe përmbajnë informata të ngjashme në tri fusha të gjera: Zbulimi – vetë agjencia dhe puna e saj, kërcënimi për sigurinë kombëtare dhe globale dhe mbikëqyrja, dispozitat (e konsiderueshme dhe financiare).

- Gjatësia mund të ndryshojë nga disa faqe koncize (Hollanda AIVD Raporti Vjetor 2016: 12 faqe) deri në një raport shumë të hollësishëm dhe të thuktë (Australia ASIO Raporti Vjetor 2016-17: 146 faqe, ose Raporti Vjetor i Belgjikës 2016: 227 faqe).
- Përmbajtja⁵¹ mund të mbulojë, pa zbuluar detaje të ndjeshme: objektivat vjetore dhe prioritetet e shërbimit; vlerësimin e saj për kërcënimet e mëdha ndaj sigurisë; çdo reformë të rëndësishme të politikave, sistemeve dhe operacioneve të zbulimit; përmbushjen e funksioneve të raportimit dhe llogaridhënies të shërbimit; dhe përgjigjen e shërbimit ndaj kërkesave për informacion sipas legjislacionit për liri të informimit.

Raportet e veçanta janë një shtesë ndaj raporteve të përgjithshme vjetore dhe zakonisht janë të kërkuara nga organi mbikëqyrës, në tema specifike të identikuara si problematike ose me interes të veçantë. Origjina e raporteve të tilla të veçanta mund të shtrihet në dispozitat ligjore ose në seancat e shqyrtimit të synuara apo dëgjimet nga organet mbikëqyrëse. Raportet e veçanta prodhohen nga shërbimi i zbulimit, ose bazohen në hulumtimin e kryer nga stafi ligjor dhe hetues në dosjet e shërbimit, me një mandat mbikëqyrës të dhënë nga organi mbikëqyrës/komisioni.

⁴² Born, Hans and Wills, Aidan (2012): *Overseeing Intelligence Services: A Toolkit*, p. 57 (Mbikëqyrja e shërbimeve të zbulimit: Doracak, fq. 57) https://dcaf.ch/sites/default/files/publications/documents/Born_Wills_Intelligence_oversight_TK_EN_0.pdf

⁴³ Një oficer më i vjetër për mbikëqyrje të zbulimit i Ministrisë së Mbrojtjes të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, po raporton si pikë kontakti brenda Departamentit të mbrojtjes organit për mbikëqyrje në baza tremujore.

⁴⁴ ASIO Raport vjetor 2016-17: <https://www.asio.gov.au/sites/default/files/Annual%20Report%202016-17.pdf>

⁴⁵ CSIS Raport publik: <https://www.csis.gc.ca/pblctns/index-en.php?cat=01>

⁴⁶ Agjencia për siguri -zbulim 2017: <https://www.soa.hr/UserFiles/File/pdf/SOA-Public-Report-2017.pdf>

⁴⁷ Shërbimi për siguri të informatave 2015: <https://www.bis.cz/vyrocní-zprávaEN890a.html?ArticleID=1104>

⁴⁸ AIVD Raport vjetor 2016: <https://english.aivd.nl/publications/annual-report/2017/04/04/annual-report-2016>

⁴⁹ Raporti i shërbimeve të zbulimit i Rumanisë 2012: https://www.sri.ro/assets/files/reports/2012/REPORT_on_the_Activity_of_the_Romanian_Intelligence_Service_in_2012.pdf

⁵⁰ ASIO Raporti vjetor 2016-17, fq. 135

⁵¹ Shih Shtojcën 3 për shembuj të informatave që përmbajnë këto raporte

Raportet e veçanta kërkojnë nga komisioni kërkuar të parashtrojnë pyetje të sakta dhe të orientuara kah subjekti. Kërkesat e raportimit duhet të jenë mjaft shteruese për t'iu përgjigjur pyetjes që duhet përgjigjur nga raporti, por jo e tepruar me qëllim për të shmangur një sasi të madhe dërrmuese të informacionit të parëndësishëm. Në këtë kuptim, shumë informacione mund të jenë po aq kufizuese sa dhe shumë pak informacione, për të ushtruar mbikëqyrje efektive.

Çfarë lloj raportesh të veçanta mund të marrin komisionet për mbikëqyrje të shërbimeve të zbulimit?

Bazuar në kërkesat ligjore:

- Akti i Kontrollit Parlamentar Slloven i Shërbimeve të zbulimit dhe sigurisë (neni 19) parashikon që çdo katër muaj dhe më shpesh nëse është e nevojshme, shërbimi t'i raporton Komisionit parlamentar për zbatimin e masave ndërhyrëse (si për sigurinë kombëtare ashtu edhe për hetimet penale). Raportet përfshijnë numrin e rasteve në të cilat janë urdhëruar masat, numrin e personave ndaj të cilëve janë urdhëruar dhe zbatuar masat, numrin e propozimeve të refuzuara, bazën ligjore për urdhërimin e masave në rastet individuale, numrin dhe llojin e mjeteve të komunikimit të kontrolluara në raste individuale, periudha kohore për të cilën janë urdhëruar masat individuale, të dhënat mbi parregullsitë e vërejtura gjatë zbatimit të masave në raste individuale. Raportet gjithashtu përmbajnë të dhëna mbi masat të cilat ende nuk kanë përfunduar. Komisioni mund të kërkojë raport të hollësishëm për masa të caktuara.
- Neni 195 i Kodit Penal të Kanadasë kërkon nga ministri i Sigurisë Publike dhe Përgatitjes Emergjente, si masë të llogaridhënies, të raportojë në kuvend për përdorimin e mbikëqyrjes elektronike për veprat penale që mund të ndiqen nga Prokurori i përgjithshëm.

Bazuar në hetimet e fokusuara:

- Komisioni parlamentar Britanik i zbulimit dhe sigurisë (ISC, i ngarkuar për mbikëqyrjen e të gjitha agjencive të zbulimit në Mbretërinë e Bashkuar) inicion raporte të tilla në mënyrë autonome nëse e sheh si të përshtatshme. Një shembull është Raporti i posaçëm i vitit 2017 mbi sulmet vdekjeprurëse me fluturake pa pilot (drone) të Britanisë së Madhe në Siri, i cili u krye për të vlerësuar bazën e zbulimit për sulme vdekjeprurëse me fluturake pa pilot (drone) mbi qytetarët e Mbretërisë së Bashkuar. ISC ka mbajtur sesione të dëshmimeve gojore dhe ka pranuar materiale të shkruara dhe raporte origjinale të zbulimit nga agjencitë e zbulimit. Mbi këtë bazë raporti është përpiluar dhe raportuar, si në shumicën e rasteve, të Kryeministri (në formë të klasifikuar) dhe në Parlament (ku është redaktuar materiali i ndjeshëm).⁵²

Raportet që vijnë nga departamentet qeveritare, dhe sidomos nga agjencitë e zbulimit janë shkruar me një vëmendje për "marrëdhëniet me publikun" dhe për këtë arsye ka gjasa të mos paraqesin tërë situatën. Ato janë të rëndësishme sepse ofrojnë një **pikënisje** për mbikëqyrësit për të zhvilluar pyetjet dhe strategjitë e tyre hetimore, duke përdorur mjete të tjera më të përpunuara të mbikëqyrjes.

4.2. Seancat e shqyrtimit

Seancat e shqyrtimit mund të jenë instrument efikas për mbikëqyrjen, nëse përdoren si duhet nga ana e kuvendit. Duke u bazuar në të drejtën kushtetuese për të marrë informata nga pushteti ekzekutiv, komisionet e përhershme kanë të drejtën që të kërkojnë pjesëmarrjen e zyrtarëve ekzekutiv në mbledhjet e tyre, aq shpesh sa që kanë dëshirë ata, me qëllim që të sigurojnë informata shtesë nga raportet e rregullta qeveritare. Disa kuvende bëjnë dallimin (në ligj, procedurë apo praktikë) midis seancave konsultuese dhe seancave dëgjimore.

Seancat konsultuese janë zakonisht të organizuara mbi çështje politike apo legjislative, për udhëzim dhe konsultim me zyrtarët qeveritar, ekspertët e pavarur dhe/ose palët e tjera të interesit. Informatat e hollësishme, të dorës së parë, të marra gjatë seancës së shqyrtimit do t'i mundësojnë komisionit që të bëjë analiza dhe vendime me informata më të mira mbi çështjen.

⁵² Komisioni parlamentar për zbulim dhe siguri (2017): Sulmet vdekjeprurëse me dronë në Siri, fq. 1 - 4

- Ndonjëherë seancat konsultuese thirren në mënyrë joformale, dhe nuk bëhet regjistrim fjalë për fjalë për takimin e mbajtur.
- Zakonisht seancat publike, konsultuese përmirësojnë transparencën e komisionit dhe informojnë opinionin për çështje të caktuara politike⁵³.

Seancat e shqyrtimit kanë për qëllim që të marrin dëshmi apo shpjegim më të gjerë mbi një çështje të caktuar. Ato janë një mjet efektiv për zbulimin e shkeljeve të mundshme, keqadministrimit, korrupsionit ose keqpërdorimit të pushtetit. Zyrtarët e qeverisë janë të ftuar për të dhënë informacion dhe për t'iu përgjigjur pyetjeve në fushën e tyre të kompetencës. Në shumicën e vendeve, ligjet dhe Rregullorja e punës përcaktojnë detyrimin e zyrtarëve të thirrur që të paraqiten para komisionit dhe të sigurojnë dokumentet dhe informacionin e kërkuar (ndonjëherë dokumentet mund të dërgohen para se të zhvillohet shqyrtimi). Mund të ftohen ekspertë të tjerë nga shoqëria civile, akademia ose institucione të pavarura për të sjellë dëshmi. Seancat e shqyrtimit zakonisht finalizohen me një raport i cili mund të përmbajë rekomandime për Qeverinë apo shërbimet e zbulimit.

- Seancat e shqyrtimit zakonisht mbahen të *mbyllura*, për të inkurajuar të punësuarit e lartë të agjencive të ndajnë informatat.
- Në raste të rralla, nëse tema e seancës së shqyrtimit është shumë e ndjeshme për sigurinë kombëtare, atëherë ka komunikim të kufizuar ose mediet dhe opinioni nuk informohen në lidhje me përmbajtjen e diskutimeve apo edhe në lidhje me mbajtjen e seancës.
- Dëshmitë me shkrim dhe me gojë që janë dhënë gjatë seancës janë të përfshira në procesverbalin e komisionit. Në një numër kuvendesh provat mund të merren vetëm pas një vendimi të seancës plenare, ndërsa në kuvende tjera komisionet ekzistuese janë të autorizuar të marrin prova vetëm gjatë një hetimi parlamentar.

Efektiviteti i seancave të shqyrtimit si një mjet për mbikëqyrje varet nga disa faktorë.

1. Pavarësia e komisionit në vendosjen për agjendën e seancës.

- Vendimi për mbajtjen e seancës së shqyrtimit në përgjithësi merret me një shumicë të thjeshtë nga anëtarët e komisionit, pa asnjë kërkesë për miratim të seancës plenare të parlamentit ose të organeve qeverisëse të tij.
- Komisionet kanë gjithashtu fuqi të zgjeruar për të vendosur mbi temën e seancës së shqyrtimit dhe të zyrtarëve ekzekutiv që ftohen për të dhënë informacione.
- Vendimi nëse seanca e shqyrtimit do të jetë publike ose e mbyllur zakonisht merret nga shumica e anëtarëve.

2. Autorizimet e komisionit anketues

- Në disa kuvende fuqia e komisionit për të thirrur personat në seanca të shqyrtimit është e kufizuar vetëm te ministrat dhe zyrtarët qeveritarë, por në kuvende të tjera, komisionet mund të kërkojnë pjesëmarrjen e ekspertëve jashtë qeverisë për të marrë një perspektivë të ndryshme mbi çështjet që diskutohen dhe për të thyer monopolin që zakonisht mbahet nga qeveria për informatat e sigurisë dhe të zbulimit.
- Ndonjëherë komisionet mbikëqyrëse mund të fillojnë një **hetim** (eventualisht me miratim nga seanca plenare), por më së shpeshti, kuvendi vendos të krijojë një komision ad-hoc, zakonisht me një mandat specifik dhe të ngushtë.

⁵³ Shih për shembull debatet publike mbi Ligjin për ndjekjen e komunikimeve në Maqedoni - nga 2012 (organizuar nga Komisioni për Çështje Evropiane) dhe 2018 (organizuar nga Komisioni për siguri dhe mbrojtje).

Neni 8. Seancat konsultative të shqyrtimit

Shqyrtimi konsultativ do të organizohet dhe kryhet me qëllim të mbledhjes së informatave dhe mendimeve profesionale të nevojshme për punën e Komisionit, dhe veçanërisht në lidhje me zgjidhjet e propozuara (zhvillimin e ligjeve, akteve nënligjore ose zgjedhja e kandidatëve); krahas përfaqësuesve të organeve shtetërore, mund të ftohen ekspertë dhe përfaqësues të organizatave joqeveritare për të lehtësuar përgatitjen cilësore të Komisionit për kryerjen e mbikëqyrjes parlamentare.

Komisioni mund të angazhojë ekspertë në cilësinë e konsulentëve.

Kostot e shkaktuara me angazhimin e ekspertëve si dhe pagat për punën e tyre do të paguhet në përputhje me aktin dhe në shumën e përcaktuar nga Komisioni administrativ.

Komisioni do të dorëzojë raportin për konkluzionet nga seanca konsultative e shqyrtimit deri te kuvendi.

Neni 9. Seancat kontrolluese

Seancat kontrolluese do të organizohen dhe do të realizohen për qëllim të marrjes së mendimeve dhe mbledhjes së informatave nën përgjegjësinë e Komisionit dhe në rast se ka nevojë të eliminohen paqartësitë, dilemat, mosmarrëveshjet lidhur me parimet apo të sqarohen çështjet aktuale të diskutueshme në zbatimin e politikës dhe ligjit dhe aktiviteteve të tjera të Qeverisë dhe autoriteteve të administratës shtetërore në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes.

Komisioni do të vendos nëse do të mbahet seancë kontrolluese me shumicë votash nga të gjithë anëtarët.

Në mbledhje do të ftohen përfaqësuesit përgjegjës të Qeverisë ose të autoriteteve të tjera të administratës shtetërore, si dhe persona të tjerë, prania e të cilëve kërkohet për sqarimin e lëndës.

Gjatë seancës kontrolluese, anëtarët e komisionit mund t'i parashtojnë pyetje personit të ftuar në seancë, me qëllim të sqarimit të çështjeve specifike.

Në seancën kontrolluese mund të ftohen ekspertë nga fusha të veçanta për qëllime të sqarimit profesional të dilemave specifike dhe paqartësive për të ndihmuar në përgatitjen cilësore të anëtarëve të komisionit për të kryer mbikëqyrjen parlamentare.

Pasi që të ketë mbaruar seanca kontrolluese, komisioni do të përgatis një raport dhe do t'ia dorëzojë kuvendit i cili mund të përmbajë një përmbledhje dhe mund të propozojë masa ose konkluzione përkatëse.

Neni 10. Hetimi parlamentar

Komisioni do të iniciojë hetim parlamentar nëse:

- 1) Gjetjet dhe konkluzionet nga seanca konsultative e shqyrtimit ose kontrolluese tregojnë se është e nevojshme që të shqyrtohet situata në lidhje me çështjet specifike;
- 2) Është e nevojshme të merren në konsideratë çështjet specifike me rëndësi publike ose të mblidhen informata dhe fakte për ndodhi dhe ngjarje specifike që kanë të bëjnë me politikën dhe punën e agjencive të sigurisë dhe mbrojtjes;
- 3) Gjetjet dhe konkluzionet mund të jenë baza mbi të cilën mund të vendos kuvendi për përgjegjësinë politike të

personave në pozita publike apo ndërmarrjen e veprimeve të tjera nën përgjegjësinë e tyre.

Neni 11. Procedura për seancë konsultative të shqyrtimit dhe për seancë kontrolluese dhe shqyrtimi parlamentar do të rregullohen sipas Rregullores së punës së Kuvendit.

4.3. Vizitat në terren

Vizitat në terren janë një mjet i fuqishëm për mbikëqyrje, pasi që i ofrojnë kuvendit mundësinë për t'iu qasur informatave nga dora e parë për punën e shërbimeve, të angazhohen me një numër të madh të personelit të zbulimit në krahasim me seancat parlamentare, të kontrollohen hapësirat, pajisja teknike dhe dosjet.

Ndryshe nga seancat e shqyrtimit, të cilat janë të bazuara në bashkëveprim dhe dialog me zyrtarët të cilët vijnë në kuvend, në territorin e komisionit, ndërsa në një vizitë në terren komisioni del në një mision eksplorues në territoret të cilat nuk i njeh, kupton apo kontrollon plotësisht. Rreziku është i lartë për humbjen e fokusit dhe largimi nga synimi i tij mbikëqyrës. Andaj, nevoja për tu mbështetur në personelin e ekspertëve është më e dukshme në vizitat në terren sesa në aktivitetet e tjera të mbikëqyrjes.

Një parakusht tjetër për vizita të suksesshme në terren është ekzistimi i procedurave të qarta. Rregullorja e punës së komisionit duhet në mënyrë të qartë të theksojë përgjegjësitë dhe hapat në realizimin e vizitave në terren, duke mundësuar vendimmarrje të qetë dhe efikase në të gjitha fazat.

Vizitat në terren mund të analizohen duke përcjellë tri faza kryesore: përgatitjen, zbatimin dhe hapat vijuese. Çdo fazë e këtij procesi do të jetë ndryshe - varësisht nëse vizita është organizuar si një aktivitet mbikëqyrës proaktiv (i paralajmëruar mirë paraprakisht, eventualisht i përfshirë në programin vjetor të komisionit), ose nëse është një vizitë reaktive për të kryer një hetim për ndonjë akuzë ose incident specifik.

Megjithatë, disa parime të përbashkëta inspirojnë organizimin e vizitave në terren në të gjitha rastet.

4.3.1. Përgatitja

Një përgatitje e mirë dhe një planifikim i duhur janë thelbësore për të zvogëluar rreziqet e dështimit, të cilat shtrihen nga shkaktimi i konflikteve me shërbimet, humbja e qëllimit të vizitës ose konflikti brenda ekipit vizitues. "Planifikimi i përsosur parandalon rezultate të dobëta"⁵⁴. Një përgatitje e mirë e vizitës ka disa hapa dallues:

Përkufizimi i vizitës, synimet dhe prioritetet

Komisioni duhet të diskutojë dhe të zhvillojë një bazë të përbashkët për qëllimet dhe prioritetet e vizitës (p.sh. të kuptohet më mirë funksionimi i shërbimeve, kontaktet me zyrtarët e lartë dhe personelin ekzekutues, kontrollin e ligjshmërisë së aktiviteteve, ndërtimin e besimit të ndërsjellë, hetimin e akuzave të medieve ndaj shërbimit ose ankesave të qytetarëve etj.).

- Synimi dhe prioritetet e vizitës duhet të jenë në pajtim me mandatin e komisionit. Ato duhet të definohen me kujdes, me mbështetjen e personelit të komisionit nga shërbimet juridike.
- Rekomandohet përfshirja e personelit përkrahës që nga fazat më të hershme.
- Nuk mund të planifikohen të gjitha vizitat shumë më herët dhe me një synim të përgjithshëm siç është të kuptohen proceset e zbulimit. Ndonjëherë vizitat organizohen në mënyrë urgjente pas incidenteve të mëdha, ankesave apo akuzave nga qytetarët, politikanët dhe mediet. Këto vizita në terren kërkojnë një përgatitje edhe më të mirë, me qëllim që të shmangen dështimet e mbikëqyrjes dhe të zvogëlohet rreziku i politizimi i tepërt i mbikëqyrjes ose të komprometimit të hetimeve të mundshme gjyqësore.

Prior discussions

Hapi i ardhshëm në fazën përgatitore përbëhet nga angazhimi në komunikim me ministrat dhe drejtorët e shërbimeve lidhur me qëllimin e komisionit për të organizuar një vizitë në terren; qëllimin dhe kontekstin konkret që bëri komisionin të vendosë mbi vizitën. Diskutimet do të përfshijnë lokacionin, kohën dhe temën e vizitës së planifikuar.

- Ky hap i paraprin planifikimit aktual të vizitës dhe është i rëndësishëm për të dalluar pengesat e mundshme dhe eliminimin e armiqësive potenciale.
- Drejtorët e shërbimeve munden në këtë pikë, veç më t'u sigurojnë komisioneve informata dhe dokumente përkatëse, për ta informuar atë për aspektet relevante të vizitës.
- Për arsye sigurie është e nevojshme të sqarohet dhe të pajtohen mbi mënyrën se si anëtarët e komisionit do të kenë qasje deri te hapësirat e shërbimeve.
- Çështjet e diskutuara dhe për të cilat ekziston marrëveshja duhet të shkruhen për të shmangur diskutimet e mëvonshme dhe keqkuptimet gjatë vizitave.

Zgjedhja e vendeve dhe gjërave për t'u vizituar

Komisioni vendos për vendet që duhet të vizitohen (hapësirat e shërbimit, instalimet lokale apo teknike etj.) dhe pajisjet specifike që duhet të vizitohen apo shqyrtohen (siç janë dhomat operative, arkivat, TI dhe bazat e të dhënave, kontakti me personelin).

⁵⁴ Komisioni Belg për shqyrtim të zbulimit

- Zgjedhja mund të bëhet më së miri pas udhëzimeve të përgjithshme të dhëna nga shërbimet që duhet të përfshijnë lokalizimin e hapësirave, edhe në rast se disa prej tyre janë informata të klasifikuara.
- Duhet të miratohet një regjim specifik për hapësirat specifike, siç janë shtëpitë e sigurta, ku sekreti është arsyeja e ekzistimit të tyre. Normalisht, komisioni nuk ka nevojë të dijë këto lokalizime, por mund të bëhet një marrëveshje me shërbimin që të gjitha këto objekte duhet të regjistrohen në një dosje të dedikuar, që mund të konsultohet nga komisioni në rast të incidenteve të mëdha.

Planifikimi dhe organizimi i vizitës në terren

Ky hap i referohet të gjitha përgatitjeve praktike dhe logjistike (orari kohor, periudha e realizimit, etj).

- Komisioni duhet të krijojë një ndarje të detyrave dhe një përshkrim të roleve për pjesëmarrësit (kryesuesit e ekipit vizitues, raportuesit, etj.).
- Komisioni duhet të vendosë se çfarë lloj raporti duhet të përgatitet (formal ose jo), cilat dokumente të tjera formale duhet plotësuar ose kërkuar nga shërbimi për t'i përgatitur.
- Është e rekomanduar gjithmonë që të përgatitet një numër i pyetjeve të përgjithshme dhe specifike për vendin e vizituar. Pyetjet e shpeshta i referohen asaj se si janë planifikuar, monitoruar dhe dokumentuar aktivitetet e zyrës.
- Gjetja e mekanizmave të kontrollit të brendshëm dhe personat përgjegjës për kontrollin e brendshëm është shumë e rëndësishme në çdo vizitë në terren që shqyrton respektimin e normave ligjore dhe regjistrimin e aktiviteteve.
- Është e dobishme që të diskutohen mekanizmat për vizita dhe reagimi i komisionit ndaj tyre. Sidomos duhet të merren parasysh dhe zbuten "skenarët në rastet më të vështira". Mund të ndodhë që, për shembull, të refuzohet qasja, të refuzohet ndonjë informatë e caktuar, të fillojnë diskutime të fuqishme me përfaqësuesit e shërbimeve, anëtarët e komisionit të mos pajtohen mes vete, të shkelen procedurat e vizitës, etj).
- Në disa raste, nëse komisioni ka një numër të madh të anëtarëve, ose nëse qëllimi i vizitës është shumë i ngushtë, mund të jetë praktike që të vendos për një ekip të vogël vizitues i cili e merr mandatin nga komisioni dhe i raporton atij. Hollësitë procedurale të një marrëveshjeje të atillë duhet të ceken shumë qartë në Rregulloren e punës së Komisionit. Është e rëndësishme të kihet përfaqësim politik nga të gjitha partitë më të mëdha, me qëllim që të sigurohet legjitimiteti i një nën komisioni të tillë.
- Të pajtohen me shërbimin për një person për kontakt, p.sh. oficeri komandues (OK) i vendit .

4.3.2. Zbatimi

Qasja deri te vendi i vizituar dhe fillimi i vizitës

- Anëtarët e ekipit vizitues duhet të tregojnë identifikimin, dhe nëse është e nevojshme, certifikatat e tyre të sigurisë. Është shumë e rekomanduar të sigurohet një kopje e dokumenteve.
- Nevojitet të shpjegohet mandati dhe qëllimi i vizitës për personelin i cili po e pranon komisionin. Të njoftojë për gjërat e kërkuara të vizitës, qasjen në dosjet dhe personelin si dhe rendin në të cilën dëshiron të vazhdojë komisioni.
- Një vizitë e pa paralajmëruar zakonisht kërkon miratimin e përgjithshëm paraprak të ministrit përgjegjës (pasi për shumë kuvende "pa paralajmërim" në fakt do të thotë se ministri informohet 24-48 orë më parë). Miratimi i përgjithshëm me shkrim i ministrit ose shefit të shërbimit i jep një urdhër formal anëtarëve të shërbimit për të pranuar dhe për të bashkëpunuar me komisionin vizitues. Mund të jetë në formën e një letre autorizimi.

Gjatë vizitës

- Pas prezantimeve është e zakonshme që të ftohet oficeri komandues të shpjegojë misionet dhe aktivitetet e personave në vendngjarje. Anëtarët e ekipit vizitues fillojnë me parashtrimin e pyetjeve të përgatitura.
- Përgatitja e vizitës duhet të tregojë se cilat janë mjetet e kontrollit (të brendshëm dhe të jashtëm) të parashikuara

në ligj ose në rregullore për të lejuar verifikimin e çështjeve të hetuara nga komisioni (siç janë mbishkrimet, librat e evidencës, listat e regjistrimit të TIK-ut, listat personale të personelit, lejet). Komisioni mund të kërkojë që të shih këto të dhëna dhe regjistra; dhe të bisedojë me personat përgjegjës për situatën dhe sfidat me të cilat ballafaqohen në kontrollin e brendshëm.

- Anëtarët nuk duhet vetëm të pyesin për shpjegime por duhet të ftojnë oficerin komandues t'ju tregojë shembuj nga dosjet, të dhënat dhe raportet dhe nëse është e mundur të kërkojë në mënyrë të rastësishme disa të dhëna.
- Në raste kur oficeri komandues e lejon këtë, hyni në bisedë me stafin ekzekutiv dhe pyetni disa pyetje për aktivitetet e tyre konkrete.
- Sigurohuni që diskutimet dhe gjetjet të shënohen/regjistrohen në mënyrë sistematike nga raportuesit.
- Duhet një mbikëqyrje objektive dhe e paanshme edhe në situata të ndërlikuara, që kanë të kaluar, të merren parasysh gjetjet në të gjitha drejtimet. Praktika e mirë është që të shënojë edhe gjetjet negative edhe ato pozitive. Edhe kur duket qartë se shërbimet janë në pajtim me standardet ligjore, është e nevojshme të shkruhet kjo në raporte kështu që të mbetet një pikë reference dhe krahasim për aktivitetet e ardhshme të mbikëqyrjes; mund të jetë e dobishme të jepni një citat, pozitiv ose negativ, për çdo artikull të listës së kontrollit ose listës së pyetjeve që udhëheqin diskutimin.

Qëndrimi gjatë vizitës

- Zakonisht është më produktive kur anëtarët e komisionit përmbahen nga të shprehurit e gjykimit të tyre në lidhje me situatën në deklarata të qarta. Edhe nëse kanë mendime të fuqishme, më mirë është që t'i formulojnë ato si pyetje, duke ftuar për një diskutim të mëtejshëm.
- Nuk është e rekomanduar që të hyhet në diskutime politike apo strategjike, sidomos jo brenda ekipit vizitues. Më mirë është të fokusohen në aktivitetet e shërbimit: cilat janë procedurat, prodhimet dhe rezultatet, se si bëhet zbulimi, cilat janë vendimet konkrete, si regjistrohet, kontrollohet, arkivohet informacioni.

Fundi i vizitës

Shpjegojani atë që vijon oficerit komandues dhe/ose personelit të tij (raporte, informata kthyesë, etj.). Përmbledhni çfarëdo marrëveshje që keni bërë gjatë vizitës, p.sh. për raportimin ose në lidhje me informata/dokumente plotësuese të cilat do t'i dërgohen ekipit vizitues.

Informim/diskutim

Shkurt pas vizitës, në kushte ideale dhe në të njëjtën ditë, rekomandohet të organizohet një diskutim/informim për vizitën me ekipin vizitues dhe/ose gjithë komisionin.

4.3.3. Hapat e mëtejshme pas vizitës në terren

Raportimi

Raportuesit duhet t'i dorëzojnë një raport shkresë ekipit vizitues dhe/ose komisionit sa më herët që të jetë e mundur. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet niveleve të klasifikimit dhe shpërndarjes së raportit jashtë komisionit. Raporti duhet të përfshijë mendimin e shumicës së anëtarëve, por gjithashtu të përfshijë mendimet e pakicave që mund të jenë në kundërshtim.

- Është e dobishme që të dallohen gjetjet: çështjet që kanë nevojë për hetime të mëtejshme, pasojat dhe rekomandimet e mundshme, implikimet për politikat/legjislacionin/buxhetin e ardhshëm.
- Rekomandimet duhet të ndahen në afatshkurta, afatmesme dhe afatgjata. Ato gjithashtu mund të dallohen sipas autoriteteve për të cilat flasin, si në shembullin në tabelën e mëposhtme.

PIKA	Mbikëqyrja e grupeve radikale	Veprimet që duhet të merren /autoriteti përgjegjës	Korniza kohore
GJETJET	1. Sipas mandatit ligjor	Nuk ka/Kuvendi	-
	2. Mungesa e planit operativ për mbledhje	Shëno planin e mbledhjes/kryesuesi i shërbimit i miratuar nga ministri	6 muaj
	3. Udhëzime minimale për personelin	Zhvillimi i instruksioneve formale/kryesuesi i shërbimit	1 vit
	4. Nuk ka gjetje për praktika të paligjshme nga personeli operativ	Nuk ka	-

Informata kthyesë

Ministri dhe shërbimi i vizituar duhet të marrin një reagim të duhur, duke përfshirë konkluzionet dhe rekomandimet si dhe një kërkesë për të raportuar se si po zbatohen rekomandimet.

Tabela më lartë, mund të kompletohet edhe me një kolonë për pasimin e asaj se çfarë është realizuar e çfarë jo.

Vlerësimi

Pas një vizite në terren ose pas një sërë vizitash, mund të bëhet një vlerësim nga komisioni (ose nga një ekspert i jashtëm/trup parlamentar) me qëllim që të përshtatet vazhdimi dhe metodologjia nëse është e nevojshme.

Raportimi më i gjerë

Në një moment - dhe ndoshta në një nivel tjetër të klasifikimit - mund të bëhet një raport më i gjerë për tërë kuvendin dhe/ose për opinionin.

Si të zhvillohet përvoja dhe praktika e komisionit për organizimin e vizitave në terren?

- Në mënyrë ideale, Rregullorja e punës së komisionit përshkruan me hollësi dhe qartësi se si organizohen vizitat në terren. Nëse jo Rregullorja e punës, atëherë duhet të caktohet një protokoll i përgjithshëm në fillim të mandatit të komisionit që përfshin vizitat e planifikuara dhe të pa paralajmëruara.
- Një komision i ri duhet të fillojë me vizita të paralajmëruara paraprakisht, mbi tema dhe qëllime të përgjithshme, siç është kuptimi më i mirë i organizatës, funksioneve dhe aktiviteteve të zbulimit. Një vizitë studimore në ndërtesën e selisë qendrore është fillimi më i mirë për të marrë një pasqyrë të operacioneve, administratës etj dhe më pas të kalohet në zyrat funksionale/rajonale më specifike.
- Kjo u jep si komisionit, ashtu dhe shërbimeve mundësinë për të mësuar rreth perspektivave të njëri-tjetrit dhe për t'u njohur me vizitat në një mjedis pa konflikt.
- Mund të jetë e dobishme që të planifikohet një periudhë e vizitave të njoftuara dhe të pajtoheni për një pikë fillimi nga e cila mund të fillojnë vizitat e paparalajmëruara. Parashikoni paraprakisht se edhe pse në një "periudhë të njoftuar të vizitës", vizitat mund të bëhen pas një njoftimi të shkurtër në situata urgjente.
- Kur anëtarët e komisionit kanë certifikata të sigurisë, kontrolloni që certifikatat e tyre dhe ato të personelit shoqëruar të jenë në nivelin e duhur (në varësi nga qëllimi dhe tema e vizitës në terren) dhe se mbulojnë qasjen fizike në vendet dhe hapësirat.
- Sigurohuni që shërbimet të kuptojnë "nevojën për të ditur" për mandatin e posaçëm mbikëqyrës të komisionit, duke përfshirë autoritetin ligjor të komisionit dhe bazën ligjore për mandatin e mbikëqyrjes së komisionit
- Lini vendet më të ndjeshme (si objektet e përgjimit) për një fazë të mëvonshme, kur komisioni të ketë fituar një kuptim të mirë të pamjes së përgjithshme, në mënyrë që ata të dinë më mirë se çfarë dhe si të pyesin.
- Një përgatitje e mirë është vendimtare për suksesin e vizitës; mungesa e njohjes së mirë të legjislationit dhe funksionimit të shërbimeve mund të japë një përshtypje të dobët për komisionin, por është gjithashtu një rast i humbur për të krijuar dhe përmirësuar mbikëqyrjen e mirë.

4.4. Hetimet

Hetimet janë një mekanizëm shumë i fuqishëm mbikëqyrës dhe ata kanë një potencial të rëndësishëm për të shpalosur faktet e mbuluara nga qeveria. Hetimet bëhen gjithmonë në kuadrin e një mandati të veçantë dhe të ngushtë - duke përcaktuar temën, qëllimin dhe afatin kohor të hetimit.

Një hetim parlamentar kërkon kompetenca të posaçme të hetimit, të quajtura edhe **kompetenca për thirrje për dëshmim**. Kjo do të thotë se rregullat e procedurës penale zbatohen *mutatis mutandis* për marrjen e provave. Me fjalë të tjera, zyrtarët e thirrur duhet t'i sigurojnë komisionit dokumente dhe informata nën betim, ngjashëm me një dëshmi në një gjykatë dhe me të njëjtat pasoja nëse dështohet për t'u siguruar e vërteta. Megjithatë, këto kompetenca hetuese mund të zbatohen **vetëm** në lidhje me çështjen e menjëhershme të hetimit dhe kohëzgjatja e tyre është e kufizuar në kohë, me mandatin e hetimit.

Rregullorja e punës së Kuvendit duhet të japë udhëzime të qarta rreth kushteve në të cilat mund të iniciohet një hetim, duke mundësuar pjesëmarrjen e barabartë të opozitës dhe të grupeve të pakicave në vendimin për organizimin dhe mandatin e një hetimi. Shumë pak komisione të përhershme kanë fuqinë për të udhëhequr hetimet dhe kur ata e bëjnë këtë, ata duhet të marrin leje dhe një mandat nga seanca plenare⁵⁵ (përgjashtime bëhen në Gjermani, Belgjikë, Holandë, Kanada dhe Mal të Zi).

Më së shpeshti, hetimet parlamentare udhëhiqen nga **ad-hoc komisione ndër partiake të hetimit**. Ato krijohen me një vendim/rezolutë të Kuvendit në seancë plenare, me mandat për të mbledhur informacione për incidente të veçanta ose episode me shqetësim të madh politik. Komisionet hetimore fillojnë pas ngjarjes brengosëse, por brenda një afati të arsyeshëm kohor, në mënyrë që mësimet të mësohen menjëherë. Atyre u jepen afate të caktuara për të kryer hetimet e tyre. Pas dorëzimit të raportit përfundimtar në parlament, komisioni i hetimit shpërbëhet. Më poshtë janë dhënë disa shembuj:

- "NSA hetimi" në Gjermani (Untersuchungsausschuss "NSA") i nisur në Bundestag në mars 2014.
- Parlamentet kombëtare në Francë dhe Belgjikë, krijuan që të dyja komisione të posaçme kërkuese/hetimore pas sulmeve terroriste të viteve 2015 dhe 2016.
- Senati Rumun në vitin 2006 ka themeluar ad-hoc komision hetimor i cili ka hetuar për dy vjet ekzistencën e vendeve të fshehta të paraburgimit të CIA-s në territorin kombëtar.

Çfarë kompetenca të posaçme të hetimit mund të kenë komisionet?

Komisioni i mbrojtjes në Bundestagun gjerman ka një pozitë të shkëlqyeshme, pasi që themelimi i tij është parashikuar në kushtetutë dhe është komisioni i vetëm i cili mund të deklarohet se është komision hetimor (neni 45a, paragrafi (2) i ligjit bazë). Në rastin e të gjitha komisioneve të tjera, Kuvendi duhet të marrë një vendim për një qëllim të tillë. Një komision hetimor është arma më efektive e kuvendit për të shqyrtuar sjelljen e Qeverisë, duke pasur të drejta të ngjashme me Prokurorinë Publike. Takimet në të cilat merren provat janë të hapura për publikun, përveç nëse kërkohet fshehtësia ushtarake. Takimet në të cilat vlerësohen provat nuk janë të hapura për opinionin.

Komisionet e Kongresit të SHBA kanë kompetenca për thirrje; refuzimi për të dëshmuar para një komisioni ose mosdhënia e një dokumenti të kërkuar konsiderohet si shpërfillje e Kongresit dhe mund të dënohet me burgim deri në 1 vit dhe me gjobë prej 1 000 dollarë.

Ligji i Malit të Zi për mbikëqyrjen parlamentare në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes parashikon ndëshkime për dështim të përgjigjes në thirrjet e komisionit ose mosdhënien e informacionit të kërkuar (neni 22), duke shqiptuar gjoka që shkojnë deri në 2,000 euro për punonjësit dhe 20,000 euro për subjekte juridike.

Në praktikë, megjithatë, një numër i vogël i hetimeve parlamentare kanë dhënë rezultate të kënaqshme, të paktën në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë. Shpeshherë kjo është rezultat i burimeve dhe aftësive të pamjaftueshme hetimore të vëna në dispozicion të komisioneve hetimore. Kjo sugjeron që në shumicën e vendeve, informacioni që kuvendi merr është në fund të fundit informacioni që shërbimet e zbulimit vendosin ta ndajnë.

⁵⁵ Në vitin 2007 një rishikim i mjeteve parlamentare të mbikëqyrjes në 88 kuvende të kryera nga IPU ka zbuluar se vetëm në 13 kuvende komisionet e përhershme mund të udhëheqin hetime, gjithmonë me lejen e seancës plenare.

5. JASHTË RRETHIT TË FSHEHTËSISË: MBIKËQYRJA E SHËRBIMEVE TË ZBULIMIT .DHE PUBLIKU

Llogaridhënia është një zinxhir marrëdhëniesh të cilat përfundimisht çojnë te publiku. Përmes zgjedhjeve, publiku ka deleguar pushtetin e tij te përfaqësuesit e tij, por e ruan të drejtën për të ditur se si organet shtetërore mbrojnë interesat kombëtare dhe shpenzojnë fondet publike. Vlera e mekanizmave të mbikëqyrjes mbështetet jo vetëm në atë se si ata arrijnë të rezultojnë në llogaridhënien e shërbimeve të zbulimit, por edhe në transparencën e tyre dhe në hapjen ndaj publikut.

Themelimi i komisioneve të specializuara të mbikëqyrjes së shërbimeve të zbulimit në shumicën e kuvendeve demokratike detyrimisht nuk ka çuar në drejtim të rritjes së përgjegjësisë publike dhe në transparencën e sektorëve të zbulimit. Në vend të kësaj, janë pikërisht organet mbikëqyrëse të shërbimeve të zbulimit ato të cilat ndikohen thellësisht nga normat e fshehtësisë që rrjedhin nga shërbimet e sigurisë dhe të zbulimit. Një numër studimesh tregojnë një trend drejt "mbajtjes në fshehtësi" të mbikëqyrjes, pasi që shqetësimet për fshehtësinë mbizotërojnë mbi përgjegjësinë për të informuar publikun në lidhje me llogaridhënien e shërbimit të fshehtë. Në shumicën e kuvendeve takimet e komisioneve janë të mbyllura si rregull, mbledhjet e tyre, pikat e rendit të ditës dhe konkluzionet mbahen sekrete dhe asnjë nga raportet e tyre nuk shpërndahen në publik.

Për publikun, mbikëqyrja e bërë në fshehtësi është mbikëqyrje e pakryer. Mungesa e shënimeve publike të hapura për denoncimin e gabimeve, abuzimeve, problemeve individuale ose sistematike në shërbimet e inteligjencës do të përfundojë duke minuar besueshmërinë e kuvendit si mbikëqyrës kompetent i interesit publik dhe si një mbrojtës syhapur i të drejtave individuale. Një heshtje e zgjatur për çështjet e zbulimit do të bëjë që komisionet dhe kuvendi në përgjithësi të duken joefektive dhe madje edhe në përputhje me marrëdhëniet e tyre me shërbimet e zbulimit.

Për këto arsye, komisionet për mbikëqyrjen e zbulimit duhet të informojnë publikun për punën e tyre; ata duhet të komunikojnë me mediet, shoqërinë civile dhe organet e tjera të pavarura mbikëqyrëse, të krijojnë aleanca dhe partneritete të dedikuara për përmirësimin e llogaridhënies demokratike.

5.1. Raportimi publik

Deputetët i përfaqësojnë votuesit e tyre dhe janë përgjegjës ndaj publikut për aktivitetet e tyre parlamentare. Është e pamundur që publiku të vëzhgojë punën e përfaqësuesve të tyre nëse puna e tyre bëhet vetëm pas dyerve të mbyllura.

Duke pasur parasysh natyrën sekrete të teknikës dhe operacioneve të zbulimit, është e pamohueshme që transparenca e plotë e mbikëqyrjes nuk është as e mundur dhe as e dëshirueshme. Komisionet duhet të harmonizojnë kërkesën demokratike për transparencë me kufizimet po aq të rëndësishme për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar. Nëse ligjet janë të qarta në përcaktimin se çfarë është informacioni i klasifikuar dhe çfarë është informacioni me interes publik, dhe nëse komunikimi midis shërbimeve dhe komisionit është efektiv, duke u bazuar në besim të ndërsjellë dhe respektimin e procedurave, komisioni me lehtësi mund të dallojë atë që mund të publikohet dhe atë që duhet të mbahet në rrethin e fshehtësisë.

Komisionet kanë disa mënyra për t'i raportuar publikut, prej të cilave më të shpeshtat janë:

- Njoftimet për shtyp nga komisioni - zakonisht të përpiluara nga stafi i komisionit dhe të miratuara nga kryetari i komisionit ose nga të gjithë anëtarët (nëse bëhet fjalë për temë të ndjeshme politike),
- Zyra e Kuvendit për Marrëdhënie me Publikun - ata mbajnë komunikimin me gazetarët e akredituar në kuvendet; ata zakonisht punësojnë specialistë për komunikim, të cilët mund të ndihmojnë komisionet në përpilimin e njoftimeve për shtyp apo edhe për krijimin e një strategjie për komunikim

- Raportet e Komisionit mbi legjislationin dhe mbikëqyrjen (versionet e paklasifikuara) publikohen në faqen e internetit të parlamentit
- Intervistat e dhëna nga deputet individualë para shtypit.

Si pasojë e zbulimeve të Snowdenit nga viti 2013 në lidhje me programet e vëzhgimit masiv të kryera nga disa qeveri, pati një përpjekje të konsiderueshme të agjencive të zbulimit për të përmirësuar komunikimin, shkëmbimet dhe bashkëpunimin me organet e mbikëqyrjes dhe veçanërisht me publikun e gjerë. Në një numër të madh të vendeve shërbimet e zbulimit sot publikojnë **Raportet vjetore të aktiviteteve** të tyre. Kjo është një shenjë se komuniteti i zbulimit është i vetëdijshëm se sa është e rëndësishme mbështetja publike, legjitimiteti dhe besueshmëria në një shoqëri demokratike. Shpesh, këto raporte të aktiviteteve japin informacione mjaft të hollësishme rreth asaj se si shërbimi ka qenë i mbikëqyrur nga kuvendi⁵⁶.

Raporti vjetor i aktivitetit të shërbimeve të zbulimit zakonisht i dorëzohet kuvendit përpara se të publikohet. Komisionet e mbikëqyrjes së shërbimeve të zbulimit e analizojnë raportin dhe diskutojnë me shërbimin për çështjet eventuale të cilat kanë nevojë për sqarime. Pastaj, raporti paraqitet në seancën plenare dhe para publikut. Diskutimi plenar i raportit të veprimtarisë vjetore të shërbimit është një ushtrim i përbashkët i transparencës për komisionet e mbikëqyrjes - në disa kuvende është rasti i vetëm ku komisionet e mbikëqyrjes së shërbimeve të zbulimit shprehin publikisht vlerësimet e tyre të përgjithshme për aktivitetet e shërbimeve të zbulimit.

Komisionet e zbulimit gjithashtu prodhojnë raportet e tyre vjetore të veprimtarisë. Shpesh ata kanë detyrimin ligjor të dorëzojnë këto raporte tek organi udhëheqës i kuvendit, i cili ka të drejtë diskrecioni për ta bërë raportin publik, përfundimisht pas redaktimit të tekstit për të larguar informacionet e ndjeshme. E njëjta procedurë zbatohet për ad-hoc raportet e mbikëqyrjes nga komisioni. Ka procedura formale ose joformale përmes të cilave agjencitë duhet të konsultohen për materialet që ata besojnë se nuk duhet të bëhen publike.

Cilat janë praktikat raportuese në kuvendet e ndryshme?

Duke ditur se besueshmëria e mbikëqyrjes varet në komunikimin me publikun, korniza ligjore mbi mandatin dhe kompetencat e komisionit për mbikëqyrjen e shërbimeve të zbulimit në Kuvendin Rumun u plotësuan në vitin 2017. Dispozita e mëparshme e cila përcaktonte se “të gjitha informacionet në lidhje me punën e komisionit janë informacion i klasifikuar” janë zëvendësuar me një ri-afirmim të përgjegjësisë së komisionit për të mbrojtur informacionin e klasifikuar, sipas ligjeve përkatëse.² Në frymën e këtyre ndryshimeve të rregulloreve, komisioni është bërë më aktiv dhe ka filluar të publikojë informata për aktivitetet e saja në faqen e internetit të kuvendit. Ndërkohë nuk ka ekzistuar asnjë informacion për aktivitetet e komisionit në dekadën e fundit, në vitin 2017 komisioni ka mbajtur 45 seanca, ka iniciuar hetime dhe shqyrtime dhe ka bërë njoftime të shpeshta për mediet.

Në Mbretërinë e Bashkuar, komisionari me kompetenca hetuese duhet të dorëzojë raport në afat sa më të shkurtër pas kalimit të çdo viti kalendarik. Kryeministri ka mundësi të largojë materiale nga raporti nëse publikimi mund të dëmtojë vazhdimësinë e kryerjes së funksioneve të agjencive.

Komisionet e mbikëqyrjes së shërbimeve të zbulimit nga kuvendet e Italisë, Francës, Gjermanisë, Suedisë dhe Mbretërisë së Bashkuar kanë obligim ligjor të publikojnë raportet e tyre vjetore të veprimtarisë. Madhësia e këtyre raporteve dallon, nga 93 faqe (Francë) e deri në 14 faqe (Gjermani), ato i referohen të dhënave statistikore mbi aktivitetet e komisionit (si numri i seancave dhe orët e punës), metodat e mbikëqyrjes, dialogu ndërinstitucional, rekomandimet³.

⁵⁶ Mund të ndodhë që shërbimi i zbulimit të raportojë mbi aktivitetet e mbikëqyrjes ndërsa komisioni i mbikëqyrjes së shërbimit të zbulimit të jetë plotësisht jo transparent ndaj publikut. Gjë që nuk e vë kuvendin në një dritë të favorshme.

⁵⁷ HP nr. 85/tetor 2017, neni I(5).

⁵⁸ Agjencia e Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore (FRA) Vëzhgimi nga shërbimet e zbulimit: mbrojtja e të drejtave themelore dhe mjetet juridike në BE, Vëllimi II: Perspektivat në terren dhe përditësimi ligjor, 2017, faqe 87 dhe faqe 164

5.2. Vlerësimi i mbikëqyrjes

Problemi kryesor në vlerësimin e efektit të komisioneve mbikëqyrëse është fakti se ka pak informacione në dispozicion për aktivitetet e tyre. Sfidat e dytë ka të bëjë me mungesën e kriterëve evidente për efektin. Faktori më i rëndësishëm që duhet të ndiqet është ndikimi i mbikëqyrjes mbi aktivitetet e shërbimeve. Komisionet e mbikëqyrjes duhet të mbajnë shënime nga zbulimet dhe rekomandimet e tyre dhe të vendosin një sistem të përcjelljes së tyre, me një vëmendje të veçantë për zhvillimet ligjore të shkaktuara nga mbikëqyrja.

Një vetëvlerësim është zgjedhja e parë dhe më e lehtë për një komision i cili dëshiron të vlerësojë ndikimin e punës së tij në institucionin e mbikëqyrur. Një vetëvlerësim ofron disa avantazhe krahas një vlerësimi të kryer nga ekspertë të jashtëm:

- Duke qenë një ushtrim vullnetar, i ndërmarrë në mungesë të vëzhguesve të jashtëm, ai kontribuon në një debat të pakufizuar mbi përparësitë dhe dobësitë e komisionit;
- Kjo shmang problemet lidhur me qasjen në informacionin e klasifikuar dhe fshehtësinë e punës së komisionit (gjë që do të ishte pothuajse e pakapërcyeshme për një të huaj);
- Është një ushtrim i mirë mësimi, duke ngritur vetëdijen dhe ekspertizën mbi parimet e mbikëqyrjes, mjetet dhe praktikatat e mira;
- Maksimizim i mundësisë për përdorim dhe lidhje të rezultateve me reformat kombëtare.

Në përgjithësi, një vetëvlerësim ka më shumë potencial se sa një vlerësim i jashtëm për të kontribuar në konsolidimin institucional. Megjithatë, kjo do të kërkonte mbështetje nga stafi i ekspertëve për të konceptuar dhe lehtësuar ushtrimin (përgatitje të pyetësorëve, intervista gjysmë të strukturuar me aktorë të ndryshëm, diskutimet në fokus grupe, etj.).

Në vend të vetëvlerësimit, mund të kërkohet nga një ekspert i jashtëm ose grup i ekspertëve që të kryejnë një revizion të efektit të aktiviteteve të komisionit. Përveç se ndoshta një ekip i jashtëm kushton më shumë, ekipi i jashtëm për të bërë vlerësim do të duhej të ketë /ose të merr certifikatën e sigurisë dhe legjitimitetin e dhënë nga një mandat të miratuar nga Kuvendi.

- një momenti fillestar (bazë) në të cilën mund të mblidhen informacione (treguesit)
- përkufizimi i situatës së dëshiruar (synimi) dhe
- një krahasim i rregullt i të dhënave gjatë një periudhe të caktuar të mbikëqyrjes.

Shumica e treguesve që mund të ndiqen janë cilësor, por edhe treguesit sasior, që mund të shprehen përmes një numri, duhet të vendosen me kujdes në kontekst.

Treguesit sasior mund të referojnë në numrin e: takimeve të komisionit/ çështjeve në rendin e ditës/ raporte të rregullta të cilat janë pranuar dhe për të cilat është debatuar/ raporte të posaçme të cilat janë kërkuar/ seanca dëgjimore/ vizita në terren/ raportet e komisionit të paraqitura në seancë plenare/ aktivitetet mbikëqyrëse të iniciuara nga grupet e pakicave/ ankesat kundër shërbimeve/ mandatet për përgjim të pranuar dhe të refuzuara, etj.

Treguesit cilësor - pasqyrojnë gjykimet e njerëzve, mendimet dhe qëndrimet e njerëzve ndaj një situatë ose subjekti të caktuar. Ata janë më të rëndësishëm në përcjelljen e trendëve në punën e kuvendit, pasi që mbikëqyrja është në thelb komplekse, politike dhe cilësore në natyrë. Ja disa shembuj:

Treguesit cilësor - pasqyrojnë gjykimet e njerëzve, mendimet dhe qëndrimet e njerëzve ndaj një situatë ose subjekti të caktuar. Ata janë më të rëndësishëm në përcjelljen e trendëve në punën e kuvendit, pasi që mbikëqyrja është në thelb komplekse, politike dhe cilësore në natyrë. Ja disa shembuj:

- Niveli i besimit reciprok, dialogu dhe bashkëpunimi mes komisionit, ministrive përkatëse dhe shërbimeve të zbulimit
- Zbatimi i rekomandimeve parlamentare nga pushteti ekzekutiv dhe ofruesit e sigurisë
- Reagimi i ministrisë/shërbimeve ndaj kërkesave për informata dhe thirrjeve për seanca dëgjimore.

- Të kuptuarit e rolit dhe të funksioneve të kuvendit (brenda kuvendit dhe brenda sektorit të zbulimit)
- Vetëdija dhe të kuptuarit nga kuvendi i ligjeve dhe procedurave relevante
- Qëndrimi i kuvendit ndaj mbikëqyrjes dhe vullnetit politik për të mbajtur qeverinë dhe shërbimet të përgjegjshme
- Marrëdhëniet e krijuara nga komisioni me organet e pavarura që kanë mandat për të luajtur një rol në qeverisjen demokratike (Këshilli qytetar për mbikëqyrje, Enti Shtetëror për Revizion, Avokati i Popullit, Agjencia për mbrojtjen e të dhënave, etj.)
- Përdorimi i medieve nga deputetët për të njoftuar qëndrimet dhe pikëpamjet
- Përdorimi i ekspertizës së pavarur të ofruar nga shoqëria civile në punën e komisionit
- Ekzistimi i fokusit të drejtave të njeriut në aktivitetet e mbikëqyrjes
- Imazhi i kuvendit /dhe i komisionit në media
- Imazhi i shërbimeve në media ose në opinionin publik;
- Transparenca e shërbimeve (raportet publike, informacionet e dhëna në bazë të ligjit për qasje të lirë në informata me interes publik, ekzistenca e një zyre për marrëdhënie me publikun, etj.)

Cilat janë kërkesat e mbikëqyrjes efektive?

Qasja: mbikëqyrja dhe qasja në informata duhet të shtrihet deri te personeli, vendet dhe informacionet e klasifikuara që janë të nevojshme dhe të mjaftueshme që mbikëqyrësit të kryejnë mandatin e tyre.

Besimi: sistemet e mbikëqyrjes duhet të jenë të dizajnuara për të ruajtur fshehtësinë dhe integritetin e procesit të zbulimit. Besimi është i nevojshëm për të fituar mirëbesimin e shërbimeve të zbulimit dhe për të mbrojtur interesat kombëtare.

Pavarësia: mbikëqyrja duhet të jetë e pavarur nga interesat partiake dhe nga influenca e papërshtatshme e shërbimeve të zbulimit.

Autoriteti: mbikëqyrja efektive varet nga autorizimet diskreionale të hetimit, duke përfshirë fuqinë për të detyruar dëshmitë nën betim.

Bashkëpunimi: Anëtarët e komisioneve të Kuvendit duhet të zhvillojnë marrëdhënie pune me organet e tjera të mbikëqyrjes, si në kuadër të Kuvendit ashtu edhe jashtë – me Avokatin e Popullit, Këshillin qytetar për mbikëqyrje, Drejtorinë e Sigurimit për Informacione të Klasifikuara, Drejtoria e Mbrojtjes së të Dhënave Personale dhe Enti Shtetëror për Revizion.

5.3. Roli i shoqërisë civile në mbështetjen e mbikëqyrjes demokratike të shërbimeve të zbulimit

Mediet, akademja dhe “think-tank”-ët, si dhe një spektër i gjerë i organizatave të shoqërisë civile të përqendruara në sektorin e sigurisë dhe/ose çështjet e të drejtave të njeriut, po sigurojnë mbikëqyrjen publike të çështjeve të zbulimit. Në vitet e fundit, pas zbulimeve të Snowdenit, publiku i interesuar është bërë i vetëdijshëm për gjërat e njohura mirë në politikën ndërkombëtare: shërbimet sekrete kanë kapacitetin për të pushtuar hapësirën informative private pa dallim dhe në mënyrë masive. Ky ndërgjegjësim i ri ka rezultuar në mobilizimin e organizatave të shoqërisë civile që angazhohen më me vëmendje dhe më zëshëm në mbikëqyrjen e shërbimeve të zbulimit dhe sigurisë, një ushtrim që gradualisht zhvillon ekspertizën dhe besueshmërinë e tyre.

Publiku mund të ushtrojë presion të drejtpërdrejtë politik mbi kuvendin dhe qeverinë, ndërsa mediet luajnë një rol kyç në rritjen e vetëdijes publike, duke orientuar vëmendjen e qeverisë në tema të rëndësishme dhe duke ekspozuar sjelljet

e gabuara në shërbimet e zbulimit. Skandalet mund të çojnë në hetime dhe të rezultojnë në reforma që përmirësojnë llogaridhënien dhe efektivitetin e zbulimit. Deputetët kanë aftësinë që të rrisin vëmendjen përmes medieve dhe të ushtrojnë presion mbi qeverinë për të ndryshuar politikat dhe praktikën. Presioni i medias sot është i madh, dhe paraqet mënyrën më të shpejtë dhe më efektive për të ushtruar presion mbi qeverinë.

Mbikëqyrja publike duhet të përballet me dilemën e atyre që dinë dhe nuk flasin dhe ata që flasin dhe nuk dinë. Në të vërtetë, rregulla e fshehtësisë është një problem i madh për ata që janë jashtë rrjetit të fshehtësisë për të bërë vëzhgime përkatëse mbi shërbimet e sigurisë, por ka shumë shembuj ku shtypi, akademia dhe OJQ-të luajnë një rol të rëndësishëm në debatin publik mbi sigurinë. Është më e lehtë në vendet ku ekziston një traditë e kulturës së sigurisë, por gjithashtu edhe një kulturë e të drejtave të njeriut që i mban qëndrimet në ekuilibër.

Në demokracitë e reja, është përgjegjësi e komisioneve të mbikëqyrjes për të kontribuar në zhvillimin e një kulture politike dhe qytetare dhe të luajë rolin e një ndërmjetësuesi midis botës së mbyllur të shërbimeve dhe të publikut. Ata duhet të ndihmojnë në tejkalimin e dyshimit tradicional dhe të ndërsjellë midis shoqërisë civile dhe institucioneve shtetërore, veçanërisht atyre që veprojnë në fshehtësi.

OJQ-të mund të sigurojnë analiza të pavarura të legjislacionit, politikave dhe të praktikave që lidhen me punën e shërbimeve të zbulimit. Ato mund të paraqesin opsione të ndryshme të politikave, të identifikojnë boshllëqet në legjislacionin ekzistues dhe /ose të paraqesin analiza krahasuese të disa aspekteve të zbulimit. Anëtarët e OJQ-ve zakonisht konsiderojnë legjislacionin dhe politikat në mënyrë jopartiake, nga aspekti i mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të njeriut sipas standardeve ndërkombëtare për qeverisjen e mirë. Ata gjithashtu mund të inkurajojnë debat publik mbi prioritetet, politikat dhe nevojat për ndryshimin e legjislacionit. OJQ-të mund të përmbajnë përfshirjen e pakicave në punën e shërbimeve të zbulimit ose në shërbimet me ndjeshmëri gjinore.

Cilat janë kushtet për mbikëqyrje efektive publike?

Efektiviteti i mbikëqyrjes publike varet nga qasja në informata të besueshme. Rregullat ligjore për klasifikimin e informacioneve duhet të pajtojnë llogaridhënien dhe transparencën me fshehtësinë e arsyeshme, për shembull përmes:

- Ligjet e lirisë së informimit që lejojnë publiku të ketë qasje në të dhënat që i ruan Qeveria;
- Oraret e klasifikimit të cilat përcaktojnë qartë, çfarë, kur dhe për sa kohë mund të mbahet informacioni sekret, duke përfshirë një afat kohor të caktuar për de-klasifikimin e tij;
- Mbrojtja e treguesve që lejojnë personelin e shërbimeve të zbulimit të zbulojnë informacione që ekspozojnë sjellje të gabuara të organeve të brendshme ose të jashtme pa frikë të ndëshkimit për shkeljen e obligimeve të tyre për të ruajtur fshehtësinë dhe bindjen.

SHTOJCAT

SHTOJCA A: PASQYRË E LEGJISLACIONIT TË MAQEDONISË PËR MBIKËQYRJE PARLAMENTARE

KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Neni. 68

Kuvendi i Republikës së Maqedonisë:

[...]

- bën zgjedhjen, emërimin dhe shkarkimin edhe të bartësve të tjerë të funksioneve publike dhe funksioneve të tjera të përcaktuara me Kushtetutë dhe me ligj;

- ushtron kontroll dhe mbikëqyrje politike mbi Qeverinë dhe mbi bartësit e tjerë të funksioneve publike të cilët përgjigjen para Kuvendit;

[...]

Neni. 76

Kuvendi themelon trupa punues të përhershëm dhe të përkohshëm. Kuvendi mund të themelojë komisione anketuese për të gjitha lëmenjtë dhe për çdo çështje me interes publik. Propozim për themelimin e komisionit anketues mund të paraqesin së paku 20 deputetë. Kuvendi themelon komision të përhershëm anketues për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të shtetasit. Të dhënat e komisioneve anketuese janë bazë për iniciimin e procedurës për përcaktimin e përgjegjësisë së bartësve të funksioneve publike.

LIGJI PËR KUVENDIN E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

V. MBIKËQYRJA PARLAMENTARE

Debatet mbikëqyrëse

Neni. 20

(1) Debati mbikëqyrës mbahet me qëllim që të merren informata dhe mendime profesionale për çështjet nga fushëveprimi i trupit punues në lidhje me përcaktimin dhe zbatimin e politikës, zbatimin e ligjeve dhe të aktiviteteve të tjera të Qeverisë dhe të organeve të administratës shtetërore.

(2) Debatin mbikëqyrës e zbaton trupi punues amë i Kuvendit i cili në mbledhje mund të ftojë përfaqësues të autorizuar të Qeverisë ose të organeve të administratës shtetërore dhe të kërkojë prej tyre informata dhe sqarime të cilat janë objekt i debatit mbikëqyrës.

(3) Në debatin mbikëqyrës mund të ftohen edhe persona të tjerë të cilët mund të japin informata për çështjet të cilat janë objekt i debatit mbikëqyrës.

(4) Përfaqësuesit e autorizuar të ftuar janë të obliguar të marrin pjesë në mbledhje në të cilën do të do të mbahet debati mbikëqyrës.

(5) Për mbajtjen e debatit mbikëqyrës, kryetari i trupit punues e njofton Kryetarin e Kuvendit. Kryetari i Kuvendit për mbajtjen e debatit mbikëqyrës e njofton me shkrim Qeverinë. Me njoftimin Kryetari i Kuvendit do të kërkojë që Qeveria të caktojë një ose disa përfaqësues të autorizuar për çështjet të cilat janë objekt i debatit mbikëqyrës.

(6) Kryetari i trupit punues amë përfaqësuesin e autorizuar të Qeverisë ose të organeve të administratës shtetërore i fton me shkrim në mbledhjen e trupit punues në të cilën do të mbahet debati mbikëqyrës dhe e njofton për çështjen e cila është temë e debatit dhe mund të kërkojë nga ai që informatat, mendimet dhe qëndrimet t'i paraqesë edhe në formë të shkruar më së voni tri ditë para mbajtjes së mbledhjes së trupit.

(7) Mjetet për mbajtjen e debateve mbikëqyrëse sigurohen nga mjetet e Kuvendit të parapara në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë.

(8) Për mbajtjen e debatit mbikëqyrës opinioni informohet nëpërmjet ueb-faqes së Kuvendit dhe Kanalit të Kuvendit.

Neni. 21

(1) Iniciativë për mbajtjen e debatit mbikëqyrës mund të ngrejë një anëtar i trupit punues amë.

(2) Për mbajtjen e debatit mbikëqyrës trupi punues vendos me shumicë votash nga numri i pranishëm i anëtarëve, ndërsa së paku me një të tretën e numrit të përgjithshëm të anëtarëve.

(3) Nëse 15 deputetë në formë të shkruar kërkojnë mbajtjen e debatit mbikëqyrës, nëpërmjet Kryetarit të Kuvendit kryetarit të trupit punues, atëherë kryetari i trupit punues është i obliguar që menjëherë të thërrasë mbajtjen e tij.

(4) Kryetari i Kuvendit me nënkryetarët dhe koordinatorët e grupeve të deputetëve, kryetarit dhe anëtarëve të trupit punues mund t'i japë rekomandim për mbajtjen e debateve mbikëqyrëse të caktuara.

Neni. 22

(1) Gjatë debatit mbikëqyrës, anëtarët e trupit punues amë dhe deputetët të cilët nuk janë anëtarë të trupit punues amë mund t'u parashtrojnë pyetje përfaqësuesve të autorizuar të Qeverisë ose të organeve të administratës shtetërore të ftuar në debat, vetëm në lidhje me çështjen e cila është objekt i debatit.

(2) Gjatë debatit mbikëqyrës, me personat e ftuar të cilët i sigurojnë informatat mund të mbahet diskutim vetëm nëse është e domosdoshme që të harmonizohen ose qartësohen çështje dhe fakte konkrete.

(3) Trupi punues amë vendos për kohëzgjatjen e debatit me ç'rast sigurohet pjesëmarrja e çdo anëtari të trupit punues amë në debat.

Neni. 23

(1) Debati mbikëqyrës, sipas rregullit, incizohet në mënyrë fonografike dhe për të njëjtin mbahet procesverbal, ndërsa përmirësime teknike dhe të tjera mund të bëhen në marrëveshje dhe në pajtim me personin, deklarata e të cilit është në pyetje.

(2) Trupi punues i paraqet Kuvendit raport për debatin e mbajtur mbikëqyrës në të cilin është përfshirë esenca e diskutimeve, ndërsa mund të propozojë edhe konkluzione të cilat i dorëzohen edhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë.

(3) Konkluzionet nga debati publik publikohen në ueb-faqen e Kuvendit.

LIGJI PËR PUNË TË BRENDSHME

Tekst i konsoliduar jozyrtar ("Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 42/2014, 116/2014, 33/15, 5/16, 120/16, 127/16, 142/16, 190/16)

Kontrolli nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë

Neni. 60

Kuvendi i Republikës së Maqedonisë (në tekstin e mëtejshëm: Kuvendi) kryen kontroll, përkatësisht mbikëqyrje mbi punën e Drejtorisë përmes komisionit përkatës (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni i Kuvendit).

Programi dhe Raporti deri te Komisioni i Kuvendit për punën e Drejtorisë

Neni. 61

(1) Deri te Komisioni i Kuvendit Drejtoria dorëzon program dhe raport për punë.

(2) Programi nga paragrafi (1) i këtij neni, dorëzohet deri në fund të muajit janar për vitin rrjedhës, ndërsa raporti për punën e vitit paraprak dorëzohet deri në fund të shkurtit të vitit të ardhshëm.

Njoftimet, të dhënat dhe informatat që Drejtoria ia jep Komisionit të Kuvendit

Neni. 62

(1) Me kërkesë të Komisionit të Kuvendit, Drejtoria mundëson këqyrje dhe ia jep Komisionit të Kuvendit njoftimet e nevojshme, të dhënat dhe informatat nga fushëveprimi i punës së Komisionit të Kuvendit që kanë të bëjnë me procedurën e kryerjes së punëve në kompetencë të Drejtorisë.

(2) Të gjitha të dhënat, njoftimet dhe informatat e dorëzuara në Komisionin e Kuvendit ose të nxjerra në mbledhje të Komisionit, paraqesin informatë me shkallë përkatëse të klasifikimit.

(3) Anëtarët e Komisionit të Kuvendit detyrohen t'i mbrojnë informatat e klasifikuara për të cilat kanë kuptuar ose në të cilat kanë pasur qasje gjatë ose lidhur me punën në Komisionin e Kuvendit, në pajtim me rregullat nga sfera e informatave të klasifikuara.

(4) Obligimi për mbrojtjen e fshehtësisë së informatave të klasifikuara vazhdon edhe pas ndërprerjes së funksionit - anëtar i Komisionit të Kuvendit, përkatësisht me ndërprerjen e mandatit të Kuvendit, në pajtim me rregullat nga sfera e informatave të klasifikuara.

Raporti te Kuvendi për punën e Komisionit

Neni. 63

(1) Komisioni i Kuvendit, deri te Kuvendi dorëzon raport për punën e kryer së paku një herë në vit.

(2) Raporti nga Komisioni nga paragrafi (1) i këtij neni paraqet informatë të klasifikuar me shkallë të klasifikimit përkatës me shkallën e klasifikimit të raportit të dorëzuar nga ana e Drejtorisë.

(3) Konkluzionet lidhur me raportin e Komisionit të Kuvendit, Kuvendi i dorëzon në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë.

LIGJI PËR AGJENCINË E ZBULIMIT

- Përkthim jozyrtar -

"Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 19/95

II. MBIKËQYRJA E PUNËS SË AGJENCISË

Neni. 9

Kuvendi i Republikës së Maqedonisë kryen mbikëqyrje të punës së Agjencisë nëpërmjet komisionit përkatës (ne tekstin e mëtejshëm: Komisioni):

Neni. 10

Komisioni dorëzon deri te Kuvendi i Republikës së Maqedonisë raport për punën e kryer më së shumti njëherë në vit. Para dorëzimit të raportit nga pika 1 e këtij neni, Komisioni është i obliguar ta dorëzojë raportin deri te drejtori i Agjencisë për të marrë mendimin e tij, veçanërisht nga aspekti i fshehtësisë së pjesëve të caktuar të tij.

Neni. 11

Drejtori është i obliguar të mundësojë kontroll dhe t'i jep të gjitha njoftimet dhe të dhënat nga fushëveprimi i punës së Komisionit. Njoftimet dhe të dhënat të e paraqitura në mbledhjen e Komisionit llogariten për fshehtësi shtetërore.

Neni. 12

Konkluzionet në lidhje me raportin e punës së Komisionit, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë e dorëzon deri te kryetari i Republikës së Maqedonisë dhe deri te Qeveria e Republikës së Maqedonisë.

LIGJI PËR MBROJTJE (Përkthim jozyrtar)

Tekst i konsoliduar jozyrtar ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" 42/2001, 58/06, 110/08, 51/11, 151/11, 215/15, Vendimi i Gjyqit Kushtetues të Republikës së Maqedonisë D. nr. 37/2002 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 73/2002) dhe D.nr. 135/2002 dhe 155/2001 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 78/2002))

KREU III: KOMPETENCAT E ORGANEVE TË PUSHTETIT SHTETËROR

Neni 17

Në realizimin e mbrojtjes Kuvendi i Republikës së Maqedonisë

1. kryen mbikëqyrje në realizimin e kompetencave të Qeverisë në mbrojtje dhe e ndjek gatishmërinë për mbrojtje të Republikës;
2. përcakton ekzistimin e rrezikut të menjëhershëm ushtarak nga sulmi mbi Republikën;
3. shpall fillimin dhe mbarimin e gjendjes së luftës;
4. vendos për lartësinë e mjeteve për nevojat e mbrojtjes;
5. miraton buxetin e Republikës për gjendjen e luftës;
6. miraton vendim për hyrje në anëtarësi dhe dalje nga anëtarësi të Republikës nga sistemet kolektive të sigurisë dhe mbrojtjes;
7. ratifikon marrëveshje ndërkombëtare që kanë të bëjnë me hyrjen, kalimin ose qëndrimin e forcave të armatosura të huaja në territorin e Republikës për aktivitete ushtruese, trajnim dhe pjesëmarrje në operacione paqësore ose humanitare, si edhe për pjesëmarrjen në ato aktivitete dhe operacione të njësiteve të Armatës së Republikës në vende të huaja;
8. miraton konceptimin nacional për siguri dhe mbrojtje të Republikës;
9. shpall ditën e Armatës, dhe
10. miraton konkluzione dhe rezoluta në lidhje me realizimin e sistemit të mbrojtjes, planet për zhvillimin e mbrojtjes, pajisjes dhe gatishmërisë luftarake të Armatës.

Raport për aktet të përmendur në pikën 10 të këtij neni dorëzon Qeveria në bazë të kërkesës së Kuvendit ose së paku në dy vite.

Për shkak të njoftimit me aktivitetet të Armatës, deputeti në Kuvend mund të kërkojë nga Ministria e Mbrojtjes të organizojë vizitën e tij të njërive, komandave dhe shtabeve të Armatës

LIGJI PËR NDJEKJEN E KOMUNIKIMEVE

"Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 71/2018

IV. MBIKËQYRJA DHE KONTROLLI MBI ZBATIMIN E MASAVE PËR NDJEKIBN E KOMUNIKIMEVE

1. Trupat mbikëqyrës për zbatimin e masave për ndjekjen e komunikimeve

Trupat mbikëqyrës

Neni. 35

(1) Mbikëqyrja mbi masat për ndjekjen e komunikimeve që zbatohen nga organet e autorizuar, si dhe mbikëqyrja mbi operatorët dhe AOT-it kryhet nga ana e:

- Kuvendit të Republikës së Maqedonisë;
- Drejtorisë për Sigurinë e Informatave të Klasifikuara;
- Drejtorisë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe
- Avokatit të Popullit të Republikës së Maqedonisë.

(2) Mbikëqyrje mbi masat për ndjekjen e komunikimeve që zbatohen nga organet e autorizuar, si dhe mbikëqyrje mbi AOT-bën Këshilli për Kontroll Civil.

(3) Me kërkesë të trupave mbikëqyrës nga paragrafi (l) i këtij neni AOT-i ndihmon në zbatimin e mbikëqyrjes mbi operatorët.

(4) AOT-i në pajtim me Ligjin për Agjencinë Operative Teknike në mënyrë të pavarur apo me kërkesë të organeve të autorizuar kryen mbikëqyrje profesionale mbi operatorin.

Obligimet për ruajtjen e sekretit zyrtar

Neni 36

(1) Personat në trupat mbikëqyrës nga neni 35 i këtij ligji dhe ekspertët nga neni 39 i këtij ligji kanë për detyrë t'i ruajnë si sekret zyrtar informatat e klasifikuara duke i përfshirë edhe të dhënat personale të cilat kanë ardhur gjatë mbikëqyrjes së kryer në pajtim me ligjin.

(2) Obligimi nga paragrafi (1) i këtij neni zgjat edhe pas përfundimit të funksionit të tyre në trupat mbikëqyrës, përkatësisht edhe pas përfundimit të angazhimit të tyre si ekspert për periudhë prej pesë vitesh.

Obligimet për certifikatën e sigurisë

Neni 37

(1) Personat nga neni 36 paragrafi (1) i këtij ligji obligohen të posedojnë certifikatë të sigurisë me shkallë përkatëse për qasjen tek informatat e klasifikuara.

(2) Certifikata e sigurisë nga paragrafi (1) i këtij neni lëshohet në afat jo më të gjatë se 30 ditë nga dita e parashtrimit të kërkesës, me kushtet dhe në procedurën e përcaktuar me ligj.

1.1 Mbikëqyrja nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë

Përbërja e Komisionit

Neni 38

(1) Për kryerjen e mbikëqyrjes nga neni 35 i këtij ligji Kuvendi i Republikës së Maqedonisë nga radhët e deputetëve në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë, formon Komision për Mbikëqyrje mbi Zbatimin e Masave për Ndjekjen e Komunikimeve (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni).

(2) Komisioni përbëhet prej kryetarit, katër anëtarëve, zëvendëskryetarit dhe katër zëvendës anëtarëve.

(3) Kryetari i Komisionit, përkatësisht zëvendësi i tij është nga radhët e partisë politike në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë në opozitë, e cila në zgjedhjet e fundit për deputete a fituar më së shumti vota, dy anëtarë të Komisionit, përkatësisht zëvendësit e tyre janë nga radhët e partive politike në pushtet dhe dy anëtarë, përkatësisht zëvendësit e tyre janë nga radhët e partive politike në opozitë në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë.

Akreditimi i ekspertëve teknike

Neni 39

(1) Komisioni nga neni 38 i këtij ligji për shkak të kryerjes efektive të mbikëqyrjes angazhon ekspertë teknikë nacional apo ndërkombëtar, me njohjen e dërgatë profesionale përkatëse, të cilat në bazë të akreditimit të tyre, mundin në mënyrë aktive të marrin pjesë në mbikëqyrje, si pjesë e Komisionit.

(2) Menjëherë pas formimit të vet dhe jo më vonë se 50 ditë, Komisioni zgjedh dy ekspertë për mbështetje të përhershme, e në afat prej gjashtë muajsh harton listë të eksperteve nacionalë apo ndërkombëtarë plotësues të cilët mund të akreditohen si ekspertë për çdo rast veç e veç për periudhë që është e domosdoshme për përgatitjen, realizimin dhe njoftimin për rezultatin teknik të mbikëqyrjes së kryer.

(3) Me kërkesë të Komisionit, Agjencia për Komunikime Elektronike, Drejtoria për Sigurinë e informatave të Klasifikuara dhe Drejtoria për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, organi i autorizuar i cili nuk është lëndë e mbikëqyrjes dhe cilido qoftë institucion tjetër shtetëror i jep mbështetje eksperte Komisionit për çështjet nga kompetenca e tyre të përcaktuara me ligj, gjatë kohës së kryerjes së mbikëqyrjes, në pajtim me këtë ligj.

Qëllimi dhe procedura për kryerjen e mbikëqyrjes

Neni 40

(1) Komisioni kryen mbikëqyrjen nga neni 35 i këtij ligji me qëllim që të përcaktohet ligjshmëria e zbatimit të masave për ndjekjen e komunikimeve nga neni 7 dhe neni 18 të këtij ligji, si dhe efektiviteti i zbatimit të masave të veçanta hetuese.

(2) Komisioni dhe ekspertët e akredituar teknike si pjesë e Komisionit, gjatë kryerjes së mbikëqyrjes, për shkak të përcaktimit të ligjshmërisë së masave nga paragrafi (1) i këtij neni bëjnë krahasimin e të dhënave nga nenet 41, 42 dhe 43 të këtij ligji, të cilat organet e autorizuar, AOT-i dhe operatorët i kanë në pronësi, i posedojnë apo gjenerojnë.

(3) Komisioni për përcaktim të efektivitetit nga paragrafi (1) i këtij neni, në mbledhje e shqyrton raportin vjetor të Prokurorit Publik të Republikës së Maqedonisë për masat e veçanta hetuese, të cilin Prokurori Publik i Republikës së Maqedonisë e dorëzon deri te Kuvendi i Republikës së Maqedonisë në pajtim me ligjin.

Të dhënat të cilat gjate kryerjes së mbikëqyrjes kërkohen nga operatori

Neni 41

Te dhënat të cilat janë në pronësi, i posedon apo gjeneron operatori dhe të cilat janë të arritshme me kërkesë të Komisionit apo të cilat drejtpërdrejt merren nga ekspertet e akredituar teknike si pjese e Komisionit gjate kohës së kryerjes së mbikëqyrjes janë:

- logot për kohën dhe datën e fillimit të masës për ndjekjen e komunikimeve;
- logot për kohën dhe datën e përfundimit të masës për ndjekjen e komunikimeve;
- logot për konfirmim të aktivizimit;
- logot për numrin e përgjithshëm të konfirmimeve pozitive të kryera në periudhën e caktuar kohore.

Të dhënat te cilat gjatë kryerjes së mbikëqyrjes kërkohen nga AOT-i

Neni 42

Të dhënat të cilat janë në pronësi, i posedon apo gjeneron AOT-i, e të cilat janë të arritshme me kërkesë të Komisionit apo të cilat drejtpërdrejt merren nga ekspertët e akredituar teknik si pjesë e Komisionit gjatë kohës së kryerjes së mbikëqyrjes janë:

- urdhëresa e anonimizuar gjyqësore dhe urdhëresa e anonimizuar e përkohshme me shkrim;
- logot për numrin e urdhëresës të anonimizuar gjyqësore;
- logot për kohën e fillimit dhe përfundimit të zbatimit të masës për ndjekjen e komunikimeve;
- logot për numrin e përgjithshëm të masave të zbatuara për ndjekjen e komunikimeve për periudhën e caktuar kohore.

Të dhënat të cilat gjatë kryerjes së mbikëqyrjes kërkohen nga organet e autorizuar

Neni 43

Të dhënat të cilat janë në pronësi, i posedojnë apo gjenerojnë organet e autorizuar, e të cilat janë të arritshme me kërkesë të Komisionit gjatë kohës së kryerjes së mbikëqyrjes janë:

- urdhëresa e anonimizuar gjyqësore dhe urdhëresa e anonimizuar e përkohshme me shkrim dhe
- dokumentet të cilat kanë të bëjnë me fillimin dhe fundin e zbatimit të masës për ndjekjen e komunikimeve.

Mënyra e kryerjes së mbikëqyrjes

Neni 44

(1) Komisioni e kryen mbikëqyrjen pa njoftim paraprak, sipas nevojës, e së paku një herë në tre muaj madje edhe në mungesë të shumicës së votave.

(2) Pas mbikëqyrjes së kryer Komisioni harton raport për mbikëqyrjen e kryer në të cilin theksohet nëse është konstatuar veprimi ligjor apo joligjor, përkatësisht nëse ekziston keqpërdorimi në veprim.

(3) Në rast kur në raportin nga paragrafi (2) të këtij neni përcaktohet veprimi ligjor, ky dorëzohet në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë, për çka Komisioni e informon publikun.

(4) Në rast kur gjatë mbikëqyrjes së kryer do të përcaktohen parregullsitë apo keqpërdorimet në procedurën e zbatimit të masave për ndjekjen e komunikimeve të përcaktuar me dispozitat e Ligjit për procedure penale dhe dispozitat e këtij ligji, si dhe shkelje e cilësdo marrëveshjeje ndërkombëtare të ratifikuar në pajtim me Kushtetutën e Republikës së

Maqedonisë, Komisioni ka për detyrë:

- në afat prej 24 orësh ta njoftojë prokurorin publik kompetent.
- në rast të cenimit ose të dhënave personale apo të drejtave të njeriut i njofton organet kompetente përkatëse;
- nëse ka mundësi dhe pa theksimin e të dhënave konkrete e informon Kuvendin e Republikës së Maqedonisë;
- nëse ka mundësi dhe pa prononcim të të dhënave konkrete e informon publikun.

Raportet e Komisionit

Neni 45

- (1) Komisioni parashtroi raport vjetor në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë për vitin kalendarik paraparak, më së voni deri në fund të muajt shkurt në vitin rrjedhës.
- (2) Raportin nga paragrafi (1) i këtij neni Kuvendi e shqyrton dhe e miraton me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i deputetëve dhe jep rekomandime për punën e Komisionit.
- (3) Sipas nevojës dhe në bazë të kërkesës së Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, Komisioni dorëzon raporte plotësuese.
- (4) Për raportin nga paragrafi (2) i këtij neni në mënyrë përkatëse njoftohet publiku.

Rregullorja e punës

Neni 46

Komisioni miraton Rregullore për punën e vet, me të cilën rregullohen çështjet për mënyrën e punës së Komisionit, si dhe për mënyrën e angazhimit të ekspertëve teknikë.

1.2 Këshilli për Mbikëqyrje Civile Emërimi i Këshillit

Neni 47

Me qëllim të realizimit të mbikëqyrjes civile të ligjshmërisë së zbatimit mbi masat për ndjekjen e komunikimeve emërohet Këshilli për Mbikëqyrje Civile (ne tekstin e mëtejshëm: Këshilli).

Përbërja e Këshillit

Neni 48

- (1) Këshilli përbehet prej kryetarit dhe gjashtë anëtarëve të cilët i emëron Kuvendi i Republikës së Maqedonisë për periudhën prej tri vitesh, pa të drejtë të rizgjedhjes.
- (2) Kuvendi i Republikës së Maqedonisë shpall konkurs publik për emërimin e kryetarit dhe gjashtë anëtarëve prej të cilëve tre janë ekspertë dhe tre janë përfaqësues të organizatave (shoqatave) joqeveritare nga sfera e mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, sigurisë dhe mbrojtjes.
- (3) Kryetari dhe anëtari i Këshillit mund të jetë personi i cili i përmbush kushtet në vijim:
 - të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
 - në momentin e shpalljes së konkursit publik me aktgjykim të plotfuqishëm gjyqësor nuk i është shqiptuar dënim apo sanksion kundërvajtjes ndalim për ushtrim të profesionit, veprimtarisë apo detyrës,
 - të ketë të marra së paku 240 kredi sipas SETK apo ka mbaruar shkallën VII të arsimit,

- të ketë përvojë pune prej së paku shtatë vjet në sferën e së drejtës, telekomunikimeve dhe teknologjive informatike apo pesë vjet përvojë pune tek organizatat joqeveritare nga sfera e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, sigurisë dhe mbrojtjes.

Pushimi i mandatit

Neni 49

(1) Kryetarit dhe anëtarit të Këshillit mund t'u pushoje mandati në Këshill për këto shkaqe:

- me kërkesë të tij;
- nëse përherë e humb aftësinë për ushtrimin e funksionit;
- nëse gjykohet me aktgjykim të plotfuqishëm për vepër penale dënim i pakushtëzuar me burg në kohëzgjatje prej se paku gjashtë muaj.

(2) Bazat për shkarkimin e kryetarit dhe anëtarit të Këshillit para skadimit të mandatit janë:

- puna joprofesionale dhe e pandërgjegjshme;
- shkelja e sigurisë së informatave të klasifikuara;
- keqpërdorimi i të dhënave personale;
- nëse nuk vepron në pajtim me dispozitat e Ligjit për pengim të korrupsionit.

Raportet e Këshillit

Neni 50

(1) Këshilli dorëzon në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë raport vjetor për punën e Këshillit për vitin kalendarik paraprak më së voni deri në fund të muajt shkurt në vitin rrjedhës.

(2) Raporti nga paragrafi (1) i këtij neni shqyrtohet në seancën e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë.

(3) Sipas nevojës dhe me kërkesë të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, Këshilli dorëzon raporte plotësuese.

(4) Për raportin nga paragrafi (1) i këtij neni në mënyrë përkatëse njoftohet publiku.

Veprimi i Këshillit

Neni 51

(1) Këshilli vepron me vetiniciativë apo pas parashtresës së parashtuar nga qytetari.

(2) Në bazë të parashtresës së parashtuar nga qytetari Këshilli ka për detyrë:

- menjëherë të parashtrojë kërkesë te Komisioni nga neni 38 i këtij ligji, që të zbatojë mbikëqyrjen në pajtim me nenin 40 të këtij ligji me qëllim të sigurohet nëse numri telefonik i qytetarit është apo ka qenë në mënyrë të paligjshme i ndjekur në tre muajt e fundit dhe

- të kryej mbikëqyrje në AOT dhe organet e autorizuara.

(3) Komisioni në bazë të mbikëqyrjes së kryer nga paragrafi (2) alineja 1 të këtij neni dorëzon njoftim të Këshilli në afat prej 15 ditësh nga dita e parashtrimit të kërkesës.

(4) Për shkak të ruajtjes së besueshmërisë së masave për ndjekjen e komunikimeve në njoftim nga paragrafi (3) i këtij neni është theksuar vetëm nëse në rastin konkret është:

a) konstatuar keqpërdorimi apo

b) nuk është konstatuar keqpërdorimi.

(5) Mbikëqyrjen nga paragrafi (2) alineja 2 të këtij neni Këshilli e kryen me njoftim paraprak në AOT dhe tek organet e autorizuar, për kryerje të krahasimit të të dhënave nga ekzemplarët e anonimizuar të urdhëresave për nevojat e mbikëqyrjes dhe kontrollit, për periudhën nga tre muajt e fundit.

(6) Këshilli në pajtim me njoftimin nga paragrafi (3) i këtij neni dhe mbikëqyrjen e kryer nga paragrafi (5) i këtij neni menjëherë e njofton qytetarin nga paragrafi (2) i këtij neni, e nëse në rastin është konstatuar keqpërdorimi, Këshilli menjëherë e njofton edhe prokurorin publik kompetent.

(7) Kur Këshilli vepron me iniciative personale mbikëqyrjen e kryen në pajtim me paragrafin (5) të këtij neni.

(8) Për mbikëqyrjen e kryer nga paragrafi (7) i këtij neni, Këshilli e njofton publikun.

Rregullorja e punës së Këshillit

Neni 52

Këshilli miraton Rregullore për punën e vet, me të cilën rregullohen çështjet për mënyrën e punës së Këshillit.

Kushtet për punën e Këshillit

Neni 53

(1) Kushtet hapësinore për punën e Këshillit i siguron Kuvendi i Republikës së Maqedonisë.

(2) Mjetet financiare për punën e Këshillit sigurohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë.

1.3 Mbikëqyrja nga Drejtoria për Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Drejtoria për Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Neni 54

Drejtoria për Mbrojtjen e të Dhënave Personale kryen mbikëqyrjen mbi ligjshmërinë e aktiviteteve të marra gjatë përpunimit të të dhënave personale, si dhe mbi zbatimin e masave për mbrojtjen e tyre të përcaktuara me ligj.

1.4 Mbikëqyrja nga Drejtoria për Sigurinë e Informatave të Klasifikuara

Drejtoria për Sigurinë e Informatave të Klasifikuara

Neni 55

Drejtoria për Sigurinë e Informatave të Klasifikuara kryen mbikëqyrjen mbi ligjshmërinë e menaxhimit me informatat e klasifikuara të përcaktuara me ligj dhe rregullat e miratuara në bazë të atij ligji.

1.5 Mbikëqyrja nga Avokati i Popullit i Republikës së Maqedonisë

Avokati i Popullit i Republikës së Maqedonisë

Neni 56

Avokati i Popullit i Republikës së Maqedonisë kryen mbikëqyrje të ligjshmërisë së aktiviteteve të ndërmarra gjatë zbatimit të masave për ndjekje të komunikimeve në aspekt të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të njeriut.

RREGULLORJA E PUNËS SË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

III. TË DREJTAT DHE DETYRAT E DEPUTETËVE

5. Interpelanca

Neni 45

(1) Interpelancë mund të paraqesin së paku pesë deputetë për punën e bartësit të funksionit publik, për Qeverinë dhe çdo anëtar të saj veças, si dhe për çështje lidhur me punën e organeve shtetërore.

(2) Interpelanca paraqitet me shkrim, nënshkruhet nga të gjithë deputetët që e paraqesin dhe duhet të përmbajë arsyetim.

(3) Interpelanca i dorëzohet Kryetarit të Kuvendit, i cili menjëherë ia dërgon atij të cilit i është paraqitur dhe deputetëve.

Neni 46

Subjekti, të cilit i është paraqitur interpelanca, ka të drejtë që për interpelancën e paraqitur Kryetarit të Kuvendit t'i dërgojë përgjigje me shkrim, më së voni brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimi të interpelancës.

Neni 47

(1) Interpelanca vihet në rend dite në seancën e parë të radhës të Kuvendit, pas skadimit të 15 ditëve nga dita e shpërndarjes së përgjigjes deputetëve.

(2) Nëse përgjigjja nuk dërgohet brenda afatit të parashikuar me nenin 46 të kësaj Rregulloreje, interpelanca vihet në rend dite në seancën e parë të radhës të Kuvendit

Neni 48

(1) Të drejtën për ta arsyetuar interpelancën në seancën e Kuvendit e ka njëri nga deputetët që e kanë paraqitur interpelancën, në kohëzgjatje prej 20 minutash.

(2) Subjekti të cilit i është paraqitur interpelanca ftohet në seancë dhe ka të drejtë ta arsyetojë përgjigjen e tij me shkrim ose të japë përgjigje me gojë për interpelancën e parashtruar, në kohëzgjatje prej 20 minutash.

Neni 49

(1) Diskutimi për interpelancën zgjat më së shumti një ditë pune.

(2) Deputetët për pjesëmarrje në diskutimin e interpelancës, e njoftojnë me shkrim Kryetarin e Kuvendit 24 orë para mbajtjes së seancës.

(3) Radhitjen e deputetëve sipas grupeve të deputetëve dhe të deputetëve që nuk janë të organizuar në grupe të deputetëve, por që do të marrin pjesë në diskutim, e përcakton Kryetari i Kuvendit, në marrëveshje me koordinаторët e grupeve të deputetëve në mënyrë që të sigurohet që në diskutim të marrin pjesë deputetë nga grupe të ndryshme të deputetëve. Pas përfundimit të diskutimit Kuvendi vendos për interpelancën.

(4) Nëse Kuvendi e aprovon interpelancën, miraton konkluzion në të cilin paraqitet qëndrimi në lidhje me të dhënat në interpelancë.

Neni 50

Deputetët të cilët e kanë paraqitur interpelancën mund ta tërheqin vetëm para fillimit të diskutimit.

Neni 51

Diskutimi për interpelancën ndërpritet, nëse:

- i paraqitet mocion besimi Qeverisë,
- Qeveria jep dorëheqje,
- Kryetari i Qeverisë paraqet propozim për shkarkimin e anëtarit të Qeverisë për punën e të cilit është parashtruar interpelanca, dhe
- bartësi i funksionit publik paraqet dorëheqje.

XII. MARRËDHËNIET ME QEVERINË

Neni 212

Të besuarit të cilët Qeveria i ka caktuar, marrin pjesë në mbledhjen e trupit punues dhe japin njoftime dhe sqarime për çështjet e rendit të ditës.

Neni 213

Kuvendi ushtron kontroll politik dhe mbikëqyrje mbi Qeverinë, në mënyrë dhe procedurë të përcaktuar me Kushtetutë dhe me këtë Rregullore.

KOMISIONI PËR MBIKËQYRJEN E PUNËS SË DREJTORISË PËR SIGURI DHE KUNDËRZBULIM DHE TË AGJENCISË PËR ZBULIM

Komisioni ka kryetar, tetë anëtarë dhe zëvendësit e tyre.

Komisioni i shqyrton çështjet lidhur me:

- respektimin e të drejtave dhe lirive, të përcaktuara me Kushtetutë dhe ligje nga ana e Drejtorisë për siguri dhe kundërzbulim dhe Agjencisë për zbulim të qytetarëve, ndërmarrjeve dhe personave tjerë juridik;
- ligjshmërinë në zbatimin e autorizimeve të Drejtorisë për siguri dhe kundërzbulim dhe Agjencisë për zbulim nga aspekti i kapërcimit të autorizimeve, ndërmarrjes së procedurave të paautorizuara, keqpërdorim dhe gjëra të tjera negative në punën, në kundërshtim me të drejtat e tyre të përcaktuara me ligj;
- metodat dhe mjetet që i shfrytëzojnë Drejtoria për siguri dhe kundërzbulim dhe Agjencia për zbulim nga aspekti i ligjshmërisë dhe respektimit të të drejtave të qytetarëve dhe subjekteve tjera;
- pajisjen me materiale, me kuadro dhe me teknikë të Drejtorisë për siguri dhe kundërzbulim dhe Agjencisë për zbulim
- vendosjen e bashkëpunimit ndërkombëtar për çështje që kanë të bëjnë me mbikëqyrjen e tillë dhe
- çështjet tjera që kanë të bëjnë me Drejtorinë për siguri dhe kundërzbulim dhe Agjencinë për zbulim.

KOMISIONI PËR MBIKËQYRJEN E ZBATIMIT TË MASËS SË VEÇANTË HETUESE – NDJEKJA E KOMUNIKIMEVE NGA MPB, DREJTORIA E POLICISË FINANCIARE, DREJTORIA DOGANORE DHE MM

Komisioni ka kryetar, katër anëtarë, zëvendëskryetar dhe katër zëvendës-anëtarë.

Komisioni i shqyrton çështjet lidhur me:

- kryerjen e mbikëqyrjes të zbatimit të masës së veçantë hetuese- ndjekje e komunikimeve nga ana e Ministrisë së Punëve të Brendshme, Drejtoria e Policisë Financiare, Drejtoria Doganore dhe Ministria e Mbrojtjes;
- ligjshmërinë në zbatimin e masës së veçantë hetuese- ndjekje e komunikimeve nga ana e Ministrisë së Punëve të Brendshme, Drejtoria e Policisë Financiare, Drejtoria Doganore dhe Ministria e Mbrojtjes nga aspekti i harmonizimit të tyre me Ligjin për ndjekje të komunikimeve dhe

- vendosjen e bashkëpunimit ndërkombëtar për çështjet që kanë të bëjnë me mbikëqyrjen e tillë
- çështjet tjera që kanë të bëjnë me Ministrinë e Punëve të Brendshme, Drejtorinë e Policisë Financiare, Drejtorinë Doganore dhe Ministrinë e Mbrojtjes në lidhje me masën e veçantë hetuese- ndjekje të komunikimeve.

Komisioni paraqet raport vjetor deri te Kuvendi i Republikës së Maqedonisë në afat prej dy muajve pas përfundimit të vitit vijues, për mbikëqyrjen e kryer mbi ligjshmërinë e zbatimit të masës së veçanta hetuese- ndjekje e komunikimeve nga ana e Ministrisë së Punëve të Brendshme, Drejtoria e Policisë Financiare, Drejtoria Doganore dhe Ministria e Mbrojtjes.

SHTOJCA B: A PLANI VJETOR I AKTIVITETEVE TË KOMISIONIT

Ky është një udhërrëfyes i mundshëm për aktivitetet që do të zbatohen nga komisioni brenda një viti.

Planet vjetore për veprim mund të ndihmojnë komisionin, anëtarët individualë dhe personelin për të organizuar agjendën e tyre, për të komunikuar më mirë me institucionet mbikëqyrëse dhe me publikun dhe për të planifikuar angazhimin e ekspertizës së jashtme dhe burimeve të tjera. Një plan i tillë mund të bëhet çdo vit, duke u bazuar në praktikën e zakonshme të zhvilluar në vitin e kaluar nga komisioni. Mund të ndahet ose jo me institucionet mbikëqyrëse, kuvendin dhe publikun, sipas vendimit të komisionit.

Periudha	Aktivitete	Aktivitete pasuese
Seanca e parë parlamentare (Shkurt-korrik)	Raportet vjetore për veprim janë të debatuar dhe miratuar: 1. DSK 2. Shërbimi për zbulim 3. AOT	Raportet e aktiviteteve dhe debatet në komision me përfaqësues nga shërbimi Rekomandimet janë të formuluar me shkrim dhe i dërgohen shërbimit pas takimit, me afate kohore për implementim Mendimet e Komisionit mbi aktivitetet e zbulimit dorëzohen/diskutohen në seancën plenare
	Komisioni kërkon raporte specifike mbi çështjet e identifikuara si prioritet - kërkesat për raportime specifike janë të hartuara nga personeli i komisionit dhe dërgohen tek institucioni mbikëqyrës.	Raportet speciale pranohen dhe diskutohen në komision Rekomandimet kthehen pas, me afat kohor për zbatim Kumtesa për shtyp duhet të përmbledh çështjen, nëse tema nuk është shumë e ndjeshme.
	Seancat mbikëqyrëse ■ 2 Pro-aktive të planifikuara prej më parë, mbi politikën e mëdha/çështjet mbi reformat ■ Reaktive mbi çështje të ndryshme të zbuluara nga mediet, deputetët, burimet e pavarura. Zyrtar publik të ftuar 24-48 orë më herët	Rekomandime Raporti në ueb faqe Kumtesë për shtyp
	Një takim i përbashkët me komisionet tjera që kanë kompetenca në mbikëqyrjen e shërbimeve të zbulimit /ose Këshilli qytetar mbikëqyrës	Mendimi i përbashkët në ueb faqe Plani për veprim të përbashkët
	Aktiviteti legjislativ	Mendim i dorëzuar deri te ■ komisionet tjera ■ mbledhja plenare
	Vizita në terren/inspektime ■ 2 Të planifikuara ■ 2 Të pa planifikuara	

Seanca e dytë parlamentare (Shtator- dhjetor)	Debatohet Raporti vjetor i Entit për revizion - Rishikim i realizimit të buxhetit të vitit të kaluar	Mendimi dorëzohet në Seancë plenare Rekomandime
	Takim i përbashkët me Komisionin për buxhet	Rekomandime të përbashkëta
	4 vizita mbikëqyrëse në terren	Konferencë për shtyp/kumtesë për shtyp Mendimi i komisionit i dorëzuar tek institucioni i vizituar (shqyrtohet edhe në mbledhje plenare?)
	4 seanca dëgjimore – për zbatimin e rekomandimeve të komisionit nga fillimi i vitit	Kumtesë për shtyp Rekomandimet e reja janë lëshuar Mendimi i komisionit në ueb faqe (shqyrtohet në mbledhje plenare?)
	Rishikohet propozim buxheti për vitin e ardhshëm	Mendimi shqyrtohet në mbledhje plenare
	Takim i përbashkët me Komisionin për buxhet	
	Aktiviteti legjislativ	Mendimi shqyrtohet në mbledhje plenare

SHTOJCA C: PASQYRË E ÇËSHTJEVE NË PLANET VJETORE TË AKTIVITETEVE

Çështjet /temat e përfshira Në raportet publikë të aktiviteteve	Frekuenca	Treguesit sasior	Interpretim/pyetje pasuese dhe shembuj nga raportet e shteteve të tjera
Rreziqet dhe kërcënimet për sigurinë kombëtare	Në vit	Vetëm tregues cilësor	-
Prioritetet në punën e shërbimit	Në vit	Vetëm tregues cilësor	-
Communications interceptions for national security	Yearly	Informata mbi të dhënat mund gjithashtu të ndahet më tutje në numrin e:	Informata mbi të dhënat mund gjithashtu të ndahet më tutje në numrin e: - rasteve për të cilat është kërkuar përgjimi - njerëzit të cilët janë përgjuar
		Nr. i urdhëresave të dhëna	Si janë ndryshuar/ashpërsuar procedurat si pasojë, për të parandaluar shkeljet e mëtejshme?
		Nr. i kërkesave për urdhëresa të refuzuara nga gjykatësi	Në 2014, Shërbimi Rumun për zbulim (SRI) ka zbatuar 44,759 përgjime të komunikimeve, nga të cilat 2'762 kishin të bënin me sigurinë kombëtare (SRI 2014 Raporti vjetor i aktiviteteve, fq. 31)
Ndjekja e komunikimeve për hetime të krimit (për Prokurorin publik)	Tremujor	Nr. i padive dhe dënimeve si pasojë e përgjimeve nda vitet e mëhershme	Në Zelandë të Re gjatë periudhës së raportimit 2016/17 25 urdhëresa nga vendi dhe 12 urdhëresa për zbulim të jashtëm janë dhënë, përderisa 25 urdhëresa nga vendi dhe 10 urdhëresa për zbulim të jashtëm ishin ende në fuqi nga periudha e kaluar e raportimit. Ditët mesatare në të cilat ka qenë në fuqi një urdhëresa për zbulim për urdhëresat vendore është 172 ditë ndërsa për ato të huaja 153 ditë. (Raporti vjetor i shërbimeve të sigurisë dhe zbulimit i Zelandës së Re 2017, fq. 34).
		Nr. i shkeljeve dhe gabimeve në zbatimin e procedurave të përgjimit	Në 2014 Shërbimi Rumun për zbulim (SRI) ka realizuar 44'759 përgjime të komunikimeve, nga të cilat 42'263 ishin urdhëresa për përgjim për Prokurorin publik, mbi hetime të krimit (15% rritje nga viti i kaluar) (SRI 2014 Raporti vjetor i aktivitetëve, fq. 31)


Raportet e zbulimit të përgatitura për palë të ndryshme	Në vit	Nr. i raporteve të prodhuara Nr. / lloji i palëve që pranojnë raporte	Çfarë informata kthyesë dërgojnë prapa shfrytëzuesit? A përdoren raportet në vendimarrjen politike? Si po i adaptojnë shërbimet e zbulimit produktet e tyre pas informatave kthyesë? Agjencia për siguri dhe zbulim e Kroacisë (SOA) ka dorëzuar në 2014 përafërsisht 8700 raporte deri te shfrytëzuesit e tyre, nga të cilat 290 raporte analitike deri te Kryetari dhe Qeveria. (SOA Raporti publik 2015, fq.24) Në 2017, SOA ka dorëzuar 450 raporte analitike deri tek udhëheqësia shtetërore, që është një rritje prej 40% nga viti i kaluar (SOA Raporti publik 2017, fq. 5) Shërbimi Rumun për zbulim (SRI) ka dorëzuar në 2014, 5'373 raporte deri te shfrytëzuesit kryesore (10% më pak se a në vitin e kaluar si rezultat i integritetit të zbulimit) dhe 2'937 raporte deri tek administrata lokale. (SRI 2014 Raporti vjetor i aktiviteteve, fq. 16) Agjencia kombëtare për siguri në komunikime holandeze (AIVD) ka prodhuar në 2016 gjithsej 457 raporte të zbulimit, 152 raporte zyrtare dhe 118 produkte kërcënimi. (AIVD Raport vjetor 2016, fq. 9)
Hetimi i gjurmëve/paraqitjeve	Në vit	Nr. i gjurmëve të pranuar dhe hetuara	Organizata për siguri dhe zbulim e Australisë (ASIO) ka pranuar në 2016-17 mbi 12 000 gjurmë dhe ka zgjidhur apo hetuar përafërsisht 15 000 referime nga gjurmët. (ASIO Raport vjetor 2016-17, fq. 48) Në 2016, AIVD e Holandës është marrë me afro 5'400 paraqitje në lidhje me terrorizmin, që kanë iniciuar edhe 238 hetime të mëtejshme (AIVD Raporti vjetor 2016, fq. 4)
Organizimi dhe menaxhimi i shërbimit	Në vit		Tabela organizative dhe funksionet e njësive të ndryshme organizative janë zakonisht publike. Numri i saktë i të punësuarve është zakonisht i klasifikuar. Përqindja siç është gjinia, arsimimi apo moshë është e përmendur në disa raste.

Kontrolli i brendshëm dhe mbikëqyrja	Në vit	Nr. i ankesave të pranuar	SRI e Rumanisë - 31.397 ankesa të pranuar në 2016, 20'567 të zgjidhura në mënyrë të favorshme. (Relatëile SRI cu cetățenii in anul 2016)
Llogaridhënia publike - kërkesa të bazuar në Aktin e lirisë së informimit		Nr. i procedurave disiplinore të iniciuara	SOA e Kroacisë - 9 procedura disiplinore në 2014 për shkelje të detyrave zyrtare (SOA Raporti publik 2015, fq. 39) Në 2016, 24 ankesa për AIVD të Holandës janë bërë te ministri i Punëve të Brendshme, ndërsa 15 deri tek Avokati i Popullit (AIVD Raport vjetor 2016, fq. 12)
Buxheti - shuma e përgjithshme. Harxhimet e personelit, shpenzimet momentale, zhvillim dhe modernizim.	Në vit	Nr. i kërkesave të pranuar/ përgjigjur	SRI e Rumanisë ka pranuar 85 kërkesa në bazë të Aktit për liri të informatave në 2016 (32 janë përgjigjur pozitivisht, 53 janë refuzuar)(Raport vjetor për qasje deri tek informatat me interes publik 2016)
Verifikim sigurie	Në vit	Buxheti me shumë të përafërt, krahasuar me vitet paraprake .	Shumat e mëdha (rrallëherë buxhete më të hollësishme) janë të botuara në raportet publike të aktiviteteve vjetore. Megjithatë, komisioni duhet të ketë qasje deri tek informatat më të hollësishme mbi realizimin e buxhetit. Verifikimi përfshin qasjen deri te të dhënat personale, andaj duhet të realizohet duke përcjellë procedura transparente; të lejojë mekanizma për ankim/ kontestim. Në 2016-17, ASIO e Australisë ka finalizuar 27 182 vlerësime sigurie në lidhje me personelin e qeverisë Australiane dhe të tjerë të cilët kërkojnë qasje tek informatat kombëtare të klasifikuara, ndjeshme dhe privileguara qeveritare dhe fushës, ndërsa 14'358 vlerësime sigurie të vizës. (ASIO Raporti vjetor 2016-17, fq. 54) Në 2016, AIVD e Holandës dhe organizatat me mandat (Shërbimi i policisë kombëtare, Xhandarmeria mbretërore ushtarake) kanë kompletuar mbi 35'000 kontrole sigurie (8'000 nga vetë AIVD). (AIVD Raporti vjetor 2016, fq. 12) Në 2014 SOA e Kroacisë ka realizuar 5933 procedura të verifikimit të sigurisë, (SOA Raporti publik 2015, fq. 24) dhe ka kompletuar në 2016 kontrole të sigurisë mbi 73'551 individ (SOA Raport publik 2017, fq. 25)
Bashkëpunim me institucione të tjera kombëtare	Në vit	Nr. i raporteve të ndara midis agjencive kombëtare partnere	Në 2016-17, ASIO Australiane ka prodhuar gjithsej 1433 raporte zbulimi për agjencitë partnere kombëtare. Raportimi është ndarë deri te më shumë se 130 organizata qeveritare federale, shtetërore dhe territoriale. (ASIO Raport vjetor 2016-17, fq. 36)
Trajnim/informim i institucioneve kombëtare	Në vit	Nr. i informimeve të realizuara	ASIO Australiane (2016-17) ka mbajtur 76 informime për Qeverinë Australiane dhe partnerë të industrisë mbi treguesit e mobilizimit për dhunë, për të krijuar një kuptim kolektiv për sjelljen terroriste. (ASIO Raport vjetor 2016-17, fq. 51)

Bashkëpunim me partnerë të huaj	Në vit	Nr. i shteteve / shërbimeve me të cilët kanë marrëveshje për bashkëpunim dhe shkëmbim të informatave	ASIO Australiane (2016-17) ka qenë e autorizuar nga Prokurori i përgjithshëm për të bashkëpunuar me mbi 350 agjenci në 130 shtete. ASIO në atë periudhë ka ndarë raportimet me mbi 130 agjenci të huaja partnere për lidhje në 60 shtete, me 643 raporte të zbulimit të dhëna te një apo më shumë agjenci partnere. (ASIO Raport vjetor 2016-17, fq. 52) Në mes të viteve 2013 dhe 2016 SOA e Kroacisë ka rritur sasinë e informatave të zbulimit të marra përmes bashkëpunimeve për zbulim nga faktori 5. (SOA Raport publik 2015, fq. 13)
Siguria fizike	Në vit	Nr. i vendeve të inspektuara, raportuara dhe certifikuara	Në 2016-17, ASIO Australiane ka realizuar: Hapësira të zonës 5: 80 inspektime në vend / raporte, 39 certifikime Shërbime shkatërrimi: 9 inspektime në vend / raporte, 8 certifikime Objektet e agjencisë kryesore : 3 inspektime në vend / raporte, 2 certifikime Shërbime korrieri: 3 inspektime në vend dhe raporte (ASIO Raport vjetor 2016-17, fq. 65)
Kundërmasa për mbikëqyrje teknike	Në vit	-	ASIO Australiane: fshehtësi
Arsim	Në vit	Kurse të realizuara	In 2016-17, ASIO Australiane ka realizuar 50 kurse për ndërgjegjësim i situatës, siguri personale, de-eskalim, ndihmë të parë gjatë traumave dhe ndërgjegjësim për mjedis armiqësor për gjithsej 512 pjesëmarrës. (ASIO Raport vjetor 2016-17, fq. 68)

SHTOJCA D: PASQYRË E AKTORËVE DHE PROCESEVE


Ligji për ndjekjen e komunikimeve (I/C) Lidhjet me palët e interesit (Numrat në grafikun e mëposhtëm i referohen neneve në Ligji)




* Komiteti për mbikëqyrje të IC-së dhe Këshilli Qytetar për Mbikëqyrje bëjnë mbikëqyrje të drejtpërdrejtë mbi trupat e autorizuar (43)(CSC 51/2)

** Trupa të tjerë të autorizuar për zbatimin e ligjit: drejtoria e doganave, policia financiare, stration, financial police


Ndjekja e komunikimeve në hetimet e krimit ME ndërmjetësim të AOT-it




Ndjekja e komunikimeve në hetimet e krimit PA ndërmjetësim të AOT-it



Ndjekja e komunikimeve në operacionet e zbulimit dhe sigurisë ME ndërmjetësim të AOT-it



Ndjekja e komunikimeve në operacionet e zbulimit dhe sigurisë PA ndërmjetësim të AOT-it





DCAF

a centre for security,
development and
the rule of law

Qendra e Gjenevës për kontroll demokratik të forcave të armatosura (DCAF) promovon qeverisjen e mirë dhe reforma në sektorin e sigurisë. Qendra kryen hulumtime mbi praktikën e mirë, inkurajon zhvillimin e normave të përshtatshme në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, bën rekomandime të politikave dhe siguron këshilla dhe programe ndihme në vend. Partnerët e DCAF-it përfshijnë qeveritë, parlamentet, shoqërinë civile, organizatat ndërkombëtare dhe gamën e shërbimeve të sektorit të sigurisë, duke përfshirë ushtrinë, policinë, gjyqësinë, agjencitë e zbulimit dhe shërbimet e sigurisë kufitare.

Na vizitoni në www.dcaf.ch

